



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

EMRI: BEKIM ÇELEBI

PROGRAMI I MAGJISTRATURËS: DIPLOMACI

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE

TEZA E MAGJISTRATURËS

KRIMET NDAJ ROHINGASVE DHE DËSHTIMI I R2P-SË
PËR TË MBROJTUR CIVILËT

MENTORI

Prof. Dr. Agron RUSTEMI

KANDIDATI:

Bekim ÇELEBI

TABELA E PËRMBAJTJES

1. ABSTRAKTI	3
1.1 ABTRACT	4
1.2 АБСТРАКТ	5
2. HYRJE.....	6
2.1 Lënda e hulumtimit	6
2.2 Qëllimet e hulumtimit	7
2.3 Hipotezat.....	7
2.4 Metodologjia e hulumtimit	8
2.5 Rëndësia e punimit.....	8
KAPITULLI I	9
3. MIANMARI DHE TRADITA E TIJ NË HISTORI	9
3.1 Historia e hershme	9
3.1.1 Burma Britanike (1824-1948)	10
3.1.2 Pavarësia e Burmës (1948-1962)	10
3.1.3 Sundimi ushtarak (1962-2011)	11
3.1.4 Reformat Demokratike (2011-2015)	11
3.2 Sistemi politik i Mianmarit	11
3.2.1 Pushteti legjislativ	12
3.2.2 Pushteti ekzekutiv	12
3.2.3 Pushteti gjyqësor.....	12
3.2.4 Forcat e Armatosura të Mianmarit	13
3.2.5 Partitë Politike.....	13
3.2.6 Sistemi politik i Mianmarit sipas perëndimit.....	14
3.3 Pasuria e Mianmarit, ekonomia dhe gjeopolitika e tij	14
3.4 Etnitë e tjera në Mianmar dhe Pakica e rohingasve	16
3.4.1 Shanët (Shan)	16
3.4.2 Karenët (Karen).....	16
3.4.3 Monët (Mon)	17
3.4.4 Çinët (Chin).....	17
3.4.5 Rakinët (Rakhine)	17
KAPITULLI II	19

4. DHUNA NDAJ ROHINGASVE DHE SHENJAT E GJENOCIDIT DHE SPASTRIMIT ETNIK.....	19
4.1 Gjenezat e problemit mes budistëve dhe rohingasve myslimanë në Mianmar	27
4.1.1 Zhvillimi i gjenocidit dhe spastrimit etnik ndaj popullit rohingas në shtetin rakhine ...	30
4.1.1.1 Rohingasit si grup i numëruar	31
4.1.1.2 Aktet si element i krimit të gjenocidit	32
4.1.2 Intenca dhe masa e krimeve të Gjenocidit	35
4.2 Reagimet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me krizën në Mianmar	39
KAPITULLI III.....	44
5. PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR CIVILËT (RESPONSIBILITY TO PROTECT-R2P).....	44
5.1 Sovraniteti shtetëror përballë sovranitetit njerëzor (4 krimet kundër njerëzimit) .	46
5.1.1 Doktrina R2P, shtyllat dhe kushtet për ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare	48
5.2 Gjenocidet e mëparshme (Ruandë, Srebrenicë, Lufta në Kosovë e ajo në Libi) dhe ndërhyrjet ndërkombëtare	50
5.2.1 Gjenocidi në Ruandë	50
5.2.2 Gjenocidi në Bosnjë (Srebrenicë).....	51
5.2.3 Lufta në Kosovë	52
5.2.4 Ndërhyrja ndërkombëtare në Libi	54
5.2.5 Përgjegjësia për të Mbrojtur: Rasti i Rohingasve në Mianmar	55
KAPITULLI IV.....	59
6. REZOLUTAT E OKB-SË DHE DËSHTIMI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT	59
6.1 Vetoja e Këshillit të Sigurimit, pengesë në realizimin doktrinës R2P	66
6.2 Dështimi i ndërkombëtareve në përmbushjen e vlerave të OKB-së	68
7. PËRFUNDIMI.....	70
8. BIBLIOGRAFIA	76

1. ABSTRAKTI

Pushteti në Mianmar shkel të drejtat e njeriut. Trajtimi i pakicës myslimane në kushte çnjerëzore por edhe mungesa e vullnetit të pushtetit për të përmirësuar situatën, është një shkelje e rëndë e të drejtës ndërkombëtare. Por, për të frenuar këtë, as komuniteti ndërkombëtar nuk ka bërë mjaftueshëm...

Rohingasit janë një 135 etnitë e Mianmarit, një shtet me të kaluar të gjatë nën juntën ushtarake. Por, rohingasit, të cilët njiheshin si etni dhe si popull i Mianmarit që nga kolonizimi britanik, me një ligj të vitit 1982 nuk gëzojnë as shtetësinë e Mianmarit dhe janë prej një kohe të gjatë nën represionin e autoriteteve shtetërore dhe shumicës budiste për deportim. Ata konsiderohen si bengalë – të ardhur nga Bangladeshi – dhe për më tepër, besimi i tyre fetar, sipas paragjytimeve budiste, shihet si kërcënim.

Vala e dhunës ndaj rohingasve (një popullsi gati 2 milion myslimanësh) filloi në vitin 2012 dhe vijoi edhe në 2017 me masakra, me vrasje, me përdhunime, me djegie të shtëpive, përzënie etj., të cilat përmbushin edhe formulën me 4 krimet, ato kundër njerëzimit, krimet e luftës, gjenocidit dhe spastrimit etnik (Konventa për Gjenocidin). Vetëm në harkun kohor 1 muor të valës së dhunës gusht-shtator 2017 humbën jetën 6 700 rohingas, ndërkohë që numri gjithsej i viktimave nga represioni i pushtetit të Mianmarit pretendohet të jetë qindra herë më i madh. Vetëm në kampin e refugjatëve në Bangladesh numërohen rreth 850 mijë rohingas.

Budistët, me dhunën e legalizuar nga ushtria, kryen masakrat më të tmerrshme njerëzore ndaj rohingasve, duke i djegur të gjallë (pamje që pushtuan botën) ndërkohë që shteti, në vend që të ndërhynte për ta parandaluar dhunën, e vazhdoi atë me ligje akoma më të rënda, me punë të detyruar për rohingasit myslimanë, me ndalime udhëtimi, me ligj për ndalime martesash, për numër të kufizuar fëmijësh etj.

Këto politika nuk u zbutën as kur në kuadër të tranzicionit politik dhe liberalizimit të juntës, erdhi si kryeministre Aung San Suu Kyi, nobeliste për paqe dhe ish e burgosur politike.

Nga ana tjetër, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, pavarësisht se kjo organizatë promovon vlerat demokratike dhe liritë e njeriut, dështoi të merrte masat konkrete për të shmangur gjenocidin dhe krimet e rënda që përjetojnë rohingasit. Kina dhe Rusia, duke vendosur interesat e tyre ekonomike, nuk votuan asnjë rezolutë për ndërhyrje humanitare, pavarësisht këmbënguljes së SHBA-së dhe aleatëve të saj perëndimorë. Deklaratat presidenciale të Këshillit të Sigurisë kishin vetëm fuqi rekomandimi, por jo edhe sanksionimi.

Rasti i Mianmarit është një nga rastet e shekullit XXI ku doktrina “Përgjegjësia për të mbrojtur (civilët)” po dështon, pavarësisht se parimet e saj përforcojnë idenë se njeriu është një subjekt i pamohueshëm i marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe jo më shteti, sovraniteti i të cilit sipas bindjes së vjetër uestfaliane ishte më i rëndësishëm se sa jeta e individit.

Fjalët kyçe: Mianmar, rohingas myslimanë, gjenocid, Përgjegjësia për të mbrojtur, R2P, Këshilli i Sigurimit

1.1 ABTRACT

The government of Myanmar violates human rights. Treating the Muslim minority in the edge of atrocities, but also the lack of will of this government to improve the situation in ground, makes it a serious violation of the International Law. Although, neither the international community has done enough to make this stop.

The Rohingyas people are one of the 135th ethnic groups living in Myanmar, a country with a long history of military junta. Even though the Rohingyas were recognized as an ethnic group of Myanmar since the British colonization, they are not yet eligible for Myanmar citizenship (due to a law adopted in 1982). They are consistently oppressed to deportation by the state authorities and the Buddhist majority.

The Rohingyas are considered as Bengals – landed from Bangladesh – and moreover, their Islamic religion is seen as a threat according to Buddhist prejudices.

The wave of violence against the Rohingyas (approximately 2 million Muslims) began in 2012 and peaked in 2017 with massacres, murders, rapes, house fires, expulsions, etc. This variety perfectly meets the formula of the 4 crimes according to the Convention of Genocide (crimes against humanity, war crimes, genocide, and ethnic cleansing). 6.700 Rohingyas were dead and 850.000 left the country toward Bangladesh (now settled in a refugee camp) only in a month's time (August-September 2017).

The Buddhist's violence "legalized" by the military of Myanmar was captured on camera, shocking the entire world. Images of people set on fire, beaten and stabbed went viral, in front of the authorities' very eyes who on the other hand, continued their oppression through several bans, like heavy work, travel bans, marriage bans, limited number of children, etc.

Such policies did not get abrogated even when Aung San Suu Kyi, a Nobel Peace Prize winner and a former political prisoner came to power, as part of the political transition toward the liberalization of the junta.

On the other hand, the UN Security Council, even though it promotes democratic values and human rights, failed to take concrete steps to avoid the genocide and atrocities over the Rohingyas.

China and Russia put their own economic interests first, opposing the attempts for a resolution which would have made possible the deployment of a force (under the humanitarian intervention) in the country. The attempts stopped at just presidential statements, with no sanctioning power but just recommendations.

The case of Myanmar is the very one that dresses up the "Responsibility to protect" with the guilt of failure, despite the fact its principles defend the new prerogative that human being sovereignty is way more important than the (Westphalian) state sovereignty.

Keywords: Myanmar, Muslim Rohingyas, genocide, Responsibility to protect, R2P, Security Council

1.2 АБСТРАКТ

Власта во Мианмар ги крши човековите права. Нехуманиот третман врз муслиманското малцинство, но и недостатокот на волја за да се подобри ситуацијата, е сериозно кршење на меѓународното право. За да го спречи ова, ниту меѓународната заедница не направи доволно.

Рохингите се една од 135-те етнички групи во Мианмар, земја со долгогодишна историја на владеење на воената хунта. Рохингите кои како етничка група во Мианмар се познати уште од времето на британската колонизација, според еден закон од 1982 година не го уживаат правото да се стекнат со државјанството на Мианмар и долго време беа под репресија од државните власти, како и од будистичкото мнозинство за депортирање. Тие се сметаат за бенгалци – кои се дојдени од Бангладеш – додека нивното религиозно верување, според будистичките предрасуди, се смета како закана.

Бранот на насилството врз рохингите (население од околу 2 милиони муслимани) започна во 2012 и продолжи во 2017 година со масакри, убиства, силувања, палење на куќи, протерувања и др., кои ја исполнуваат формулата на 4-те кривични дела, тие против човештвото, воените злосторства, геноцид и етнично чистење (Конвенција за спречување и казнување на злочинот геноцид). Само во еден месечниот период од август до септември 2017 година 6700 рохинга го загубија животот, додека вкупниот број на жртви од владината репресија во Мианмар се смета дека е стотици пати поголем. Само во бегалскиот камп во Бангладеш има околу 850000 рохинга.

Будистите, со насилството легализирано од војската, ги извршија најстрашните масакри врз рохингите, палејќи ги живи (кадри што се појавија ширум светот), додека државата наместо да интервенира за да го спречи насилството, ја продлабочи кризата со дискриминирачки закони, со присилна работа за рохингите, забрани за патување, забрани за стапување во брак, ограничување на бројот на деца итн. Овие политики не омекнаа дури и кога, како дел од политичката транзиција и либерализација на хунтата, дојде на власт Аунг Сан Су Чи, добитничка на Нобелова награда за мир и поранешна политичка затвореничка.

Од друга страна, Советот за Безбедност на ООН и покрај фактот дека оваа организација промовира демократски вредности и човекови слободи, не успеа да преземе конкретни мерки за да го избегне геноцидот и тешките злосторства што ги доживееја рохингите. Кина и Русија, поставувајќи ги своите економски интереси, не изгласаа ниту една резолуција за хуманитарна интервенција, и покрај инсистирањата на САД и нејзините западни сојузници. Изјавите на претседателот на Советот за Безбедност на ООН имаа моќ на препораки, но не на санкционирање. Случајот на Мианмар е еден од случаите на XXI век кога принципот “Одговорноста за заштита на цивилите” не успева, и покрај нејзините принципи дека човекот е најбитниот субјект во меѓународните односи, а не државата, чиј суверенитет според стариот Вестфаски принцип беше побитен од животот на поединецот.

Клучни зборови: Мианмар, рохинги муслимани, геноцид, одговорноста за заштита на цивилите, R2P, Совет за Безбедност

2. HYRJE

Përparimi i vlerave të njeriut dhe sovranitetit të tij, si një subjekt i rëndësishëm i marrëdhënieve ndërkombëtare, është një nga motivet e reja të fundshekullit XX dhe fillimshkullit XXI. Por, të drejtat e njeriut, pavarësisht se e drejta ndërkombëtare i jep më shumë vëmendje individit, ende vazhdojnë të shkelen në shumë shtete të botës.

Pushtimi i medias me pamje masakrash nga Mianmari, ishin nxitja kryesore për marrjen në studim të situatës së një etnie pakicë, rohingasve në këtë shtet. Kjo etni, jo vetëm që nuk njihet si popullatë e shtetit të Mianmarit, por prej kohësh është nën represionin e vazhdueshëm të komunitetit shumicë, budistëve, si dhe vetë shtetit të Mianmarit.

Pavarësisht se konflikti paraqitet si një përplasje e quajtur “komunale” (mes dy etnive), në fakt ai ka qenë një represion shtetëror i juntës ushtarake dhe tashmë të shtetit të ri (më liberal) të kryesuar edhe nga nobelistja për paqe Aung San Suu Kyi.

Duke pasur parasysh sendërtimin e të drejtës ndërkombëtare, atë të dënimit të krimeve të luftës, kundër njerëzimit, gjenocidit dhe spastrimit etnik, Mianmari mbetet një nga njollat më të zeza të doktrinës “Përgjegjësia për të mbrojtur (civilët)”.

Në këtë studim, sikurse më poshtë, hidhet dritë mbi ngjarjet në Mianmar, krimet kundër popullatës myslimane rohingase, mbi përpjekjet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të gjetur një zgjidhje, por edhe mbi interesat dhe përplasjet mes fuqive të mëdha, anëtare të përhershme në këtë këshill.

Në punim hidhet dritë mbi të ardhmen e botës, rrezikun e rrënimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare – qëllime të OKB-së – si dhe mekanizmat për zgjidhje konfliktesh, ku në rend të parë duhet të jetë sovraniteti njerëzor dhe jo ai shtetëror.

2.1 Lënda e hulumtimit

Mianmari, një shtet në Azinë juglindore, është bërë shteti më i përfolur për sa i përket shkeljes së të drejtave të njeriut. Nga popullata prej 54 milion banorësh, në Mianmar jetojnë rohingasit, një minoritet i cili është shpallur nga shumë studiues, si minoriteti më i persekutuar në botë, në suazat e një apartheidi.

Kriza me pakicën rohingase në Mianmar çoi në shpërnguljen e mbi 850 000 njerëzve, dhe një gjë e tillë vuri në shqetësim edhe komunitetin ndërkombëtar. Përkundër apeleve të shumta për ta frenuar dhunën ndaj këtij minoriteti, i cili nuk ka as shtetësi, as vendbanime dhe asnjë të drejtë sikurse pakicat e tjera në Mianmar, kanë mbetur thjesht deklarata presidenciale të Këshillit të Sigurimit (vetëm rekomandime) dhe jo rezoluta me sanksione reale apo me ndërhyrje humanitare.

Edhe doktrina “Responsibility to protect” (Përgjegjësia për të mbrojtur) duket se nuk po e përmbush misionin e saj ndaj 4 shkeljeve madhore të të drejtave të njeriut. Kjo doktrinë e themeluar me qëllim që të mbrojë civilët, e miratuar si forma më e reformuar e OKB-së në vitin 2005, tenton të ndihmojë në ndalimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit, gjenocidit dhe spastrimit etnik.

Por, ndonëse me herët kemi parë reagime adekuate nga Këshilli i Sigurimit, në rastin e Mianmarit dhe spastrimeve ndaj pakicës rohingase, kjo nuk ndodh. Komuniteti ndërkombëtar nuk mund të bëhet bashkë në qëndrime, për shkak të vetos së Kinës dhe

Rusisë për ndërhyrje të mundshme. Nga ana tjetër, kemi parë se SHBA-ja ka ndërhyrë edhe në mënyrë të njëanshme, prandaj ngrihet dilema përse nuk ndërhyjnë në Mianmar, dhe cilat janë interesat ose pengesat për një gjë të tillë.

Në këtë studim do të hedhim dritë mbi shtetin e Mianmarit, minoritetin rohingas, krimet ndaj tij, reagimet ndërkombëtare, peshën reale të doktrinë R2P si dhe sistemin e Këshillit të Sigurimit dhe dështimet e tij për të parandaluar masakra të tilla.

Po ashtu, do të shohim nëse krimet që ndodhin në Mianmar, e përmbushin realisht matricën e 4 krimeve kundër të cilave u themelua edhe doktrina e R2P, si dhe do të hedhim paralelet e sferave të ndikimit gjeopolitik të shteteve dhe fqinjëve të Mianmarit.

2.2 Qëllimet e hulumtimit

Përmes tezës së lartpërmendur synojmë të nxjerrim detaje të reja dhe më të thelluara mbi dhunën dhe krimet e budistëve ndaj pakicës myslimane rohingase në Mianmar.

Pikërisht qëllimi i hulumtimit tonë është që përmes fakteve dhe argumenteve të vërtetojmë nëse ka apo jo spastrim etnik, gjenocid apo krime kundër njerëzimit ndaj rohingasve në Mianmar, a shkelen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, dhe përse komuniteti ndërkombëtar hesht dhe nuk ndërmerr aktivitete të menjëhershme për parandalim të krimeve të tilla.

Nga ana tjetër, qëllim i hulumtimit do të jetë edhe zbardhja e dilemës nëse është e drejtë apo jo ndërhyrja ndërkombëtare në rastin e krizës me rohingasit në Mianmar, si dhe nëse pas vendimeve të tilla të 5 fuqive të mëdha fshihen interesa të tjera.

Në këtë punim do të hidhët dritë edhe mbi doktrinën “Përgjegjësia për të mbrojtur” dhe lëvizjet konkrete ndërkombëtare për të parandaluar jo vetëm gjenocidin, por edhe një konflikt që do të cenonte gjithë sigurinë dhe paqen në botë. Mbi të gjitha, do të synohet të tregohet nëse sovraniteti njerëzor është më i rëndësishëm nga ai shtetëror.

Në punim do të sqarohen edhe shkaqet se përse pacifizmi budist u shndërrua në nacionalizëm dhe çfarë çoi në një trajtim të tillë të pakicës rohingase në Mianmar.

2.3 Hipotezat

Ky punim synon të përbëjë një vlerë akademike, dhe si i tillë, për vërtetim ka shtruar edhe disa hipoteza të mirëfillta. Përveç hipotezës bazë që ky punim përpiket të sqarojë, përgjigje gjejnë edhe disa hipoteza të tjera dytësore.

Hipoteza e Përgjithshme

- Mianmari shkel të drejtat e njeriut me krimet ndaj minoritetit rohingas

Hipoteza ndihmëse

- Krimet ndaj rohingasve përmbushin 4 krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut sipas Konventës për Gjenocid (gjenocid, krime kundër njerëzimit, spastrim etnik dhe krime të luftës)

- Këshilli i sigurimit i OKB-së ka dështuar përballë krimeve dhe nuk arriti të miratonte asnjë rezolutë me efekt konkret
- “Përgjegjësia për të mbrojtur” dhe sovraniteti i njeriut, ende në pikëpyetje në rastin me rohingasit
- Vetoja e Kinës dhe Rusisë, bllokadë për ndërhyrje të komunitetit ndërkombëtar
- Interesat ndërkombëtare, pengesë edhe për ndërhyrje të njëanshme

2.4 Metodologjia e hulumtimit

Përgatitja e kësaj teze magjistrature kërkoi shfrytëzimin e metodave të ndryshme shkencore hulumtuese.

Si metoda kryesore të përdorura gjatë këtij punimi numërojmë:

- ato përshkruese, historike dhe krahasimore, përmes të cilave hodhëm një vështrim mbi shtetin e Mianmarit, sistemin politik dhe zhvillimin historik të tij, si dhe përvojat e mëparshme të ndërhyrjeve ndërkombëtare dhe dallimet konkrete të secilit rast.
- analizën, përmes dokumenteve dhe rezolutave të OKB-së për Mianmarin, raporteve të Human Rights Watch për krimet që janë bërë ndaj rohingasve, si dhe analizën e qëndrimeve të shteteve me vendimmarrje në Këshillin e Sigurimit.
- atë cilësore, përmes transkriptimit të qëndrimeve politike të bëra nga autoritetet vendimmarrëse, përfaqësuesit e tyre në OKB dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

2.5 Rëndësia e punimit

Rëndësia e këtij punimi është shumë dimensionale. Së pari, ai ka të bëjë me një çështje aktuale, në dukje - dështimin e komunitetit ndërkombëtar për të parandaluar shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut në përmasa të spastrimit etnik dhe gjenocidit, edhe përkundër promovimit të një rendi të ri botëror i cili e vendos sovranitetin njerëzor përpara atij shtetëror, sidomos përmes doktrinës R2P të OKB-së e cila si instrument arriti sukses nëpërmjet ndërhyrjes ndërkombëtare në parandalimin e gjenocidit në Libi.

Në këtë punim tregohet se interesat e Fuqive të Mëdha, për shumë politika ndërkombëtare, dallojnë nga rasti në rast... Aty ku kanë interes, shtetet sjellin bashkë njëzëri vendime, ndërsa aty ku nuk kanë, ato heshtin dhe vendimmarrja e tyre është e ngadaltë.

Ky punim ka rëndësi për studentët dhe qarqet akademike për t'i njohur ata nga afër me zhvillimet në Lindjen e Largët, veçanërisht me gjendjen dhe krizën e pakicës rohingase në Mianmar.

KAPITULLI I

3. MIANMARI DHE TRADITA E TIJ NË HISTORI

Mianmari, i quajtur ndryshe edhe si Burma, zyrtarisht Republika e Unionit të Mianmarit, është një shtet në Azinë Juglindore (Google Maps, 2020). Mianmari është vendi i njëmbëdhjetë në Azi për nga sipërfaqja, ndërsa në nivel botëror renditet i 40-ti për nga madhësia më një sipërfaqe prej 678.500 kilometra katrore. Ai kufizohet në verilindje me Kinën (2121 km), në lindje me Laosin (238 km), në perëndim me Bangladeshin (271 km), në veriperëndim me Indinë (1468 km), në juglindje me Tajlandën (2146 km), ndërkojë që në jug dhe jugperëndim ka dale në detin Andaman dhe në Gjirin e Bengalit.

Kryeqyteti i Mianmarit është Nay Pyi Taw-i, edhe pse kryeqendra tregtare është Yangon-i i cili deri në vitin 2006 ishte kryeqyteti i Mianmarit.

Pjesa më e madhe e relievit është terren malor me rrafshnaltë, fusha dhe rrafshina bregdetare. Përmes tyre kalon lumi Irrawady me gjatësi prej 1600 kilometra, prej të cilave 1000 janë të lundrueshme. Klima e Mianmarit është nëntropikale dhe karakterizohet me dimër të freskët, me sezon të nxehtë vere dhe sezon me shira, i shoqëruar nga monsunet. (Encyclopedia Britannica, 2020).

Mianmari ka rreth 54,5 milion banorë (Department of Population, 2020) dhe njihet si vend me diversitet të madh etnik. Grupet etnike të përfaqësuara janë burmanët (Burman) në masën 69%, shanët (Shan) 8,5 %, karenët (Karen) 6,2%, rakinët (Rakhine) 4,5%, si dhe minoritete të tjera siç janë çinët (Chin), monët (Mon), kaçinët (Kachin), rohingasit (Rohingya) që konsiderohen si pakicë pa shtetësi. Grupe etnike të huaja që jetojnë në Mianmar janë edhe kinezët (rreth 230 mijë), hindusët (rreth 430 mijë), bengalët (rreth 570 mijë) si dhe pakistanezët rreth (42 mijë). Mianmari nuk ka fe zyrtare! Afro 9/10 e popullatës ndjekin budizmin (burmanët dhe shanët), ndërsa një pjesë e pakicave ndjekin krishterimin protestant (karenët, çinët dhe kaçinët) si dhe pjesa tjetër ndjek islamin (rohingasit). Gjuha zyrtare në Mianmar është gjuha burmane e folur nga 65% e popullsisë. Gjuhë e dytë llogaritet anglishtja, edhe pse në vend fliten gati 100 gjuhë dhe dialekte të tyre nga ana e pakicave etnike (Birma, 2020).

3.1 Historia e hershme

Mianmari besohet se ka një histori të lashtë. Gërmimet e rralla arkeologjike kanë zbuluar pjesë të së kaluarës së hershme, të cilat mendohet se datojnë që 11 mijë vjet para erës sonë. Studiuesit thonë se kultura e Mianmarit është shënuar që fazën e ashtuquajtur Anyathian (të epokës së gurit) që ka marrë emrin nga rajoni i thatë, ku janë gjetur edhe gjurmët e vendbanimeve të hershme (Cooler, 2002). Sipas disa studiuesve kinezë, popullata e Mianmarit e ka origjinën nga grupi Qiang nga Kina e Lashtë, gjuha e të cilit ka shumë ngjashmëri me atë që do të flisnin më vonë popujt në Mianmar. Bazuar në këtë lidhje mes historisë dhe gjuhës, grupi Qiang i Kinës së Lashtë llogaritet si paraardhës i

Mianmarit. Ky grup kishte migruar në jug të Mianmarit, nga veriperëndimi i Kinës, disa shekuj para epokës së Krishtit, duke formuar grupet e para etnike (Tun, 2015).

Qytet-shtetet e para u krijuan në shekullin e dytë para erës sonë, falë fisit Pyu i migruar në jug të vendit. Kultura dhe gjuha e tyre tibeto-burmane, sipas historisë, ndikoi shumë nga tregtinë e asaj kohe me Indinë, prej nga u importua edhe budizmi si dhe koncepte të tjera kulturore dhe politike që do të formësonin organizimin politik e kulturor të mëvonshëm të Mianmarit (Myint-U, 2008, f. 51). Deri në shekullin IX, Mianmari numëronte të paktën tre qytet-shtete; Pyu në zonën qendrore, Mon përgjatë vijës bregdetare jugore dhe Arakan përgjatë bregdetit perëndimor.

Më vonë, nga fundi i shekullit IX, një vendbanim i vogël i quajtur Pagan, arriti që t'i unifikonte shumë rajone, dduke krijuar Perandorinë Pagane e cila qëndroi deri në shekullin XVI. Në gjysmën e dytë të të njëjtit shekull, ishte dinastia Taungoo (1510-1752) ajo që ribashkoi vendin dhe themeloi Perandorinë më të madhe në historinë e Azisë Juglindore. Dinastia Taungoo u zëvendësua nga dinastia Alaungpaya (1752-1885) duke u bërë perandoria e dytë më e madhe në historinë e Burmës së atëhershme. Kjo perandori vazhdoi reformat administrative të cilat ishin filluar që nga dinastia Taungoo, dhe ky rregullim shoqëror dhe administrativ njihet edhe si epoka e krijimit të shtetit modern të Burmës (Phayre, 2013).

3.1.1 Burma Britanike (1824-1948)

Zanafillat e shtetit të Mianmarit, sipas studiuesve, datojnë me tre luftërat e njëpasnjëshme anglo-burmane nga viti 1824 deri në 1948. Fillimisht, Burma mori karakterin e një province të Indisë Britanike (Dautremer, 1913, f. 47) dhe më pas, shndërrimin në një koloni të administruar në mënyrë të pavarur, duke i hapur rrugën më vonë, pavarësisht të saj, e njohur si Burma Britanike. Britanikët e ndanë provincën e Burmës nga India Britanike në vitin 1937 dhe i dhanë kolonisë një kushtetutë të re dhe autorizime të tjera. *Be Maw* u bë kryeministri i parë i Burmës dhe me këtë, ndikimi britanik filloi të tërhiqej (Cady, 1958, f. 37).

Lufta e Dytë Botërore nuk la pa përfshirë as Burmën e cila u pushtua nga Perandoria Japoneze në vitin 1942. Lufta solli shumë ndryshime, veçanërisht, shkatërrimin e një pjese të madhe të infrastrukturës dhe industrisë. Ajo nxiti eksodin e një numri të madh burmanësh drejt Indisë, ndërkohë që e gjunjëzuar, Burma iu dorëzua diktatit japonez. Lidhja me Japoninë nxiti fundin e kolonializmin dhe rrënoi iluzionin e paprekshmërisë Perëndimore dhe Britanike, duke çuar edhe në ngritjen e nacionalizmit burman (Steinberg, *Burma/Myanmar what everyone needs to know*, 2010, fv. 36-37).

3.1.2 Pavarësia e Burmës (1948-1962)

4 janari i vitit 1948 ishte dita kur Burma shpalli pavarësinë dhe u bë republikë e pavarur pasi një vit më herët mori pëlqimin nga Parlamenti i Britanisë së Madhe për Aktin

e Pavarësisë së Burmës (1947). Vendi mori emrin Unioni i Burmës (The Constitution of the Union of Burma, 1948).

Pas pavarësisë filluan kryengritjet nga komunistët e Ushtrisë Revolucionare të Burmës dhe Bashkimi Kombëtar i Karenit. Viti 1962 shënoi fillimin e sundimit totalitar dhe mbizotërimit politik të ushtrisë në Burma. Ushtria zëvendësoi qeverinë civile e quajtur Lidhja Anti-Fashiste Popullore, me Këshillin Revolucionar të Unionit në krye të të cilit ishte gjenerali Ne Win (Taylor R. H., 2009, fv. 255-256).

3.1.3 Sundimi ushtarak (1962-2011)

Grushti i shtetit që solli në pushtet Këshillin Revolucionar dhe gjeneralin Ne Win, pavarësisht se ishte trumbetuar se do të rivendoste rendin dhe do të ringrinte ekonomikisht vendin, në fakt instaloi socializmin (Silverstein, 1977, f. 81). Këshilli Revolucionar vuri në jetë, të ashtuquajturin plan afatgjatë “Rruga Burmane për Socializëm” ideologji që brenda saj përjashtonte pluralizmin politik. Në vitin 1974 u miratua kushtetuta e dytë e Republikës së Unionit të Mianmari, nën frymën e sundimit ushtarak të partisë së vetme – Partisë së Programit Socialist Burman (Smith M., Burma: Insurgency and the Politics of Ethnicity, 1991, f. 20). Pikërisht kjo periudhë do të shënonte edhe gjatë kësaj periudhe Mianmari bëhet një nga vendet më të varfra në botë.

Zgjedhjet e para të lira u organizuan në vitin 1990 ku partia e Aung San Suu Kyi – Lidhja Kombëtare për Demokraci - fitoi mirëpo Junta Ushtarake (Brooker, 2009, f. 52) nuk pranoi të hiqte dorë nga pushteti, deri në vitin 2011.

3.1.4 Reformat Demokratike (2011-2015)

Reformat lidhen me emrin e Aung San Suu Kyi, e cila që para zgjedhjeve të vitit 1990 ishte vendosur në arrest shtëpiak. Me shpërbërjen e juntës ushtarake në 2011, ajo u lirua. Shembulli i saj bëri që të krijohej Komisioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (Myanmar National Human Rights Commission, 2020) i cili amnistoi të gjithë të burgosurit politikë të juntës. Duke hedhur bazat për një demokraci liberale, Mianmari zhvilloi zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2015. Partia e Lidhjes Kombëtare për Demokraci e Aung San Suu Kyi fitoi me shumicë absolute në të dy dhomat e parlamentit kombëtar, duke çuar në zgjedhjen për herë të parë që nga grushti i shtetit të vitit 1962 të një presidenti jo-ushtarak, atë të Htin Kuaw (Moe & Ramzy, 2016).

3.2 Sistemi politik i Mianmarit

Kushtetuta e Republikës së Unionit të Mianmarit e vitit 2008 (kushtetuta e tretë e cila është në fuqi ende sot e kësaj dite) duhej t'i hapte rrugën demokratizimit të vendit, mirëpo, në fakt, ajo ishte thjesht një vazhdimësi e formave të deritanishme të një demokracie të kufizuar. Në kushtetutën e re u trajtuan vetëm privilegjet e ushtrisë (Linn, 2015) e cila i ruan sërish attribute dhe autorizime të jashtëzakonshme asaj. Këto privilegje

nuk u zbutën, përkundrazi, u legalizuan me aktin më të lartë shtetëror. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2015 e sollën Aung San Suu Kyi në krye të qeverisë së Mianmarit. Ajo kishte marrë çmimin Nobel (Bella, 2015) në vitin 1991, duke tërhequr vëmendjen e botës për përpjekjet e saj për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Mianmar. Por, tani, në krye të qeverisë që udhëheq, ajo përballet me kritika të rënda për shkelje të të drejtave të njeriut në përmasat e spastrimit etnik, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit ndaj njërit prej minoriteteve, atij rohingas (Ellis-Petersen, 2018) (më gjerësisht përgjatë studimit).

3.2.1 Pushteti legjislativ

Pushteti legjislativ ushtrohet nga Asambleja e Unionit (Pyidaungsu Hluttaw) e cila është e përbërë nga Dhoma e Lartë (Amyotha Hluttaw), e njohur ndryshe edhe si Dhoma e Nacionaliteteve, si dhe Dhoma e Ulët (Pyithu Hluttaw), e njohur edhe si Dhoma e Përfaqësuesve. Dhoma e Lartë përbehet nga 224 anëtarë, nga të cilat 168 zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe 56 emërohen nga Forcat e Armatosura të Mianmarit, ndërsa Dhoma e Ulët përbehet nga 440 anëtarë, nga të cilat 330 zgjidhen drejtpërdrejtë dhe 110 emërohen nga Forcat e Armatosura të Mianmarit (Myanmar Constitution, 2008).

3.2.2 Pushteti ekzekutiv

Sipas kushtetutës, Presidenti i Republikës së Unionit të Mianmarit është kreu i shtetit dhe kreu i qeverisë. Ai udhëheq ekzekutivin të quajtur Kabinet i Qeverisë ose Qeveria e Unionit, e cila është e përbërë nga Presidenti, Zëvendës presidentët, Ministrat dhe Prokurori i Përgjithshëm i Unionit. Presidenti i Mianmarit zgjidhet nga Kolegji Presidential Zgjedhor i Mianmarit i përbërë nga tre komitete të veçanta me përfaqësues nga dhoma e ulët, dhoma e lartë dhe komiteti i përbërë nga deputetët e emëruar nga forcat e armatosura. Secili komitet propozon nga një kandidat për president, dhe ai që merr më së shumti vota bëhet president, ndërsa dy të tjerët, zëvendës presidentë (Myanmar Constitution, 2008, f. 75).

Presidenti i shtetit *de jure* është udhëheqës i qeverisë, mirëpo *de facto* figura kryesore e shtetit është Këshilltari Shtetëror i Mianmarit, post i krijuar në vitin 2016 dhe shumë i ngjashëm me postin e Kryeministrit. Këshilltari Shtetëror nominohet nga Asambleja e Unionit ndërsa emërohet nga Presidenti i Shtetit. Ai ka mandat 5 vjeçar dhe vepron si një lidhje midis degës ekzekutive dhe legjislative (McKirdy, 2016).

3.2.3 Pushteti gjyqësor

Sipas kushtetutës pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, edhe atë nga Gjykata Supreme e Unionit, Gjykatat e Larta të Rajonit, Gjykatat e Larta të Shtetit, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat e Zonave të Vetadministruara, Gjykata Ushtarake, Gjykata Kushtetuese dhe gjykata tjera të përcaktuara me ligj (Myanmar Constitution, 2008, f. 125).

Sistemi gjyqësor i Mianmarit është i kufizuar dhe ai nuk e pranon juridiksionin e detyrueshëm të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Me këtë, nuk sigurohet asnjë garanci për një gjykim të drejtë publik, dhe gjyqësori nuk është i pavarur nga ekzekutivi (Ross, 2012).

3.2.4 Forcat e Armatosura të Mianmarit

Forcat e Armatosura të Mianmarit, të njohura ndryshe si Ushtria e Mianmarit (Tatmadaw), sipas kushtetutës së miratuar në vitin 2008, kanë fuqi të vendosin veto mbi çdo vendim thelbësor mbi politikën shtetërore. Neni 20 (b) i kushtetutës i jep ushtrisë autoritetin e plotë mbi ministrin e mbrojtjes, atij të punëve të brendshme dhe atij të kufirit, pasi i emëron të tre ministrat (Myanmar Constitution, 2008, f. 6).

Sipas kushtetutës Tatmadaw raporton drejtpërdrejt Këshillin Kombëtar për Siguri dhe Mbrojtje (NDSC) të udhëhequr nga Presidenti, i përberë nga 11 anëtarë, prej të cilëve 6 emërohen nga ushtria. Me këtë, de facto dhe de jure, ky këshill bëhet autoriteti më i lartë në qeverinë e Mianmarit. Këshilli ka kompetenca të fuqishme, siç janë ushtrimi i pushtetit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme (përfshi këtu kompetencat legislative dhe gjyqësore gjatë kësaj gjendjeje); miraton nominimin e Presidentit për Komandant të Përgjithshëm të Tatmadaw, koordinohet me Presidentin për të ndërmarrë veprimet ushtarake kundër agresorëve, rekomandon falje etj (Myanmar Constitution, 2008, f. 147).

Ushtria ka ndikim të madh në ekonominë e Mianmarit, pasi ajo kontrollon Korporatën Ekonomike Pronësore të Mianmarit (MEHC) dhe Korporatën Ekonomike të Mianmarit (MEC), konglomerate që janë jashtë sektorit publik dhe që punësojnë mijëra njerëz në bashkëpunim me firma të huaja (Steinberg D. , 2010, f. 164).

Po ashtu, përveç ndikimit të fuqishëm në sistemin shtetëror dhe atë ekonomik, Ushtria ka ndërtuar edhe një klasë të fuqishme kuadrosh të njëmendësisë, të cilët luajnë role shtyllë në administratë, një koncept ky krejtësisht i kundërt me atë perëndimor (Steinberg D. , 2010, f. 164)

3.2.5 Partitë Politike

Mianmari ka një sistem shumë-partiak ku garojnë afro 92 parti të ndryshme politike, por partitë më të mëdha janë Lidhja Kombëtare për Demokraci, Partia Kombëtare e Arakanit, Partia e Solidaritetit dhe Zhvillimit të Unionit dhe Lidhja e Kombësive të Shanit për Demokraci (Myanmar Times, 2015). Sipas nenit 407 të kushtetutës, çdo parti e cila direkt ose indirekt merr ndihma financiare nga qeveri të huaja, shoqata fetare ose filantropë nga ndonjë vend i huaj, nuk do të ketë asnjë të drejtë ekzistence (Myanmar Constitution, 2008, f. 165).

Përafërsisht dy të tretat e partive politike klasifikohen si parti etnike pasi burojnë nga grupe të caktuara etnike. Në këtë mënyrë, ato konkurrojnë me përfaqësues etnikë në zonat elektorale të vendit. Një tipar tjetër i partive politike të Mianmarit është se ato nuk janë të organizuara në baza religjioze ose klasore, edhe përkundër ndarjeve të forta

shoqërore dhe fetare (Stokke, 2020). Në fakt, sistemi partiak konsiston mes dy ndarjeve të përqendruara në proceset ndërtuese të kontestueshme, të kombit dhe shtetit, d.m.th., ka një përplasje mes koncepteve, shtet dhe komb.

3.2.6 Sistemi politik i Mianmarit sipas perëndimit

Sistemi politik në Mianmar, sipas organizatave të huaja konsiderohet si një demokraci *pjesërisht e lirë* (Freedom House, 2019). Po ashtu, në raportin e kësaj organizate, theksohet se zgjedhjet e fundit e lanë pa asnjë përfaqësues mysliman Asamblenë e re parlamentare në shtet. Nga ana tjetër, Amnesty International thekson se dhuna ndaj rohingasve është një nga njollat e qeverisë së Mianmarit. Qeveria nuk bëri asnjë përparim në krijimin e kushteve të favorshme për kthim të sigurt, dinjitar dhe vullnetar të 740 000 rohingasve që ikën në Bangladesh pas vitit 2017.

Rohingasit të cilët mbetën në shtetin Rakhine jetojnë në një sistem i ngjashëm me aparteidin, me arrestime, ndalime në mënyrë arbitrare të aktivistëve për të drejtat e njeriut, si dhe mosndëshkim ndaj autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, krime këto sipas të drejtës ndërkombëtare (Amnesty International, 2020).

3.3 Pasuria e Mianmarit, ekonomia dhe gjeopolitika e tij

Mianmari është një shembull i një vendi me ekonomi në zhvillim. Ajo është një prodhuese e rëndësishme e gazit natyror dhe naftës në Azi. Mianmari njihet si një nga prodhuesit më të vjetër të naftës në botë, madje ajo njihet për eksportin e fuçisë së saj të parë me karburant të papërpunuar në vitin 1853 (Ridd & Racey, 2015, fv. 1-3). Kufizimet financiare, mungesa e aftësive teknike, investimet e pamjaftueshme nga firma të huaja si dhe sanksionet ndërkombëtare e kanë penguar dukshëm Mianmarin të realizojë potencialin e tij të prodhimit të naftës dhe gazit natyror. Mirëpo, në vitin 2012, SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian i lehtësuan sanksionet ndaj Mianmarit, duke i hapur rrugën reformave politike dhe ekonomike. Shumë kompani të huaja investuan në industrinë e gazit dhe naftës, sikurse British Petrol, Shell, Total Sa dhe të tjera (Vakulchuk, Stokke, & Overland, 2018, f. 39).

Ndërsa, sa i përket rezervave të gazit natyror në Mianmar, ato arrijnë 283 miliard metra kub. Afro 70% e gazit eksportohet në Kinë dhe Tajlandë (Hlaing & Vakulchuk, 2017, f. 23)

Mianmari gjithashtu ka burime të mëdha gjeologjike, përfshirë bakrin, arin, mermerin, nikelin, zinkun etj., të cilët së bashku me gurët e çmuar si safirët dhe rubinët, përbëjnë një kapital të rëndësishëm në ekonominë e Mianmarit. Kontrolli mbi burimet natyrore është shkaku kryesor i konflikteve në zonat etnike ku edhe janë të përqendruara shumica e burimeve natyrore të vendit (Vakulchuk, Stokke, & Overland, 2018, f. 41).

Investitorët më të mëdhenj në Mianmar janë Kina, Vietnami, Singapori, Britania e Madhe, Hong-Kongu dhe Japonia, ndërsa kompanitë amerikane shpesh investojnë përmes zyrave të themeluara në Singapor ose në Korenë e Jugut (Hlaing & Vakulchuk, 2017, f. 10).

Eksportin më të madh të burimeve dhe mallrave Mianmari e realizon me Kinën 42,13 %, Tajlandën 18,35 %, dhe Indinë 7,87%, ndërsa importin më të madh të mallrave e realizon nga Kina 31,4 %, Singapori 15%, Tajlanda 11,1 %, Arabia Saudite 7,5 % (Central Intelligence Agency, 2020). Edhe përkundër këtyre fakteve, Mianmari llogaritet vend me shkallë të lartë të korrupsionit (Corruption Perception Index, 2019), ku rreth 30% e popullsisë jeton në varfëri.

Pozicioni gjeografik i Mianmarit bën një lidhje mjaft të rëndësishme në Gjirin e Bengalit, midis dy fuqive kryesore rajonale në Azinë Juglindore, Kinën dhe Indinë. Mianmari është i rëndësishëm për Kinën për arsye të ndryshme strategjike. Ai përbën një treg prej rreth 54 milion njerëzish për produktet kineze (Steinberg D. , 2010, f. 159). Gjithashtu rreth 80% e gazit dhe naftës që importohet në Kinë kalon nëpërmjet Mianmarit dhe ngushticës Malaka në gjirin e Bengalit (një nga rrugët detare më të mëdha të tregtisë në botë). Sa i përket bashkëpunimit tregtar bilateral midis Mianmarit dhe Kinës, vetëm gjatë vitit 2019 ai arriti në rreth 17,71 miliard dollarë, duke e bërë Kinën një ndër investitorët më të mëdhenj në Mianmar, sidomos me investime në fushën energjetike (3,6 miliard dollarë në hidrocentralet përgjatë lumit Irrawaddy (Aibing, 2011)).

Kina gjithashtu është partner strategjik (Fan & Steinberg, 2012) i Ushtrisë së Mianmarit, pasi ajo është furnizuesi më i madh i armëve dhe pajisjeve ushtarake të Tatmadaw.

Edhe India është gjithashtu një aktore me ndikim në rajon, me një histori të gjatë dhe të ndryshueshme sa i përket marrëdhënieve me Mianmarin. India është një treg i madh për eksportet e Mianmarit, në masën 25% të eksporteve të përgjithshme të Mianmarit. Pavarësisht se kjo i përshtatet më shumë Mianmarit, nga ana tjetër, edhe vetë India ka përfitim nga ky treg eksporti, për shkak se pengon rritjen e ndikimit të Kinës, sidomos në gjirin e Bengalit ku edhe ajo ka dalje (Vakulchuk, Stokke, & Overland, 2018, f. 33). Gjatë vitit 2017, India paralajmëroi plane për dëbimin e 40 000 refugjatëve rohingas që kishin ikur në Indi, duke i quajtur ata emigrantë të paligjshëm. Në këtë mënyrë, India u pozicionua si mbështetëse e politikës së ushtrisë së Mianmarit dhe dhunës që ajo kryente sistematikisht rohingasve (Kasturi, 2017).

SHBA-ja luajti një të rëndësishëm në Mianmar, duke qenë nxitësi kryesor për vendosjen e sanksioneve, të mbështetura edhe nga shtetet perëndimore gjatë viteve '90. Një pjesë e sanksioneve u hoqën vetëm pas ndryshimit të qeverisë së Mianmarit në vitin 2011 (Clymer, 2015). Synimi ishte të sanksionohej junta ushtarake në pushtet, të ndihmoheshin forcat demokratike të Mianmarit, konkretisht Lidhja Kombëtare për Demokraci si përfaqësuese legjitime e popullit (U.S Congress, 2003). Presidenti Obama hoqi zyrtarisht sanksionet pas konsultimeve me Aung Sang Suu Kyi në vitin 2016. Në vitin 2017 SHBA-ja vendosi në listën e zezë shefin e Komandës Perëndimore të Ushtrisë së Mianmarit, Maung Maung Soe i cili ishte përgjegjës për dhunën ndaj rohingasve. Ndërsa në vitin 2018, Departamenti Amerikan i Thesarit, miratoi sanksione ekonomike kundër 4 komandantëve

ushtarakë dhe policorë të Mianmarit, gjithashtu për shkak të rolit të tyre në dhunën ndaj rohingasve, e kualifikuar si spastrim etnik (U.S Department of the Treasury, 2018).

Marrëdhëniet bilaterale midis Rusisë dhe Mianmarit kanë më shumë se 60 vjet histori, me tone të përhershme pozitive (Ivashentsov, 2012, f. 159). Gjatë Luftës së Ftohtë, interesi i Rusisë në Mianmar udhëhoqej nga lufta ideologjike kundër Perëndimit. Sot, qëllimi kryesor i Rusisë është të sigurojë bashkëpunim ekonomik si dhe të përmirësojë pozicionin e saj në rajonin e Azisë Juglindore (Lutz-Auras, 2015). Bashkëpunimi midis dy vendeve është kryesisht në sektorin energjetik (pasi Mianmari ka rezerva të pasfrytëzuara gazi) si dhe në sferën e energjisë bërthamore. Edhe pse pati shqetësime nga bashkësia ndërkombëtare dhe SHBA-ja lidhur me këtë bashkëpunim, Rusia ka dhënë garanci se vëzhguesit e Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike do të jenë pjesë e çdo zhvillimi (Cotte, 2015).

Bashkëpunimi në sektorin ushtarak nuk është aspak i vogël, veçanërisht duke pasur parasysh situatën ku Mianmari nuk ka qasje në tregjet perëndimore për armë.

Vetëm Kina shet më shumë armë në Mianmar, megjithatë të dyja këto vende përbëjnë furnizuesit kryesor të armëve në Mianmar (SIPRI, 2016). Nga ana tjetër, sa i përket marrëdhënieve politike, dy shtetet kanë një forcim të mëtjshëm, sidomos pas vetos së Rusisë në vitin 2007 në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

3.4 Etnitë e tjera në Mianmar dhe Pakica e rohingasve

Mianmari është një shoqëri multi-etnike, multi-kulturore dhe multi-fetare me rreth 135 grupe etnike të ndryshme. Sot burmanët janë grupi më i madh etnik që përbëjnë 68% të popullsisë, ndërsa grupet e tjera etnike përbëjnë 32% të popullsisë së mbetur në Mianmar (Smith M., *Ethnic Groups in Burma*, 1994, f. 17) Grupet e pakicave etnike jetojnë në 7 shtetet e klasifikuara sipas përbërjes etnike, kryesisht të përqendruara afër zonave kufitare, ndërsa 7 rajonet dhe pjesa qendrore e Mianmarit janë të banuar me burmanët (Rieffel, 2010, f. 46).

Grupet etnike në Mianmar janë:

3.4.1 Shanët (*Shan*)

Shanët janë grup etnik të ardhur nga Kina në shekullin X dhe sot përbëjnë 9% ose afro 6 milion banorë të popullatës totale. Ato jetojnë në shtetin Shan, në pjesën lindore të Mianmarit dhe i përkasin religjionit budist. Për dekada të tëra, shanët ishin në luftë të armatosur me qeverinë e Mianmarit për shkak trajtimit çnjerëzor, torturave, përdhunimeve dhe konfiskimin e pronave nga qeveria e Mianmarit (Waddington, 2010).

3.4.2 Karenët (*Karen*)

Karenët janë grup etnik të cilët jetojnë në shtetin Karen, në pjesën jugore dhe juglindore të Mianmarit dhe përbëjnë 6% ose afro 4 milion banorë të popullatës totale.

Shumica e karenëve i përkasin religjionit budist, dhe një numër i vogël janë të krishterë dhe myslimanë. Edhe karenët, njësoj si edhe shanët kanë qenë dhe janë shënjestër e diskriminimit, torturimit, spastrimit të detyruar, ekzekutimeve jashtëgjyqësore nga autoritetet shtetërore të Mianmarit. Sot mbi 128 000 karenë jetojnë në kampe refugjatësh në kufirin Mianmar-Tajlandë (Karen Buddhist Dhamma Dhutta Foundation, 2010, fv. 7-10).

3.4.3 Monët (Mon)

Monët janë grup etnik të cilët jetojnë në shtetin Mon, në pjesën jugore të Mianmarit dhe përbejnë 2% ose afro 2 milion banorë të popullatës totale. Ata llogariten si pasardhës të civilizimeve më të lashta në Azinë Juglindore, të cilët besohet se kanë sjellë budizmin dhe shkrimin në Mianmar (Minority Rights International, 2020). Sikurse edhe pakicat e tjera edhe monët kanë qenë me dekada të shtypura nga qeveria e Mianmarit.

3.4.4 Çinët (Chin)

Çinët janë grup etnik të cilët jetojnë në shtetin Çin, në pjesën perëndimore të Mianmarit dhe shumica e tyre i përkasin fesë krishtere. Edhe kjo pakicë ka qenë shënjestër e persekutimeve të vazhdueshme etnike dhe fetare që nga koha kur gjeneral Ne Win rrëzoi qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike në vitin 1962. Në këtë shtet janë regjistruar krime të rënda kundër njerëzimit, të kryera nga ushtria Tatmadaw e Mianmarit. Zëri i tyre nuk është dëgjuar thuajse fare, nga frika e hakmarrjes nga ushtria e Mianmarit (Bagnall, 2010).

3.4.5 Rakinët (Rakhine)

Rakinët janë grup etnik të cilët jetojnë në shtetin Rakhine, në bregdetin perëndimor me dalje në gjirin e Bengalit dhe përbëjnë 4,5% të popullsisë së përgjithshme të Mianmarit. Në shtetin Rakhine jeton edhe pakica etnike myslimane rohingase (rohingya). Sipas disa studiuesve, ata janë indigjenë të shtetit, për disa të tjerë, ata janë një grup i krijuar gjatë migrimeve para-koloniale dhe koloniale, ndërsa qëndrimi zyrtar i qeverisë së Mianmarit është se ata janë emigrantë të paligjshëm që migruan në Arakan (tani Rakhine) pas pavarësisë së Burmës në vitin 1948 dhe pas luftës çlirimtare të Bangladeshit në vitin 1971.

Rohingasit myslimanë, paraardhësit e të cilëve kishin origjinë nga India dhe Bangladeshi, konsideroheshin si qytetarë të Burmës/Mianmarit në bazë të kushtetutës të vitit 1948 dhe administratës civile deri në grushtin e shtetit nga Ushtria në vitin 1962 (Minority Rights International, 2020).

Ata e humbën statusin e tyre pas miratimit të kushtetutës në vitin 1974 dhe ligjit për shtetësi të vitit 1982, ku thuhet se për t'u llogaritur shtetas i Mianmarit duhet që t'i përkasësh një prej 135 grupeve etnike, ose të paraqesësh dokument se paraardhësit e tu kanë qenë të vendosur në Burma/Mianmar që para vitit 1823.

Pra, që nga viti 1982, me humbjen e statusit të shtetësisë, rohingasit u bënë shënjestër e forcave ushtarake të Mianmarit, që i torturon, përdhunon, ekzekuton, ua shkatërron vendbanimet, i zhvendos dhe i dëbon me forcë rohingasit myslimanë. Rohingasve u është mohuar e drejta për martesë, për arsim, për t'u angazhuar në punë, si dhe të lëvizin lirshëm.

Në vitin 2012 filloi konflikti mes budistëve arakanez të shtetit Rakhine dhe rohingasve myslimanë, ku qindra myslimanë u vranë pas ndërhyrjes të ushtrisë Tatmadaw. Situata vazhdoi të përkeqësohej dhe në vitin 2017 më shumë se 700 000 rohingas u strehuan si refugjatë në Bangladesh, ndërsa qindra rohingas, mes të cilëve edhe fëmijë dhe gra u vranë kur forcat ushtarake së bashku me qytetarë të armatosur ndërhynë në fshatrat e banuar nga myslimanët rohingas. Kombet e Bashkuara akuzuan qeverinë e Mianmarit për spastrim etnik, ndërsa Amnesty International i quajti aktet, krime kundër njerëzimit (Bari, 2018).

KAPITULLI II

4. DHUNA NDAJ ROHINGASVE DHE SHENJAT E GJENOCIDIT DHE SPASTRIMIT ETNIK

Rohingasit u bënë të njohur për botën në vitin 2012, kur u bënë pre e sulmeve dhe masakrave të mëdha. Dhuna mes budistëve dhe rohingasve filloi në qershor, në katër qytetet veriore të shtetit të tyre, duke u përhapur brenda tetorit, edhe në 9 qytete të tjera. Akti që nxiti këtë valë dhune ishte qarkullimi i një raporti të detajuar nëpër media, rreth një përdhunimi të dyshuar dhe vrasjes së Ma Thida Htwe, një gruaje budiste rakine 28-vjeçare, nga tre myslimanë më 28 maj të vitit 2012 në fshatin Kyaw Ne Maw (Wade, 2017, f. 103). Gjashtë ditë më vonë, në shenjë hakmarrjeje, një grup i madh budistësh ndaluan një autobus që transportonte udhëtarë dhe rrahën deri në vdekje 10 myslimanë (Marshall, 2012) para syve të ushtrisë dhe policisë, të cilët nuk ndërmorën asgjë për ta ndaluar aktin.

Policia arrestoi përdhunuesit dhe më vonë raportoi se njëri prej tyre kishte bërë vetëvrasje gjatë përpjekjes së arrestimit. Dy të mbeturit u shpallën fajtor dhe u dënuan me vdekje nga gjykata (CNN, 2012). Nga ana tjetër qeveria formoi një komision prej 16 zyrtarësh, i kryesuar nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme Kyaw Zan Myint, për të hetuar shkakun e masakrës së 10 myslimanëve, mirëpo më deri sot, komisioni nuk ka zbuluar ndonjë gjetje.

Pas vrasjeve, qindra rohingas myslimanë dogjën disa shtëpi të budistëve në qytetin Maungdaw. Kjo hapi një sërë ngjarjesh të tjera, duke shkaktuar vrasjen dhe djegien e shtëpive nga të dyja palët në të gjithë shtetin Rakhine. Më 10 qershor, nga frika se trazirat mund të përhapeshin përtej kufijve të shtetit Rakhine, presidenti i Mianmarit Thein Sein shpalli gjendje të jashtëzakonshme duke marrë në dorë pushtetin (BBC NEWS, 2012).

Forcat ushtarake edhe pse ishin të pranishme, nuk ndërhynë aspak në parandalimin e dhunës, madje, ato filluan sulmet ndaj myslimanëve, duke detyruar në shpërnguljen e të paktën 100 000 rohingasve nga shtëpitë e tyre, dhe duke bërë arrestime masive të burrave rohingas në të gjithë shtetin. Nga ana tjetër, udhëheqësit lokal të shtetit Rakhine, së bashku me murgjit budistë, në vazhdimësi kërkonin izolimin ekonomik dhe shoqëror të rohingasve myslimanë, duke bërë thirrje të qarta për spastrim etnik të myslimanëve nga zonat ku ata jetojnë (Human Rights Watch, 2012).

Disa ditë më vonë, presidenti i Mianmarit Thein Sein informoi Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) se rohingasit përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare dhe se ata duhet të zhvendosen në ndonjë shtet të tretë që është i gatshëm t'i pranojë ata. Kjo nënkuptonte ngritje të kampeve në Bangladesh, mirëpo UNHCR-ja e hodhi poshtë menjëherë një propozim të tillë (Naing, 2012).

Edhe përkundër provave të përfshirjes së policisë dhe ushtrisë në trazirat e qershorit, Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja vlerësuan fillimisht se forcat e sigurisë po e trajtonin në mënyrë të përshtatshme dhunën midis rohingasve dhe budistëve në shtetin Rakhine (Reuters, 2012). Në fund të qershorit vala e parë e dhunës pësoi rënie, ndërkohë presidenti Thein Sein krijoi një komision 27 anëtarësh, për të hetuar ngjarjet e dhunës dhe për të gjetur zgjidhje për bashkësitë me përkatësi të ndryshme fetare, për të jetuar qetë dhe në

harmoni. Raporti përfundimtar i këtij komisioni nuk arriti t'i trajtonte abuzimet dhe përgjegjësitë nga autoritetet shtetërore për shkeljet e të drejtave të njeriut, dhe nga tjetër fajësoi rohingasit për dëmtimin e imazhit "të mirë" të Mianmarit përballë bashkësisë ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Ministria e Punëve të Jashtme e Mianmarit, në një deklaratë për media, mohoi përfshirjen e forcave të sigurisë dhe autoriteteve lokale në dhunën mes rakinëve budistë dhe rohingasve myslimanë, dhe mohoi çfarëdoj diskriminimi fetar dhe racor në shtetin Rakhine, siç kishin akuzuar shumë media dhe organizata joqeveritare (Smith M. , 2014, f. 42).

Fatkeqësisht, ngjarjet e qershorit ishin vetëm paralajmërim i një vale më të madhe sulmesh në tetor. Murgjit budistë lëshuan pamflete duke kërkuar nga rakinët etnikë t'i ndërprisnin të gjitha lidhjet ekonomike me rohingasit, të mos u shisnin mallra dhe të mos shoqëroheshin me ta. Në pamflete shkruhej gjithashtu se rohingasit ishin duke planifikuar zhdukjen e rakinëve budistë, të vidhnin tokat e tyre, ndërsa zgjidhja e vetme ishte ndarja dhe evitimi i çdo kontakti me myslimanët rohingas (Human Rights Watch, 2012).

Një valë e re dhune filloi në tetor, pas një raporti për vrasjen e dy budistëve dhe dy ushtarëve me armë zjarri nga myslimanët (The Economist, 2012). Dhuna e filluar më 22 tetor në nëntë qytete të shtetit Rakhine zgjati një javë. U dogjën xhamitë lokale dhe shtëpitë, gjë që i detyroi rohingasit të zhvendoseshin. Sipas disa dëshmitarëve, sulmet fillestare nuk u kryen nga vendasit që ata njihnin, por nga njerëz të ardhur nga jashtë (Human Rights Watch, 2013). Një nga masakrat më të rënda ndodhi në fshatin Yan Thei më 23 tetor, në orën 6:30 të mëngjesit. Sulmi vijonte nga ngjarjet e një dite më parë, kur policia lokale (Lon Thein) i kishte çarmatosur rohingasit nga shkopinjtë dhe disa armë të lehta. Edhe përkundër premtimeve të policisë për mbrojtje nga turma e budistëve, një gjë e tillë nuk ndodhi – rohingasit myslimanë u lanë në mëshirë të dhunës së rakinëve budistë. Masakra përfundoi me të paktën 80 myslimanë të vdekur, 28 prej të cilëve ishin fëmijë, përfshi edhe nën moshën 5 vjeçare (Ibrahim A. , 2016, f. 100).

Human Rights Watch (2013) zbuloi prova edhe për katër varreza masive në shtetin Rakhine; tre datonin nga dhuna e qershorit dhe një nga masakra e tetorit.

Kontributi kryesor i forcave të sigurisë gjatë masakrave të tetorit ishte zhvendosja e rohingasve nga shtëpitë e tyre duke përdorur presion, si dhe mosndërhyrja për të parandaluar masakrën e cila bëhej para syve të tyre nga ekstremistët budistë.

Sidoqoftë, niveli i dhunës së ushtruar dhe masakrave të kryera në qershor dhe tetor tërhoqi vëmendjen e ndërkombëtarëve. Presidenti Thein Sein u detyrua nga mesi i nëntorit t'i shkruante letër Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Ban Ki-mun, duke pranuar se kishte pasur dhunë në qershor dhe tetor në shtetin Rakhine. Në të njëjtën letër, presidenti i Mianmarit jepte garancinë se do t'i trajtonte problemet me zhvendosjen e detyruar të rohingasve, si dhe premtonte pajisjen me shtetësi të të gjithë rohingasve (United Nation, 2013).

Koha e këtij premtimi nuk ishte e rastësishme! Ajo ndodhi pikërisht para vizitës së Presidentit të SHBA-së Barak Obama në Mianmar, e cila ishte e para e një presidenti amerikan në Mianmar (New York Times , 2012). Një fjalimin e tij në Universitetin e Yangonit, Obama paralajmëroi rrezikun e dhunës së vazhdueshme në shtetin Rakhine. Ai

theksoi se kjo dhunë ka shkaktuar shumë vuaajtje, persekutim e varfëri, ndërsa nënvizoi se rohingasit kanë të njëjtin dinjitet sikurse gjithë të tjerët. Obama përkujtoi se edhe SHBA-ja është komb i emigrantëve që vijnë nga çdo pjesë e botës, mirëpo ka disa parime që janë universale, që zbatohen për të gjithë njerëzit, pavarësisht prejardhjes apo fesë që ata praktikojnë (The Obama White House, 2012).

Valët e dhunës së qershorit dhe shtatorit në shtetin Rakhine rezultuan me mbi 100 000 rohingas myslimanë të shpërngulur nëpër kampet e refugjatëve brenda Mianmarit, mbi 200 rohingas të vdekur dhe me mijëra të shpërngulur në Tajlandë dhe Malajzi. Organizata dhe agjenci të shumta humanitare u përballen me kërcënime nga nacionalistët rakinë dhe me kufizimet nga ana e qeverisë, në qasjen më të afërt të të prekurit, për shkak të vonës së vizave për hyrje në Mianmar (Fan & Saleem, 2012).

Mirëpo, hetimi nga organizatat e huaja nuk ishte fundi i dhunës, por fillimi i shkeljeve akoma të rënda të të drejtave të njeriut në përmasa të gjenocidit dhe spastrimit etnik në Mianmar.

Në zona më të largëta, siç ishte fshati Maungdaw kishte shpërthime të herëpashershme të dhunës dhe persekutime nga autoritetet lokale dhe ekstremistët budistë. Me qindra rohingas u vranë, u përdhunuan, u arrestuan dhe u dërguan në vende të panjohura (Muslim Lawyers Association South Africa, 2014, f. 34). Gazetarëve dhe Organizatave Jo-Qeveritare iu mohuara hyrja në fshatin Maungdaw, ndërsa OKB-së iu lejua hyrja vetëm nën mbikëqyrjen shtetërore (Quintana, 2014).

Në këtë kontekst, ndjenja anti-myslimane filloi të rritej në të gjithë Mianmarin. Tani, shënjestër nuk ishin vetëm rohingasit por edhe bashkësitë e tjera myslimane. Në fillim të vitit 2013, dhuna u përhap në pjesën qendrore të Mianmarit. Ngjarja më e rëndë ndodhi në qytetin Meiktila më 20 mars, ku një mosmarrëveshje mes një banori mysliman, pronar i një dyqani ari, rezultoi me sulm ndaj një klienti budist dhe gruas së tij (Wade, 2017, f. 140).

Në shenjë hakmarrjeje, një turmë e madhe budistësh shkatërroi dyqanin. Në mërmë një murg budist që nuk ishte i përfshirë në incidentin e mëparshëm, u tërhoq nga biçikleta e tij, u lye me benzinë nga gjashtë banorë myslimanë të cilët i vunë flakën të gjallë pranë një xhamie (Szep, 2013). Vrasja brutale e murgut budist e përshkallëzoi ashpër situatën, duke rritur në masë të madhe intensitetin dhunës. Në trazirat që zgjatën dy ditë, qindra shtëpi myslimane u shkatërruan, duke lënë të paktën 44 njerëz të vdekur përfshirë edhe masakrën e 32 nxënësve dhe 4 mësuesve në shkollën islamike Mingalar Zayone (International Crisis Group, 2013, f. 12). Disa ditë më vonë, dhuna u përhap jashtë qytetit Meiktila, në qytetet Oh The Kone, TatKone dhe Yamenthin, të banuara me myslimanë (BBC NEWS, 2013).

Përgjigjja e forcave të sigurisë gjatë këtyre ngjarjeve ishte e paqartë dhe e papërshtatshme. Dëshmitarë të shumtë përshkruanin se si forcat e sigurisë qëndruan pa ndërmarre asnjë veprim për të parandaluar budistët – myslimanët vazhdonin të vriteshin përpara syve të tyre (BBC NEWS, 2013). Presidenti Thein Sein shpalli për herë të dytë gjendjen e jashtëzakonshme dhe vendosi trupa ushtarake për të qetësuar situatën në Meiktila dhe qytete të tjera ku u përhap dhuna midis budistëve dhe myslimanëve (International Crisis Group, 2013, f. 13).

Dhuna u përhap edhe në shtetet e tjera ku kishte grupe etnike që i përkisnin fesë myslimane, siç janë shanët dhe myslimanët kinezë të njohur si Panthay. Dinamika kryesore e nxitjes së këtyre ngjarjeve ishte aleanca midis murgjve ekstremistë të lëvizjes “969” dhe të ashtuquajturit grupi i murgjve nacionalist “Ma Ba Tha” i financuar drejtpërdrejtë nga ushtria e Mianmarit – Tatmadaw (Zaw, 2019).

Më 21 maj, shtatë myslimanë, përfshirë edhe pronarin e dyqanit të arit dhe ata që kryen vrasjen e murgut budist, u dënuan me burg nga 2 deri 28 vjet për nxitje të dhunës. Ndërsa në korrik të të njëjtit vit, gjykatat dënuan 25 murgj budistë deri në 15 vjet burg për vrasje dhe krimet gjatë trazirave në Maiktila ku u vranë mbi 44 myslimanë. Rreth 12 000 myslimanë u shpërngulen nga trazirat mes budistëve dhe myslimanëve në Maiktila, dhe tani jetojnë në strehimore të improvizuara në vende të ndryshme të Mianmarit (The Guardian, 2013).

Përderisa dhuna e vitit 2012 ishte mes ekstremistëve budist dhe rohingasve myslimanë, dhuna e vitit 2013 nuk ishte e përqendruar vetëm kundër rohingasve në shtetin Rakhine por edhe kundër të gjithë myslimanëve që jetonin në Mianmar, pavarësisht se cilit grup etnik i takonin dhe në cilin shtet apo rajon jetonin.

Rohingasit myslimanë u izoluan nga pjesa tjetër e shoqërisë burmane, duke u shpërngulur nëpër kampe refugjatësh ose në zona të izoluar, në kushte të rënda jetese dhe pa qasje në ndihmat urgjente humanitare.

Ato u bënë më “të huaj” për pjesën tjetër të njerëzve të Mianmarit, pa të drejta ligjore për mbrojtje që shtetet zakonisht ua garantojnë qytetarëve të tyre (Ibrahim A. , 2016, f. 106). Niveli i dhunës në shtetin Rakhine ra pas vitit 2013, mirëpo persekutimi dhe përjashtimi i rohingasve vazhdoi. Në vitin 2014, në mediat e Mianmarit qarkulloi një plan i hartuar nga qeveria e shtetit Rakhine dhe pastaj i dekretuar nga presidenti i shtetit Thein Sein, i quajtur ndryshe “Planveprimi i Shtetit Rakhine”, i cili kishte për qëllim rindërtimin dhe zhvillimin e shtetit Rakhine pas konflikteve midis budistëve dhe rohingasve myslimanë (Human Rights Watch, 2014). Planveprimi i Shtetit Rakhine kishte gjashtë pika: Sigurinë, Stabilitetin dhe Sundimin e Ligjit, Rehabilitimin dhe Rindërtimin, Zhvendosjen e Përhershme, Vlerësimin e Shtetësisë, Zhvillimin Socio-Ekonomik dhe Bashkëjetesën Paqësore (International Crisis Group, 2014, fv. 35-36).

Plani nuk përmbante rikthimin e rohingasve nga kampet e zhvendosura brenda për brenda shtetit, në shtëpitë e tyre. Përkundrazi, aty përshkruhej një plan për zhvendosjen e rohingasve nga kampet brenda shtetit, nëpër zona të përhershme në vende të paspecifikuara rreth Mianmarit. Sipas planit, duhej të bëhej edhe një vlerësim i shtetësisë të rohingasve bazuar në ligjin për shtetësi të vitit 1982, si dhe kërkohej që të bëhej edhe një regjistrim i rohingasve si “bengalë”. Rohingasit që nuk pranuan të regjistrohen dhe identifikoheshin si “bengalë” u vendosën në kategorinë e atyre që kundërshtojnë përcaktimin e shtetësisë sipas ligjeve ekzistuese, duke iu mohuar menjëherë e drejta e shtetësisë. Plani synonte ndërtimin e kampeve “të përkohshme” për ata që refuzonin të regjistroheshin dhe ata që nuk kishin dokumente adekuate. Sipas Human Rights Watch (2014), vendosja në kampe përbën ndalesë arbitrare dhe të pabazë, me mundësinë për

depërtim të tyre (Bookbinder A. , Rakhine Action Plan a 'Blueprint for Segregation and Statelessness', 2014).

Human Rights Watch e quajti planin, një skicë për izolim të përhershëm dhe lënie pa shtetësi të rohingasve, që siç duket, ishte projektuar për t'i përzënë ata sa më shpejt nga Mianmari (Human Rights Watch, 2014).

Më 12 nëntor, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-mun, në një konferencë për shtyp gjatë një samiti të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN), të mbajtur në Mianmar, në fjalimin e tij mbështeti të drejtat e rohingasve për vetë-identifikim dhe kërkoi nga qeveria e Mianmarit të merrte qëndrim të qartë kundër persekutimit të pakicave. Ai kërkoi po ashtu nga qeveria që të rishikonte procedurat për shtetësinë e rohingasve, që sipas tij, nuk ishin në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ban Ki-mun këshilloi autoritetet që të respektonin të drejtat e njeriut, të merrnin qëndrim kundër nxitjes dhe t'u siguronin rohingasve qasje të ndihmat humanitare (Bookbinder A. , UN Sec-Gen Urges Rohingya Rights, 2014).

Një ditë më vonë, zyrtarë të qeverisë së Mianmarit, kritikuan Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-mun për përdorimin e fjalës *rohingas* dhe thirrjet e tij për trajtim më të mirë të pakicës myslimane që është pa shtetësi. Zëvendësministri i Punëve të Jashtme Thant Kyaw dhe kryeministri i shtetit Rakhine Maung Maung Ohn, njëkohësisht ish gjeneral i ushtrisë së Mianmarit -Tatmadaw, thanë se nuk e pranojnë terminologjinë që përdor OKB-ja për myslimanët bengalë - “rohingas” - duke shtuar se përdorimi i këtij termi mund të ketë ndikim të dëmshëm në përpjekjet për bashkëjetesën mes komuniteteve myslimane dhe budiste (Mon, 2014).

Mjerimi sistematik i rohingasve në Mianmar nxiti një krizë të madhe refugjatësh. Ata u detyruan të kërkonin strehim në vendet fqinje, Bangladesh, Tajlandë dhe Malajzi. Kjo krizë tërhoqi vëmendjen e shtypit ndërkombëtar në maj të vitit 2015. Kriza e refugjatëve e vitit 2015 nuk ishte rezultat i ndonjë vendimi politik apo i ndonjë shpërthimi të ri të dhunës, por një proces natyror që ndodh kur qeniet njerëzore jetojnë në kushte të mjerueshme (Ibrahim A. , 2016, fv. 107-108). Shumë rohingas u bënë pre e trafikantëve të qenieve njerëzore, të cilët me anije i transportonin ata në vendet fqinje. Zyrtarë të qeverisë së Mianmarit deklaruan se kjo krizë refugjatësh është vetëm një trafikim njerëzor dhe jo përndjekje për shkak të diskriminimit politik ose fetar (Slodkowski, 2015). Autoritetet e Mianmarit, edhe përkundër presioneve të shumta nga bashkësia ndërkombëtare për t'u ulur dhe gjetur zgjidhje për çështjen e krizës së refugjatëve, refuzuan të merrnin pjesë në samitin rajonal të Shoqatës së Kombeve të Azisë Juglindore në Tajlandë, me të vetmin argumentim: në vend të termit “rohingas” të përdorej termi “emigrantë të paligjshëm” (Al Jazeera, 2015). Pasi u siguruan se termi “rohingas” nuk do të përdoret dhe në vend të tij do të përdorej termi “emigrantë të paligjshëm”, autoritetet e Mianmarit pranuan të merrnin pjesë në samitin e organizuar nga Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore në Bangkok. Vendet aziatike u pajtuan të punonin së bashku për të ndaluar krizën e emigrantëve si dhe të trajtonin shkaqet kryesore të migracionit. Mianmari, gjatë samitit, i hodhi poshtë kategorikisht pretendimet se ajo është fajtori kryesor i krizës së refugjatëve (BBC NEWS, 2015).

Më 8 nëntor 2015 në Mianmar u mbajtën zgjedhjet e para të përgjithshme demokratike (Human Rights Watch, 2015), ndërsa rohingasve nuk iu lejua të merrnin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme as si kandidatë dhe as si votues, për shkak të mungesës së shtetësisë dhe dokumenteve të identifikimit (The Guardian, 2015). Zgjedhjet i fitoi partia e Lidhjes Kombëtare për Demokraci, në krye me ikonën e demokracisë kombëtare, fituesen e çmimit nobel Aung San Suu Kyi, e cila kishte ngritur pritshmëritë për ndryshim të politikave të deritanishme ndaj myslimanëve (Ramzy, 2015). Mirëpo, ajo që pasoi ishte një retorikë e ngjashme sikurse edhe e qeverisë së mbështetur nga ushtria. Qeveria e re i quajti rohingasit “emigrantë të paligjshëm” që duhet të kthehen në Bangladesh (Ramzy, 2015).

Edhe komuniteti ndërkombëtar priste që qeveria e re të bënte përpjekje rreth përmirësimit të gjendjes me shkeljet e të drejtave të njeriut ndaj rohingasve myslimanë (Bari, 2018, f. 49).

Gjatë vitit 2015 edhe Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut publikoi një raport ku thuhej se rohingasit janë privuar nga e drejta për shtetësi. Rohingasit kishin pësuar diskriminim sistematik dhe kufizime të ashpra për lëvizje, ndërsa përgjigjja e Aung San Suu Kyi ndaj komisionarit ishte se qeveria e saj do t'i shmangte përdorimit të termit “rohingas” (The Guardian, 2016).

Gjendja filloi të përkeqësohej gjatë vitit 2016, më saktësisht më 9 tetor, kur një grup i armatosur sulmuan dhe vranë nëntë policë kufitarë në shtetin Rakhinë (International Crisis Group, 2015).

Përgjegjësinë për sulmin dhe vrasjen e policëve e mori grupi kryengritës i cili i referohej vetes si “Harakan Al Yaqin” që në përkthim do të thotë “Lëvizja Besimi” (Lewis, 2016). Më vonë, grupi u njoh me emrin Ushtria e Shpëtimit të Rohingasve nga Arakani (“Arakan Rohingya Salvation Army-ARSA”) (Edroos, 2017). Ushtria u përgjigj duke dërguar trupa ushtarake, me justifikimin se do të ruante paqen dhe stabilitetin, por në fakt nisi operacionin e krehjes së popullatës për asgjësimin e kryengritësve (Wright & Berlinger, 2016).

Sulmet e ushtrisë së Mianmarit, sipas Amnesty International, shkuan përtej asaj që duhej ndërmarrë si kundërpërgjigje proporcionale ndaj kërcënimit të sigurisë së vendit. Po ashtu, edhe Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut theksonte se ushtria ishte përgjegjëse për shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut, përfshirë vrasje të paligjshme, përdhunime dhe forma të tjera torturimi, djegie të shtëpive dhe fshatrave ku jetonin rohingasit (Amnesty International, 2016). Rreth 87.000 rohingas ikën në Bangladesh për të shpëtuar nga operacionet ushtarake, ndërsa rreth 400 rohingas u vranë gjatë operacioneve ushtarake që zgjatën deri në dhjetor të vitit 2016 (Aljazeera, 2016).

Aung San Suu Kyi u kritikua ashpër nga komuniteti ndërkombëtar për heshtjen e saj, mosveprimin, si dhe për dështimin në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ushtria. Përgjigja e saj për situatën ishte se nuk ekziston vend pa probleme me të drejtat e njeriut (Broomfield, 2016).

Në mars të vitit 2017, Komisioni Këshillëdhënës për shtetin Rakhinë, i formuar një vit më parë nga Aung San Suu Kyi dhe ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Anan për të gjetur dhe propozuar zgjidhje për krizën, lëshoi një raport me rekomandime të

përkohshme. Komisioni e dorëzoi raportin e tij përfundimtar tek autoritetet e Mianmarit më 23 gusht me rekomandime për veprim urgjent dhe të qëndrueshëm për të parandaluar dhunën, si dhe inkurajonte pajtimin dhe ofrimin e një ndjenje të shpresës për popullatën e shtypur nga shteti (Advisory Commission on Rakhine State, 2017).

Por, disa orë pas publikimit të raportit më 25 gusht, ushtria e shpëtimit të rohingasve nga Arakani (ARSA) sulmoi 24 pika kontrolli kufitare, stacione policore dhe baza ushtarake në Maungdaw dhe qytete të tjera në pjesën veriore të shtetit Rakhine, duke lënë të vrarë 10 policë dhe 1 ushtar. Kjo situatë shkatërroi mundësinë për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Këshillëdhënës (Bari, 2018, f. 50). Ajo që pasoi ishte një reagim brutal i ushtrisë së Mianmarit duke shënjestruar jo vetëm anëtarët e Ushtrisë së Shpëtimit të Rohingasve nga Arakani (ARSA) por edhe gjithë popullsinë rohingase në pjesën veriore të shtetit Rakhine. Sipas Amnesty International, ushtria bëri vrasje të paligjshme, përdhunime dhe krime të tjera seksuale, djegie të qëllimshme të fshatrave ku jetonin rohingasit, krime serioze kundër njerëzimit sipas Amnesty International (Amnesty International, 2017).

Autoritetet e Mianmarit i mohuan edhe akuzat e OKB për spastrim etnik. Qeveria, ushtria dhe nacionalistët budistë u përpoqën të bindin botën se veprimet e tyre ishin vetëm një operacion kundër ARSA-së në shtetin Rakhine dhe se veprimet ishin të nevojshme për sigurinë kombëtare. Deri në fillim të dhjetorit të vitit 2017, numri i refugjatëve rohingas që kishin lënë Mianmarin, që nga 25 gushti kishte arritur në 688 000 (Inter Sector Coordination Group, 2018).

Sipas hetimeve të Associated Press (Encyclopedia Britannica, 2020), në vitin 2017, të paktën pesë varreza masive me civilë rohingas u zbuluan në fshatin Gu Dar Pyin. Sipas të intervistuarve në kampet e refugjatëve në Bangladesh, të cilët i kishin mbijetuar masakrës, ushtria e Mianmarit kishte vrarë mbi 400 rohingas. Shumë prova për këtë masakër ishin filmuar me telefona celularë dhe mbanin vulë kohore. Qeveria e Mianmarit e mohoi masakrën në fshatin Gu Dar Pyin, dhe tha se në operacion ishin vrarë vetëm 10 terroristë, të cilët ishin varrosur po aty (Klug, 2018).

Një masakër tjetër ndodhi në fshatin Maung Nu, në shtetin Rakhine, nga ushtria e Mianmarit. Më 27 gusht 2017, ushtria ekzekutoi dhjetëra rohingas myslimanë, akt ky i notuar edhe nga Human Rights Watch me intervistimin e 14 të mbijetuarve dhe dëshmitarëve rohingas të ikur në kampet e refugjatëve në Bangladesh (Human Rights Watch, 2017). Të paktën 82 rohingas u vranë në fshatin Maung Nu, ndërsa ushtria e Mianmarit përsëriti qëndrimin se *asnjë i pafajshëm nuk është vrarë* (Pitman, 2017).

Një ndër masakrat më të rënda ndodhi në fshatin Tula Toli të shtetit Rakhine, afër kufirit me Bangladeshin. Imazhet satelitore të siguruar dhe analizuar nga Amnesty International vërtetuan se i gjithë fshati ku jetonin rohingasit myslimanë u dogj, ndërsa nga ana tjetër vendet ku jetonin rakinët budistë nuk u prekën fare (Holmes, 2017). Më 30 gusht 2017, ushtria e Mianmarit kishte bllokuar të gjitha pikat e daljes nga fshati Tula Toli, ndërsa kryeplaku i fshatit Aung Ko Sein u kishte kërkuar rohingasve që të mblidheshin në një vend më të sigurt, sepse shtëpitë e tyre do të digjeshin (Rahman, 2018).

Dëshmitarë dhe të intervistuar të ngjarjeve në Tula Toli theksonin se afro 1 000 - 2 000 rohingas ishin mbledhur përsëri kur filloi sulmi. Ushtria e Mianmarit vrau qindra

rohingas, përdhunoi dhe vrau gra dhe fëmijë, si dhe i vuri zjarrin të gjitha shtëpive të rohingasve në Tula Toli. Autoritetet e Mianmarit vazhduan me bllokimin e vizave për agjencitë dhe grupet e huaja hetimore për të drejtat e njeriut, përfshi hetuesit e Kombeve të Bashkuara, për të zbardhur masakrën në fjalë (Human Rights Watch, 2017).

Më 2 shtator 2017, ushtria e Mianmarit së bashku me rakinët budistë vranë 10 rohingas myslimanë në fshatin Inn Din të shtetit Rakhine. Tre fotografi të siguruar nga një i moshuar budistë i fshatit tregojnë momentet kryesore të masakrës në fshatin Inn Din; arrestimin e burrave rohingas nga ushtarët si dhe ekzekutimin e tyre. Ushtria e Mianmarit më vonë pranoi vrasjen, praninë e varrit masiv, por e dredhoi arsyetimin duke thënë se viktimat janë terroristë bengalë. Më 12 dhjetor 2017 autoritetet e Mianmarit arrestuan dy gazetar të Reuters-it Wa Lone dhe Kyaw Soe Oo, të cilët hetonin në mënyrë të pavarur këtë masakër. Nën akuzën për posedim të dokumenteve të klasifikuara, ata u shpallën fajtor dhe u dënuan me nga 7 vjet burg, përkundër kritikave ndërkombëtare. Ato u liruan në vitin 2019 pas një falje nga presidenti Win Myint dhe fituan një sërë çmimesh ndërkombëtare për raportimin e tyre për masakrën e Inn Dinit (Lone & Oo, 2018).

Sipas një studimi të vitit 2018, më shumë se 24 000 rohingas u vranë nga ushtria e Mianmarit dhe nga budistët lokalë që kur filluan operacionet e spastrimit në 25 gusht 2017. Studimi gjithashtu konstatoi se mbi 18 000 gra dhe vajza rohingase ishin përdhunuar, 116 000 rohingas u rrahën ndërsa 36 000 rohingas u hodhën në zjarre (Habib, Jubb, & et.al, 2018, p. 69). Më herët sipas një raporti të organizatës “Mjekët pa kufij”, të paktën 6 700 rohingas, përfshirë edhe 730 fëmijë nën moshën 5-vjeçare u vranë vetëm në muajin e parë të sulmeve ushtarake ndaj rohingasve (The New York Times, 2017).

Forcat e sigurisë në Mianmar vazhduan të kryenin abuzime të rënda ndaj rohingasve myslimanë edhe gjatë vitit 2018, duke e thelluar krizën humanitare dhe atë të të drejtave të njeriut në shtetin Rakhine. Bashkimi Evropian dhe Kanadaja vendosën sanksione për 7 zyrtarë ushtarakë lidhur me përfshirjen e tyre në operacionet e spastrimit në shtetin Rakhine. Shtetet e Bashkuara vendosën gjithashtu sanksione financiare dhe udhëtimi për 4 komandantë të ushtrisë dhe dy njësi ushtarake. Këshilli i OKB-së për të drejtat e njeriut, në shtator të vitit 2017, miratoi një rezolutë të hartuar nga Bashkimi Evropian dhe Organizata e Bashkëpunimit Islamik, duke vendosur një mekanizëm për të mbledhur, ruajtur dhe analizuar provat e krimeve të rënda të kryera në Mianmar (Human Rights Watch, 2019).

Qeveria e Mianmarit edhe gjatë vitit 2019 vazhdoi të kundërshtonte thirrjet ndërkombëtare për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut kundër rohingasve myslimanë në shtetin Rakhine. Misioni fakt-gjetës i pavarur ndërkombëtar, i themeluar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara (UNHRC, 2019), gjeti prova të mjaftueshme për të kërkuar nga OKB-ja hetimin e zyrtarëve të lartë ushtarakë të Mianmarit, për krime kundër njerëzimit dhe gjenocidit të ushtruar ndaj myslimanëve etnikë rohingas (Human Rights Watch, 2020).

Sipas kryetarit të këtij misioni Marzuki Darusman, Mianmari kishte dështuar ta parandalonte gjenocidin, hetuar atë si dhe të miratonte një legjislacion efikas që ta gjonte e ndëshkonte gjenocidin. Sipas Darusman, kërcënimi i gjenocidit vazhdon ende për 600 000

rohingasit e mbetur në shtetin Rakhine. Misioni fakt-gjetës, në raportin e tij përfundimtar, i bënte thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së se Mianmari duhet të paraqitet para Gjykatës Penale Ndërkombëtare, ose, të krijohet një gjykatë ad-hoc, si gjykatat e krijuara për ish Jugosllavinë dhe Ruandën (UNHRC, 2019).

Më 11 nëntor 2019, Gambia ngriti padi para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë kundër Mianmarit, për shkelje të Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Aung San Suu Kyi i hodhi poshtë akuzat e gjenocidit ndaj rohingasve dhe kërkoi nga gjykata ta heqë çështjen nga lista e saj (Human Rights Watch, 2020).

Pavarësisht provave të shumta që tregojnë përgjegjësinë e forcave të sigurisë së Mianmarit për shkeljen e të drejtave të njeriut, Këshilli i Sigurimit ende mbetet i paralizuar, duke e bërë të pamundur referimin e Mianmarit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe vendosjen e sanksioneve për zyrtarët ushtarakë dhe shtetëror të implikuar në krimet e rënda ndaj rohingasve (Human Rights Watch, 2020).

4.1 Gjenezë e problemit mes budistëve dhe rohingasve myslimanë në Mianmar

Rohingasit myslimanë, sikurse përmendëm më sipër, janë grup etnik që jeton në shtetin Rakhinë në bregdetin perëndimor të Mianmarit. Ata pohojnë se janë popull indigjen dhe se me shënjë kanë jetuar në këtë vend, ndërsa qëndrimi zyrtar i qeverisë së Mianmarit është se ata janë emigrant të paligjshëm të ardhur nga Bangladeshi, për shkak edhe të karakteristikave të tyre të ngjashme kulturore dhe fizike që ndajnë me bengalët (Kosem & Saleem, 2016, f. 212).

Identiteti kombëtar i Mianmarit ka qenë gjithnjë i ndërthurur ngushtë me budizmin. Para kolonizimit, mbretërit budistë sundonin pjesën më të madhe të Burmës, ndërsa gjatë sundimit britanik, të gjitha shkollat ku mësohej budizmi u shkatërruan. Kjo krijoi një armiqësi ndaj *jo-budistëve* e cila u përdorë gjatë periudhës të sundimit ushtarak për të forcuar autoritetin dhe legjitimitetin budist ndaj të tjerëve, një lidhje mes budizmit dhe identitetit kombëtar të Mianmarit. Kushdo që kundërshtonte qeverinë, kundërshtonte edhe budizmin.

Sot budizmi vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në shoqërinë burmane. Murgjit nderohen dhe shërbejnë në pozicione udhëheqëse të aparatit shtetëror. Edhe pse budizmi njihet si fe paqësore në botë, budistët dhe murgjit janë përgjegjës për dhunën e përhapur në Mianmar, veçanërisht ndaj rohingasve myslimanë si dhe ndaj të gjitha pakicave jo-budiste (Warzone Initiatives, 2015).

Gjatë periudhës së sundimit britanik (1824-1948) pati një valë migrimi të punëtorëve myslimanë nga India dhe Bangladeshi në Mianmar, e cila aso kohe administrohej si provincë e Indisë Britanike. Për një periudhë 40-vjeçare, popullsia myslimane në Burma u trefishua. Britanikët u prematuan rohingasve një shtet autonom në këmbim të mbështetjes së tyre në Luftën e Dytë Botërore, ndërsa nacionalistët budistë (rakinët) të Mianmarit mbështetën japonezët. Kështu, pas luftës, britanikët shpërblyen rohingaset me poste prestigjioze qeveritare (Bari, 2018). Pas pavarësisë në vitin 1948, qeveria e konsideroi si të paligjshëm migracionin e ndodhur gjatë sundimit britanik. Si

pasojë e kësaj erdhi edhe ndarja e shtetit Rakhine në zonat myslimane dhe budiste. Kjo ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve për rohingasit, prej nga filloi shkelja e te drejtave të tyre nga qeveria dhe nacionalistët budistë për më shumë se 6 dekada të tëra (Human Rights Watch, 2000).

Dy akte madhore shkelën të drejtat e rohingasve: Ligji Emergjent i Emigrimit (1974) dhe Ligji për Shtetësinë (1982). Ligji Emergjent i Emigrimit kërkonte që të gjithë qytetarët të mbanin një kartë identiteti të quajtur Certifikata Kombëtare e Regjistrimit. Rohingasit ishin të papërshtatshëm për këto karta dhe atyre iu lejua vetëm Karta e Regjistrimit për të Huaj. Ligji për Shtetësinë kufizoi të drejtën e shtetësisë vetëm për ata që konsideroheshin burmanë të vërtetë, duke përjashtuar rohingasit nga tre kategoritë për fitimin e shtetësisë dhe duke mos i përfshirë ata në grupin e 135 grupeve etnike zyrtare (Warzone Initiatives, 2015).

Budizmi nga ana tjetër njihet si fe paqësore e cila e ndalon dhunën si mjet në zgjidhjen e konflikteve. Sidoqoftë në historinë e budizmit ka pasur akte dhune, të drejtuara, të promovuara ose të frymëzuara nga budistët (Jerryson & Juergensmeyer, 2010).

Historikisht, në shtetin Rakhine, budistët dhe myslimanët kanë shkaktuar dhunë njëri-tjetrit, përfshirë djegien e xhamive në zonat budiste dhe manastiret në zonat myslimane (The Rakhine Inquiry Commission, 2013).

Gjithashtu, ekziston një besim i fort midis budistëve se nëse budistët nuk e mbrojnë vendin dhe nuk ndërmarrin masa kundër presionit demografik të bengalëve myslimanë, atëherë Mianmari dhe pjesa tjetër e Azisë Juglindore do të pushtohet nga myslimanët. Pavarësisht nëse kjo bindje është e pranueshme ose jo, ajo është marrë si e vërtetë nga një pjesë e madhe e popullsisë në Mianmar, duke shkaktuar midis budistëve, frikë nga rohingasit myslimanë (International Crisis Group, 2017, f. 7). Kjo çoi në krijimin e lëvizjeve nacionaliste anti-myslimane në Mianmar: “Lëvizja 969” dhe “Lëvizja MaBaTha” (Foxeus, 2019).

Lëvizja 969 është një lëvizje nacionaliste budiste anti-myslimane (Walton & Hayward, 2014, f. 12), e cila është e përkrahur nga murgjit, zyrtarët qeveritarë dhe popullsia më e gjerë. Kjo lëvizje i ka rrënjët e saj ideologjike në një libër të shkruar në vitin 1990 nga U Kyaw Lwin, një ish funksionar në ministrin e Çështjeve Fetare, dhe rregullat sipas librit burojnë nga një besim tradicional në numerologji (Bookbinder A. , 2013). Myslimanët në Azinë Juglindore paraqesin frazën “*bismillah-ir-rahman-ir-rahim*” (“Në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit”) me numrin 786 (Waqar, 2015) dhe e përdorin këtë numër sidomos në bizneset për të treguar se ato janë pronësi të myslimanëve. Nga ana tjetër, ithtarët e lëvizjes 969 e shohin këtë numër si një dëshmi se myslimanët do të pushtojnë Mianmarin në shekullin XXI, bazuar në premisën e pakuptueshme se 7 plus 8 plus 6 është e barabartë me 21 (Palatino, 2013).

Numri 969 ka për qëllim të jetë i kundërt me 786 dhe nënkupton nëntë atributet e veçanta të Budës, gjashtë atributet e mësimave të tij dhe nëntë atributet e veçanta të murgërisë (Kamal, 2014). Lëvizja u drejtua nga murgu i shquar Ashin Wirathu i cili u burgos në vitin 2003 për nxitje të urrejtjes anti-myslimane dhe më pas u lirua në vitin 2010 nën një amnisti të përgjithshme. Pas lirimit, ai drejtoi një tubim murgjish në Mandalay për

të mbrojtur planin e presidentit Thein Sein për të spastruar ose dëbuar rohingasit në një vend të tretë. Fjalimet e tij frymëzuan nisjen e dhunës në vitin 2012 në shtetin Rakhine midis budistëve dhe rohingasve myslimanë (Hodal, 2013). Disa nga aktivitetet kryesore të kësaj lëvizjeje janë retorika ekstreme për bojkotimin e bizneseve myslimane, ndalimin e martesave të grave budiste me myslimanë si dhe tentativa për krijimin e shkollave të së dielës për mësim të doktrinës budiste 969 (Bookbinder A. , 2013).

Lëvizja MaBaTha e quajtur ndryshe Organizata për mbrojtjen e racës, kombit, fesë dhe shpërndarjes së Budizmit (Walton & Hayward, 2014, f. 14), u krijua në vitin 2012 si pasardhëse e lëvizjes 969, me degë dhe struktura në të gjithë vendin. MaBaTha shërbeu si një grup politik dhe vazhdoi me retorikën nacionaliste dhe ekstreme anti-myslimane sikurse lëvizja 969. Një nga temat kryesore të organizatës me të cilën ajo fitoi mbështetje të masave më të gjerë e budistëve në Mianmar ishte se *Islami është i pandarë nga Xhihadi* (Htun, 2020). Nga aktivitetet më të rëndësishme të kësaj organizate janë fushatat për promovimin e katër ligjeve që mbrojnë “racën dhe fenë” kundër “islamizimit” të Mianmarit (Frydenlund, 2018).

Në paketën e ligjeve që u miratua në parlament dhe u nënshkrua nga presidenti Thein Sein në vitin 2015 përfshihej:

- Ligji për Kontrollin e Popullsisë i cili u jepte qeverisë fuqinë për të zbatuar masa kontrolli ndaj popullsisë në zonat e përcaktuara nga presidenti, të cilat kanë dëndësi të lartë të popullsisë, natalitet të lartë, vdekshmëri të nënave dhe foshnjave gjatë lindjes, varfëri ose pasiguri ushqimore. Dispozitat e këtij ligji kishin për qëllim të aplikoheshin veçanërisht në shtetin Rakhine me shumicë myslimane, për të kufizuar çiftet myslimane që mos të kenë më shumë se dy fëmijë.
- Ligji i Veçantë i Martesave për Gratë Budiste sipas të cilit për çdo martesë të një gruaje budiste me një burrë jo-budist duhet të bëhet kërkesë e veçantë në regjistrin e bashkisë, i cili do ta shfaqë atë publikisht për 14 ditë. Pas miratimit të martesës, sipas dispozitave të ligjit, burri duhet të lejoj që gruaja të ndjekë lirshëm besimin e saj budist dhe të mos përpiqet ta konvertoj atë. Në të kundërtën, për shkelje të këtij ligji, burri do të dënohet me 3 vjet burg ose me konfiskim të pasurisë së përbashkët dhe humbje të kujdestarisë së fëmijëve.
- Ligji i Konvertimit Fetar sipas të cilit një person i cili dëshiron të konvertohet në një fe tjetër, duhet të jetë i moshës madhore, të konvertohet vullnetarisht dhe të aplikojë për leje para Bordit Shqyrtues dhe Regjistrues të Konvertimit Fetar. Personi që kërkon konvertimin në fe tjetër do të intervistohet nga ky bord.
- Ligji për Monogami sipas të cilit përbën vepër penale që një person të ketë më shumë se një bashkëshort ose të jetoj me një partner të pamartuar që nuk është bashkëshort, ose të angazhohet në pabesi martesore. Ky ligj ishte përgjigje për praktikën e poligamisë në bashkësitë myslimane, për mbrojtjen e grave budiste nga burrat jo besnikë (White, 2015).

Ligjet tërhoqën vëmendjen ndërkombëtare, pasi ato jo vetëm që kishin qëllime diskriminuese dhe shënjestronin myslimanët, por shkelnin edhe dispozitat kushtetuese të Mianmarit për lirinë fetare dhe mosdiskriminimin (International Crisis Group, 2017, f. 12).

Lëvizja MaBaTha gjatë vitit 2017 u riemërua si Fondacion Buddha Damma Parahita dhe vazhdoi aktivitetet nacionaliste (Myint, 2019). Lëvizja 969 dhe Organizata MaBaTha luajtën një rol të rëndësishëm në nxitjen e urrejtjes dhe dhunës midis budistëve nacionalistë dhe rohingasve myslimanë në shtetin Rakhine. Pacifizmi budist u zëvendësua me nacionalizëm ekstrem në Mianmar, me arsyetimin se Budizmi është i rrezikuar me zhdukje nga Islami. Mirëpo, siç thekson Mark Juergensmeyer, ekspert për dhunën fetare, “nëse islami, një traditë fetare, emri i të cilës do të thotë paqe, mund të shoqërohet me dhunë (nga ekstremistët), nuk duhet të çuditemi që ka budistë të zemëruar që bëhen edhe më të dhunshëm (Longstreath, 2013).

4.1.1 Zhvillimi i gjenocidit dhe spastrimit etnik ndaj popullit rohingas në shtetin rakhine

Bota ka njohur shumë gjenocide deri më sot. Pa përmendur ato të shekujve të mëparshëm apo gjatë sundimeve të perandorive të ndryshme, njerëzimi mban mend ato të ndodhura pas Luftës së Dytë Botërore; masakrat në Bosnjë, Ruandë, Kamboxhia, Darfur, Libi etj.

Termi “gjenocid” për herë të parë u përmend në vitin 1944 nga studiuesi dhe juristi polak Raphael Lemkin. Termi në fakt, bashkon fjalën greke *genos* që do të thotë racë, komb, fis dhe fjalën latine *cide* që do të thotë vrasje ose shfarosje (Lemkin, 1944, f. 79). Më 9 dhjetor 1948, Kombet e Bashkuara zyrtarizuan mbrojtjen nga ky krim përmes Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Gjenocid nënkupton shkatërrimin e vazhdueshëm dhe me paramendim, në tërësi ose pjesërisht, të një grupi etnik, kombëtar, racor ose fetar. Sipas kësaj konvente, i dënueshëm nuk është vetëm gjenocidi, por edhe tentativa (komploti) për kryerje të gjenocidit, nxitja e drejtpërdrejtë dhe publike e kryerjes së gjenocidit, përpjekja për të kryer gjenocid si dhe bashkëpjesëmarrja në kryerjen e këtij krimi (Genocide Convention, 1948).

Gjenocidi konsiderohet krim në të drejtën ndërkombëtare si në kohë lufte ashtu edhe në kohë paqeje, dhe si i tillë, nga shtetet palë kërkohet që ta parandalojnë dhe ndëshkojnë atë (Genocide Convention, 1948). Konventa e përcakton gjenocidin në cilindo prej pesë kategorive të akteve të kryera me qëllim të shkatërrimit të një grupi etnik, kombëtar, racor ose fetar (Genocide Convention, 1948). Aktet e numëruara janë:

- a) vrasja e anëtarëve të grupit (që përfshin vrasje të drejtpërdrejta dhe veprime që shkaktojnë vdekje);
- b) lëndimi i rëndë fizik ose mendor i anëtarëve të grupit (që përfshin shkaktimin e traumave ndaj anëtarëve të grupit përmes ushtrimit në masë të gjerë të torturave, përdhunimeve, dhunës seksuale, gjymtimit etj.);
- c) nënshtrimi ose vënia qëllimisht e grupit në kushte të tilla që synojnë zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij (që përfshijnë ndalimin me paramendim të

burimeve të nevojshme për mbijetesën fizike të grupit, mbajtja nëpër kampe e grupit, shpërngulja me forcë nga trojet e tyre etj.);

- d) ndërmarrja e masave që kanë për qëllim frenimin e lindjeve brenda grupit (që përfshinë ndalimin e martesës, mbajtjen për një kohë të gjatë veçmas të burrave dhe grave me qëllim për të parandaluar fertilitetin etj.);
- e) transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga njëri grup në tjetrin (që përfshin imponimin përmes forcës së drejtpërdrejtë ose përmes frikës së dhunës, burgosjes, presionit psikologjik apo metodave të tjera shtrënguese) (Genocide Convention, 1948).

4.1.1.1 Rohingasit si grup i numëruar

Karakteristikat dhe historia e rohingasve dëshmojnë se ata përbëjnë një grup etnik kombëtar, etnik, racor ose fetar sipas Konventës së Gjenocidit. Megjithatë zyrtarët e Mianmarit e kontestojnë praninë historike të rohingasve në vend, historianët gjurmajnë praninë e rohingasve në shtetin e tanishëm Rakhine qysh në shekullin IX (Yegar, 1972, f. 2).

Referenca e parë me shkrim në gjuhën angleze me emrin “rohingya” u shfaq në një etnografi koloniale britanike të vitit 1799 ku shkruante “Muhamedanë, të cilët janë vendosur prej kohësh në Arakan dhe që e quajnë veten “Rooinga”, ose vendas të Arakan (Buchanan, 1799, f. 215).

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, rohingasit përkrahën britanikët kundër pushtimit japonez, me të cilët ishin aleatë budistët rakinë. Historia e rohingasve që nga shekulli IX e deri në mesin e shekullit XX dëshmon se grupi ndan lidhje historike të dallueshme, dhe kështu bie brenda kategorisë së grupit kombëtar të Konventës së Gjenocidit.

Për më tepër, rohingasit flasin një gjuhë të veçantë dhe dalluese nga gjuhët e tjera që fliten në shtetin Rakhine dhe Mianmar. Rohingasit janë grupi i vetëm që flasin gjuhën rohingase. Gjuha dalluese e rohingasve mbështet përfundimin se ato formojnë një grup etnik të mbrojtur nga Konventa e Gjenocidit.

Rohingasit gjithashtu formojnë grup të mbrojtur në bazë të fesë së tyre, sepse ata janë kryesisht myslimanë. Qeveria e Mianmarit, së bashku me rakinët lokalë, vazhdimisht e ka mbështetur ndjenjën anti-myslimane. Si shembull për këtë, në një prezantim gjatë një stërvitjeje ushtarake, ushtria e Mianmarit paralajmëroi për rreziqet e rritjes së popullsisë myslimane në vend (Nyi Pyi Taw Divisional Military Headquarters, 2012, f. 4). Murgjit në shtetin Rakhine dhe në të gjithë vendin luajtën rol të rëndësishëm në krijimin e një klime që nxiti diskriminimin dhe dhunën nga qytetarët budistë kundër myslimanëve. Murgu i shquar Wirathu thoshte se myslimanët po orkestrojnë një plan për ta kthyer Mianmarin në një vend mysliman, duke dashur ta shkatërrojnë budizmin (Fisher, 2013). Feja e rohingasve luan një rol në përndjekjen e tyre. Mirëpo për shkak se ekzistojnë grupe të tjera myslimane në Mianmar, të cilat janë gjithashtu subjekt diskriminimi (por me përmasa jo kaq mizore), nuk është vetëm feja ajo që përbën bazën e persekutimit të rohingasve. Në këtë kontekst, feja është veç një pjesë e rëndësishme e identitetit rohingas si një grup i veçantë (Lowenstein, 2015, f. 43).

Qeveria e Mianmarit dhe e shtetit Rakhine nuk i referohet rohingasve me emrin e tyre, sepse duke bërë kështu, do t'i legjitimonte ata si grup etnik vendas në Mianmar. Në vend të kësaj, ata i referohen atyre si “bengalë”, në mënyrë që të theksojnë pretendimet e qeverisë se rohingasit janë emigrantë të paligjshëm të kohëve të fundit (Human Rights Watch, 2013, f. 110). Në Mianmar, termi “bengalë” përdoret ekskluzivisht për rohingasit. Mospranimi i rohingasve dhe karakterizimi i tyre si “bengalë” tregon se qeveria i trajnon ata si një grup dallues.

Sipas të gjitha attributeve të notuara më sipër, rohingasit përbejnë një grup nën Konventën e Gjenocidit. Ata ndajnë një histori, kulturë dhe gjuhë të përbashkët, ndërkohë që shteti dhe komuniteti shumicë burman i konsideron ata si një grup dallues (Lowenstein, 2015, f. 44).

4.1.1.2 Aktet si element i krimit të gjenocidit

Vrasja e anëtarëve të grupit

Konventa e Gjenocidit e identifikon vrasjen e anëtarëve të grupit si një akt të ndaluar gjenocidal. Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ruandën e ka kualifikuar aktin e vrasjes kur përmbushen dy elemente: 1) se viktimat ka vdekur dhe 2) se vdekja ka ardhur nga një veprim ose mosveprim i paligjshëm i të akuzuarit. Gjykata ka konstatuar gjithashtu se përcaktimi i përgjegjësisë penale për gjenocid me aktin e vrasjes së anëtarëve të grupit kërkon që 1) autori i krimit të ketë vrarë me dashje një ose më shumë anëtarë të grupit, pa nevojën e paramendimit dhe 2) viktimat ose viktimat t'i përkasin një grupit të caktuar etnik, kombëtar, racor ose fetar (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 147). Ndërsa Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ish Jugosllavinë e ka kualifikuar “vrasjen”, pa sqarime sikurse në rastin e Ruandës, duke u mbajtur vetëm me faktin nëse akti ka qenë i qëllimshëm dhe jo domosdoshmërisht i paramenduar (International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia, 2003, f. 146).

Përfshirja e forcave të sigurisë së shtetit në masakrat ndaj rohingasve i plotëson kërkesat për vërtetimin e kryerjes së aktit të ndaluar të vrasjes së një grupi në mbrojtje. Shumë refugjatë rohingas si dhe agjenci të OKB-së, organizata të të drejtave të njeriut dhe ekspertë të pavarur, kanë raportuar se Ushtria e Mianmarit dhe Forcat e Policisë ishin të përfshira në përdorimin e dhunës vdekjeprurëse kundër rohingasve në shtetin Rakhine. Dëshmitarë të shumtë kanë raportuar se forcat e sigurisë kanë qëlluar dhe vrarë civilë rohingas, në vend që të ndërhyjnë në mbrojtje të tyre (Lowenstein, 2015, f. 45). Ushtria dhe Policia e Mianmarit, me mbështetjen e rakinëve budistë, kryen një ndër masakrat më të mëdha në fshatin Tula Toli, ku dhjetëra ushtarë qëlluan, therën dhe dogjën për vdekje qindra civilë rohingas (Fortify Rights, 2018, f. 83).

Mosveprimi i forcave të sigurisë së shtetit për të frenuar, hetuar ose ndëshkuar dhunën lokale kundër rohingasve përbën gjithashtu shkelje të Konventës së Gjenocidit. Shumë dëshmitarë kanë raportuar se Ushtria e Mianmarit dhe policia kanë qëndruar duarkryq ndërsa budistët e shtetit Rakhine sulmonin dhe masakronin rohingasit. Pas

vrasjeve, forcat e sigurisë asgjësonin trupat e rohingasve në mënyrë që të pengonin hetimet. Edhe pse dhuna e vitit 2012 dhe 2017 në shtetin Rakhine vrau kryesisht civilë rohingas, autoritetet shtetërore ndoqën penalisht vetëm rohingasit, jo budistët rakinë për dhunën. Veprimet e tilla të pushtetit si dhe mosveprimi në parandalimin e dhunës së kryer në Mianmar përshtaten brenda kategorisë së aktit ndaj “anëtarëve të grupit” (Lowenstein, 2015, f. 46).

Lëndimi i rëndë fizik ose mendor i anëtarëve të grupit

Sipas Konventës së Gjenocidit, akti i dytë i ndaluar është lëndimi i rëndë fizik ose mendor i anëtarëve të grupit. Sipas Gjykatës Ndërkombëtare Penale për Ruandën, “lëndimi i rëndë fizik ose mendor” mund të shkaktohet si pasojë e “akteve të torturës, qofshin ato trupore ose mendore, trajtimit çnjerëzor ose degradues, ose persekutimit” (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 130). Edhe pse Konventa e Gjenocidit nuk përshtin akte specifike të ndaluara që shkaktjnë lëndimin fizik ose mendor, Gjykatat Penale Ndërkombëtare për Ruandën dhe Ish-Jugosllavinë kanë kualifikuar një numër të madh aktesh jo-fatale, duke përfshirë torturat, përdhunimet, dëbimin dhe trajtimin çnjerëzor, për t’u përshtatur në këtë kategori (International Criminal Court, 2011, f. 2). Rastet e torturimit të rohingasve përbëjnë akte të lëndimit të rëndë trupor dhe mendor. Sipas raporteve hetimore dhe vëzhgimeve të agjencive të huaja, Ushtria e Mianmarit ka rrahur dhe torturuar burra dhe gra rohingas. Autoritetet qeveritare kanë përdorur gjithashtu torturën si një mjet tjetërsimin e identitetit të rohingasve, ose zhveshjen e tyre nga identiteti real. Organizata ndërkombëtare “Projekti Sentinel për Parandalimin e Gjenocidit” raportoi që forcat e sigurisë së Mianmarit torturuan civilë rohingas derisa ata pranuan të regjistroheshin si “bengalë” (The Sentinel Project for Genocide Prevention, 2013, f. 28). “Projekti Sentinel” raporti gjithashtu se Ushtria dhe Policia e Mianmarit kanë një histori të gjatë të krimeve të luftës, përfshirë edhe torturat dhe përdhunimet. Torturat ndaj rohingasve përmbushin kualifikimin e të drejtës ndërkombëtare për aktin e ndaluar të lëndimit të rëndë fizik ose mendor të anëtarëve të grupit.

Aktet e dhunës seksuale të kryera ndaj grave dhe vajzave rohingase cilësohen gjithashtu si lëndim i rëndë fizik dhe mendor. Forcat e sigurisë së shtetit u përfshinë në përdhunime sistematike dhe përdhunime bandash gjatë operacioneve të spastrimit të udhëhequra nga ushtria. Sipas një raporti të Human Right Watch, forcat e sigurisë së Mianmarit përveç përdhunimit, përdorën edhe akte të tjera dhune; rrahën dhe poshtëruan gratë dhe vajzat rohingase (Human Rights Watch, 2017). Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën e ka krahasuar përdhunimin me torturat duke thënë se “si tortura ashtu edhe përdhunimi përdoren për qëllime frikësimi, degradimi, poshtërimi, diskriminimi, kontrolli ose shkatërrimi të një personi”. Ashtu si torturat ashtu edhe përdhunimi përbëjnë një shkelje të dinjitetit personal (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 149).

Nënshtrimi ose vënia qëllimisht e grupit, në kushte të tilla që synojnë zhdukjen e plotë fizike ose të pjesëshme të tij

Sipas Konventës së Gjenocidit, vënia e grupit në kushte të tilla që synojnë zhdukjen e plotë ose të pjesshme të tij përbën akt të ndaluar. Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën e kualifikoi këtë dispozitë si metodë të shkatërrimit me të cilën autori i veprës nuk vret menjëherë anëtarët e grupit, por që, në fund të fundit, akët e tij synojnë shkatërrimin fizik të viktimave të dhunës, pra vdekjen e ngadaltë të viktimave ose grupit.

Këto metoda mund të përfshijnë gjithashtu “nënshtrimin e një grupi njerëzish në *dietë jetese* (mos qasje të ushqimi dhe uji), dëbim sistematik nga shtëpitë, si dhe reduktim të shërbimeve bazë mjekësore (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 131). Ndalimi me paramendim i burimeve të nevojshme për mbijetesën fizike si ushqimi ose shërbimet bazë mjekësore dhe mbajtja e kontrolluar nëpër kampe, kanë për qëllim nënshtrimin e grupit në kushte që synojnë zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij (International Criminal Court, 2011, f. 3). Dëbimi i rohingasve nga shtëpitë e tyre nëpër kampe të zhvendosura brenda dhe jashtë Mianmarit dhe mohimi i kujdesit mjekësor, ushqimit, mjeteve themelore higjienike etj., përbëjnë kushte të tilla jetese që synojnë t'i shkatërrojnë rohingasit si grup. Dhuna dhe zjarrvëniet në shtetin Rakhine shkatërrojnë shtëpitë e rohingasve, ndërkohë që urdhëresat që ndalonin kthimin e tyre në to dhe pozicionimi i tyre në kampe, ishin prova e duhur që vërtetnin këtë kualifikim të aktit gjenocidal. Organizata të shumta për të drejtat e njeriut i përshkruanin kampet e zhvendosura brenda vendit, si geto të pajetueshme (Stoakes, 2013).

Forcat qeveritare rregullonin dhe kontrollonin hyrje-daljet nga kampet, ndërsa në raportet ditore të Këshillit Danez të Refugjatëve regjistroheshin dështime të qeverisë për të ofruar ushqim, ujë, mjete sanitare si dhe kujdes mjekësor (Danish Refugee Council, 2014).

Forcat e sigurisë i pengonin gjithashtu rohingasit të largoheshin nga kampet e zhvendosura për të kërkuar punë, ushqim dhe ndihmë mjekësore. Rohingasit që jetojnë në veri të shtetit Rakhine, të cilët nuk u shpërngulën nga dhuna e vitit 2012, vuajnë ende në kushte të tilla që synojnë shkatërrimin e tyre. Rohingasve të mbetur aty nuk u lejohet lëvizja e lirë, andaj ata janë të detyruar të punojnë brenda fshatrave të tyre, shumë prej të cilave nuk kanë ushqim të mjaftueshëm, ujë të pijshëm dhe shërbime mjekësore.

Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, forcat e sigurisë në Mianmar i kanë detyruar burrat dhe djemtë rohingas në punë të rëndë fizike përmes kërcënimeve, frikësimit dhe dhunës (US Department of State, 2014). Qoftë në kampet e zhvendosura, qoftë në pjesën veriore të shtetit Rakhine, rohingasit përballen me kushte të rënda jetese, të shkaktuara nga forcat e sigurisë, zyrtarët vendas dhe komuniteti shumicë budist me qëllim vënien në kushte që synojnë shkatërrimin e tyre (Lowenstein, 2015, f. 50).

Ndërmarrja e masave që kanë për qëllim frenimin e lindjeve brenda grupit

Ndërmarrja e masave që kanë për qëllim frenimin e lindjeve brenda grupit përbën një akt tjetër të gjenocidit sipas Konventës së Gjenocidit. Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën kualifikon se masat që kanë për qëllim parandalimin e lindjeve përfshijnë edhe “kontrollin e detyruar të lindjeve, ndalimin e martesave dhe mbajtjen veçmas të

burrave dhe grave”. Sipas gjykatës, edhe përdhunimi mund të jetë një masë që synon të parandalojë lindjet kur personi i dhunuar nuk pranon më pas të lind dhe të lërë pasardhës (Schabas, 2009, f. 201). Qeveria e Mianmarit ka vendosur masa të tilla për parandaluar lindjet e rohingasve, siç janë kufizimet në martesë që zbatohen vetëm ndaj rohingasve, si dhe në planifikimin e numrin e fëmijëve që mund të ketë një familje. Për t’u martuar duhet marrë gjithashtu leje nga shteti si dhe të paguhet një tarifë e caktuar. Që nga viti 2005, rohingasit, për t’u lejuar të martohen, duhej të pranojnë të kanë jo më shumë se dy fëmijë.

Shkelja e kësaj mase mund të rezultojë me dënime me burg deri në 10 vjet. Siç kemi përmendur më lartë, në maj të vitit 2015 u miratuan një seri ligjesh për mbrojtjen e racës dhe fesë, me të cilat rohingasve iu kufizoheshin këto të drejta (Lowenstein, 2015, f. 51).

4.1.2 Intenca dhe masa e krimeve të Gjenocidit

Qëllimi si element i krimit të gjenocidit

Për t’u shpallur fajtor për krimin e gjenocidit, autorëve të krimit u duhet vërtetuar jo vetëm akti i përshkruar i krimit por edhe “qëllimi” pas të cilit synojnë të shkatërrojnë tërësisht ose pjesërisht një grup të mbrojtur (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 127). Që të ekzistojë krimi i gjenocidit, aktet e kryesit të veprës duhet të jenë të motivuara nga dy elementë të veçantë mendorë, përkatësisht një “qëllim i përgjithshëm” për të kryer aktin dhe një “qëllim i veçantë” përmes të cilëve, aktet krijojnë pasojë të shkatërrimit në tërësi ose pjesërisht grupi i mbrojtur (Kreb, 2006, f. 493). Ky qëllim i veçantë për të shkatërruar, i quajtur ndryshe si qëllim gjenocidal, e dallon krimin e gjenocidit nga krimet e tjera të notuara nga Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e krimit të Gjenocidit.

Gjykatat ndërkombëtare kanë arritur në përfundimin se qëllimi i një kryesi vepre mund të nxirret përmes ekzaminimit të tërësishëm të rrethanave që lidhen me kryerjen e akteve të ndaluara (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998, f. 133). Gjykatat e vërtetojnë gjithashtu qëllimin për të kryer gjenocid, përmes provave të një plani apo politike shtetërore, klimës raciste në opinionin publik ose fjalimet publike dhe takimeve private (ICTR, 2003, f. 101). Sipas Konventës së Gjenocidit, por edhe sipas interpretimit autorizues të Gjykatave Penale Ndërkombëtare Ad-Hoc (për Ruandën dhe Ish Jugosllavinë), provat në dispozicion mbështesin një konkluzion që qeveria e Mianmarit dhe aktorët vendorë kanë vepruar me qëllimin e kryerjes së gjenocidit ndaj myslimanëve rohingas në shtetin Rakhine. Ky konstatim, edhe pse i paracaktuar pa një hetim të plotë, bazohet në prova të retorikës së përhapur (poshtëruese kundër myslimanëve dhe konkretisht myslimanëve rohingas, si dhe provat që rohingasit janë në shënjestër të veçantë për shkak të identitetit të tyre grupor), politikat qeveritare të kufizimeve të lindjes dhe martesës për rohingasit, politikat qeveritare që i privojnë rohingasit nga ndihmat dhe burimet e nevojshme si dhe dëshmitë e shkallës masive të mizorive të kryera kundër rohingasve.

Të gjitha këto prova së bashku tregojnë se qeveria e Mianmarit ka vepruar me një qëllim të caktuar për të kryer veprën e gjenocidit. Kur përcaktohet nëse ka ndodhur gjenocid, gjykatat ndërkombëtare bëjnë edhe dallimin midis motivit dhe qëllimit.

Në rastet e gjenocidit, motivi ose “arsyeja pse i akuzuari ka kërkuar të shkatërrojë grupin e viktimizuar [,] nuk ka peshë te vërtetimi i fajshmërisë” (Lowenstein, 2015, f. 58).

Sipas një raporti të Komisionit Hetimor Ndërkombëtar për çështjen e Darfurit, qëllimi i veçantë nuk duhet të ngatërrohet me motivin, përkatësisht arsyen e veçantë që mund të shtyjë një person të merret me sjellje kriminale. Për shembull, në rastin e gjenocidit një person që synon të vrasë një grup personash që i përkasin një grupi në mbrojtje, me qëllim të veçantë të shkatërrimit të atij grupi, mund të motivohet, për shembull nga nxitja për t’u hakmarrë për sulmet paraprake nga anëtarët e atij grupi ose nga dëshira për të kënaqur eprorët e tij që e nënçmojnë atë grup. Nga pikëpamja e të drejtës penale, ajo që ka rëndësi nuk është motivi, por përkundrazi, nëse ekziston apo jo një qëllim i veçantë i nevojshëm për të shkatërruar një grup (International Commission of Inquiry on Darfur, 2005, f. 125).

Në Mianmar, qeveria dhe aktorët lokalë rakinë mund të kenë motive të ndryshme për veprimet e tyre, përfshirë urrejtjen raciale dhe pretendimet territoriale. Sidoqoftë, nëse veprimet e tyre, përfshirë zhvendosjen me forcë të rohingasve në rrethana të rënda në kampe dhe shtyrjen e tyre në det për t’u përballur me udhëtime të rrezikshme dhe vdekjeprurëse, qëllimisht ose me vetëdije sjellin shkatërrimin e një pjese të konsiderueshme të grupit rohingas, atëherë ka bazë që të kualifikohet nga e drejta penale se këta aktorë kanë vepruar me qëllimin për të kryer gjenocid (Lowenstein, 2015, f. 59).

Shkalla e masës së krimeve të kryera

Shkalla e masës së krimeve të kryera është një element që konsiderohet i rëndësishëm nga gjykatat ndërkombëtare. Por, pavarësisht se numri jo gjithmonë përbën një njësi matëse të masës së krimit, mjafton qëllimi për të shkatërruar një pjesë thelbësore të grupit, për të treguar qëllimin për shkatërrimin total të grupit. Lidhur me këtë, Gjykata Penale Ndërkombëtare e Ish Jugosllavisë thoshte se pikërisht vrasja e burrave myslimanë boshnjakë (pjesë thelbësore e grupit) nënkuptonte asgjësimin e të gjithë grupit boshnjak mysliman. Pa burrat, ishte e qartë se nuk do të mund të mbijetonte as grupi, jeta e të cilit varej nga fati i burrave. (ICTY, 2001, fv. 225-226).

Gjykatat penale ndërkombëtare gjithashtu kanë marrë parasysh hapësirën kohore në të cilën kanë ndodhur krimet, duke treguar se kombinimi një numri të madh individësh të vrarë në një periudhë të shkurtër kohore krijon shanse më të mëdha të mbështetjes së qëllimit për gjenocid (International Criminal Tribunal for Rwanda, 1998). Shtrirja e saktë e dhunës në shtetin Rakhine, duke filluar nga 25 gushti 2017, mbetet e paqartë pasi autoritetet e Mianmarit nuk i kanë lejuar hetuesit e pavarur dhe të paanshëm të shqyrtojnë skenat e krimit. Ushtria e Mianmarit gjithashtu shkatërroi të paktën 55 fshatra të prekura nga dhuna, duke shkatërruar provat e mundshme në ato vende (Human Rights Watch, 2018). Sidoqoftë, dëshmitë nga të mbijetuarit e sulmeve në të gjithë shtetin Rakhine

sugjerojnë natyrën e gjerë të dhunës. Imazhet satelitore të analizuara nga Human Rights Watch tregojnë shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të të paktën 362 fshatrave në të tre qytetet e shtetit Rakhine që nga 25 gushti 2017 (Human Rights Watch, 2018). Shkalla e gjerë e shkatërrimit (gjeografikisht) sjellë edhe një numër të madh vdekjesh. Sipas organizatës ndërkombëtare “Mjekët pa kufij” në një kohëzgjatje prej më pak se një muaj, midis 25 gushtit dhe 24 shtatorit 2017, të paktën 6700 rohingas u vranë nga dhuna gjatë operacioneve të spastrimit të ushtrisë së Mianmarit (Medecins Sans Frontieres, 2017).

Që nga janari i vitit 2018, qeveria e Bangladeshit vlerësoi se 43 700 fëmijë rohingas të shpërngulur nga dhuna e vitit 2017 kishin humbur një ose të dy prindërit, duke sugjeruar mundësinë e një numri më të madh vdekjesh (APHR, 2018, f. 3). Sipas Kombeve të Bashkuara, përveç numrit të konsiderueshëm të individëve të vrarë, sulmet bënë që rreth 860 175 rohingas të iknin në Bangladesh që nga gushti i vitit 2017 (UNHCR, 2020). Shifrat nuk përfshijnë vdekjet dhe zhvendosjet nga sulmet e vitit 2016, ku të paktën 40 fshatra u shkatërruan duke shpërngulur afërsisht 94 500 rohingas në Bangladesh (ONOGA, 2017). Aktualisht ka afro 855 000 rohingas që jetojnë në kampe refugjatësh në Bangladesh (Joint Response Plan, 2020). Shkalla masive e persekutimit, sulmeve, vrasjeve dhe zhvendosjes të rohingasve vërteton qëllimin për të shkatërruar grupin, tërësisht ose pjesërisht.

Dhjetë fazat e gjenocidit

Në vitin 1998, profesori Gregory Stanton, president dhe themelues i Genocide Watch, zhvilloi tetë faza të gjenocidit: klasifikimi, simbolizimi, dehumanizimi, organizimi, polarizimi, përgatitja, shfarosja dhe mohimi (Genocide Watch, 2020). Pesë vjet më vonë, Stanton i zgjeroi këto tetë faza në dhjetë, duke shtuar diskriminimin në fazën e tretë dhe persekutimin në fazën e tetë (Stanton, 2016). Identifikimi i shenjave të hershme paralajmëruese është thelbësore për të parandaluar nxitjen, organizimin dhe kryerjen e gjenocidit. Çdonjëra nga të dhjeta fazat shoqërohet me strategji për parandalim. Këto shenja e shtojnë një shtet të caktuar të veprorë për të parandaluar gjenocidin, ose të tregojë një nevojë që bashkësia ndërkombëtare të ndërhyjë për të parandaluar dhe mbrojtur kundër shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut kur shteti nuk është në gjendje ose nuk dëshiron ta bëjë atë (Szurlej, 2016, f. 93).

- Faza 1 – Klasifikimi; rohingasit klasifikohen si “others” (të tjerët) ose të ndryshëm në krahasim me popullsinë kryesore burmane.
- Faza 2 – Simbolizimi; ata janë të marginalizuar si nga feja ashtu edhe për nga përkatësia e tyre etnike. Rohingasit shpeshherë referohen si “bengalë” ose si “kalarë”, sidomos nga ata që dëshirojnë t’ua zhvlerësojnë origjinën e tyre (Stecklow, 2018).
- Faza 3 – Diskriminimi; kjo fazë ka të bëjë me të drejtat civile, të drejtat e votimit dhe shtetësinë e rohingasve. Duke ua mohuar shtetësinë rohingasve, shteti i Mianmarit i diskriminon ata duke i penguar të gëzojnë liritë dhe të drejtat e njeriut që u takojnë.

- Faza 4 – Dehumanizimi; rohingasit janë të detyruar të jetojnë në zona me kushte të rënda dhe me kufizime të tjera të lirive të tyre, siç kemi përmendur më lartë kufizimin e numrit të fëmijëve që mund të ketë një familje rohingase. Përgjegjëse për një fushatë dehumanizimi e veshur me një propagandë dhe nivel të lartë të gjuhës së urrejtjes kundër myslimanëve rohingas është “Lëvizja 969” e cila i quan ata gjarpërinj, qen të çmendur, çakej.
- Faza 5 – Organizimi; gjatë kësaj faze grupi superior përpiqet të ushtrojë kontroll të plotë mbi grupin e synuar, duke ushtruar forma represioni si përdhunime masive, arrestime, tortura dhe vrasje të grupit. Një organizim i tillë mund të jetë zyrtar, i realizuar nga shteti ose nga nacionalistë të lidhur me shtetin. Në Mianmar, ushtria dhe policia janë përgjegjëse për elementet e organizimit, përfshirë përdhunimin dhe arrestimet. (Szurlej, 2016, fv. 97-98).
- Faza 6 – Polarizimi; gjatë kësaj faze për ta polarizuar grupin e synuar nga pjesa tjetër e shoqërisë, grupi superior përdor propagandë me elemente të urrejtjes për t’i përçarë dhe veçuar grupet. Shembull të qartë të polarizimit përbënte edhe politika shtetërore (më vonë paketa e ligjeve për mbrojtjen e racës dhe fesë) e vitit 2015, me të cilën u kufizuan martesat midis grave budiste dhe burrave jo-budistë, si dhe trajnimet e personelit ushtarak të titulluar “frika nga zhdukja e racës”, duke propaganduar se rohingasit synojnë të përhapin besimin e tyre myslimanë duke kërcënuar budizmin.
- Faza 7 – Përgatitja; në fazën përgatitore, autorët planifikojnë një “zgjidhje përfundimtare” për grupin e synuar, shpeshherë duke përdorur eufemizma, të tilla si “kundër terrorizmit”, “spastrim etnik”, “pastrim” etj., për të maskuar qëllimet gjenocidale (Stanton, 2016). Rohingasit janë të vendosur në zona me kushte të rënda, të ndarë dhe të izoluar nga jo-myslimanët si pjesë e përgatitjes së një gjenocidi (përzënie dhe depërtimi).
- Faza 8 – Persekutimi; gjatë kësaj faze anëtarët e grupit të synuar janë të ndarë në bazë të përkatësisë së tyre etnike dhe fetare, dhe pas veçimit nga popullsia e përgjithshme, grupi i synuar transferohet në geto, kampe përqendrimi ose rajone ku kushtet për mbijetesë janë të rënda. Aktet e gjenocidit ndodhin në këtë fazë, kur një pjesë e grupit shkatërrohet qëllimisht (Stanton, 2016). Siç kemi përmendur edhe më lartë, rohingasit u zhvendosën me dhunë nga shtëpitë e tyre nëpër kampe refugjatësh brenda vendit.
- Faza 9 – Shfarosja; nëse konflikti përparon në këtë fazë, atëherë fillojnë të ndodhin vrasjet masive dhe shfarosjet... akte këto që synojnë dehumanizimin e viktimave. Që nga fillimi i dhunës në vitin 2012, qindra rohingas u shfarosën, u vranë dhe më pas u varrosën nga autoritetet duke i djegur për të zhdukur provat.
- Faza 10 – Mohimi; gjatë kësaj faze autorët e gjenocidit përpiqen ta hedhin fajin mbi viktimat, ndërsa fshehin ose shkatërrojnë provat e krimeve të tyre,

kundërshtojnë hetimet dhe frikësojnë dëshmitarët (Stanton, 2016). Hetuesve ndërkombëtarë, agjencive, trupave të huaj, gazetarëve etj. u ishte mohuar hyrja në kampet ku mbaheshin rohingasit disa herë, ndërsa media e kontrolluar nga shteti hidhte poshtë pretendimet ekzistuese si “raporte jo të vërteta të agjencive të huaja të lajmeve” (Fortify Rights, 2015).

Bazuar në analizën e mësipërme, situata me rohingasit përmbushte secilën nga këto dhjetë faza të gjenocidit.

4.2 Reagimet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me krizën në Mianmar

Autoritetet e Mianmarit kishin ndërtuar dhe ushqyer me vite një mendim të keq kundër rohingasve përmes krijimit të narrativëve negative rreth tyre. Megjithëse afro 90% e popullsisë janë budistë, islami ishte projektuar si kërcënim për budizmin, ndërsa rohingasit si kërcënim për interesin kombëtar të Mianmarit. Kriza e rohingasve u bë temë kryesore nëpër media, në botën e politikanëve, në qarqet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile ndërkombëtare. Dhuna kundër rohingasve filloi në qershor 2012 dhe kriza e fundit e nxitur nga ushtria e Mianmarit sipas Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut Zeid Ra’ad Al Hussein u përshkrua si “shembull i librave shkollorë të spastrimit etnik” (UN News, 2017). Dhuna e vazhdueshme kundër popullit rohingas mysliman u kritikua nga e gjithë bota dhe krijoi shqetësim për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.

Organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç ishin “Human Rights Watch” dhe “Amnesty International” publikuan dhjetëra raporte dhe analiza të lajmeve në lidhje me krizën e rohingasve. Përveç kësaj, media globale si “The New York Times”, “The Guardian”, “Al Jazeera” dhe “BBC” publikuan dhe transmetuan dhjetëra raporte në lidhje me mizoritë e ushtrisë së Mianmarit mbi rohingasit (Islam, 2019). Njerëzit në mbarë botën u bindën për vuajtjet e rohingasve duke manifestuar shqetësimin e tyre përmes protestave. Thirrja e tyre e njëzëshme ishte ndalimi i gjenocidit mbi pakicën myslimane në Mianmar (Goldman, 2017).

Këshilli i Sigurimit, si një ndër organet kryesore të OKB-së që ka për detyrë ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, mbeti peng i fuqisë së vetos nga dy anëtarët e përhershme të Këshillit, Kinës dhe Rusisë, për çështjen e dhunës ndaj rohingasve myslimanë në Mianmar. Kina dhe Rusia kundërshtuan një rezolutë të paraqitur nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik, me të cilën kërkohej që qeveria e Mianmarit të lejonte hyrjen e punonjësve të ndihmës, të siguronte kthimin e të gjithë refugjatëve, t’u jepte të drejtën e shtetësisë të gjithë rohingasve si dhe caktimi i një të dërguari special të OKB-së në Mianmar (The Straits Times, 2017).

Këto janë reagimet e pesë shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit në OKB lidhur me çështjen e rohingasve myslimanë në Mianmar:

- *Kina* vazhdimisht refuzonte të dënonte krimet e kryera nga forcat e sigurisë së Mianmarit. Në vend të kësaj, Kina bllokoi përpjekjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-

së për të miratuar një rezolutë që të dënonte dhunën (e paraqitur nga SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar në vitin 2007), duke argumentuar se ndërhyrja e huaj nuk do e zgjidhte problemin. Nga ana tjetër, ajo justifikoi sulmet për shkak të luftimit të terrorizmit dhe mbrojtjes së sigurisë kombëtare (Bequelin, 2017). Pekini zyrtar u vetëshpall si ndërmjetës në mosmarrëveshjen midis Bangladeshit dhe Mianmarit për krizën e refugjatëve rohingas dhe kërkoi nga komuniteti ndërkombëtar të inkurajonte zgjidhjen e krizës përmes konsultimeve bilaterale në vend të një nisme ndërkombëtare (Lee, 2017). Ky pozicion i Kinës, dhe iniciativa e saj si ndërmjetësuese, pengoi OKB-në dhe shtetet perëndimore të përfshiheshin me mekanizma të tjerë në këtë rajon (Joy, 2018, f. 4). Pekini zyrtar nuk e kritikoi asnjëherë drejtpërdrejtë qeverinë e Mianmarit lidhur me dhunën ndaj rohingasve. Për Kinën, statusi i rohingasve ishte çështje e brendshme sovrane e Mianmarit dhe komentimi publik i kësaj çështje përbënte shkelje të parimeve zyrtare të politikës së jashtme të Kinës. Pra, Kina nuk e kritikoi dhunën, pasi në të kundërt, një gjë e tillë do të aktualizonte edhe trajtimin e Kinës me pakicat etnike, e sidomos me pakicën myslimane ujgure në rajonin Xinjiang të Kinës (BBC NEWS, 2014). Kina e tjetërsoi angazhimin e saj ndërmjetësues, duke i dhënë konotacion ekonomik. Sipas saj, stabiliteti i këtij rajoni dhune mund të arrihet vetëm përmes uljes së varfërisë, me shtrirje të investimeve kineze (Joy, 2018, f. 5). Kina mbetet partneri kryesor ekonomik i Mianmarit dhe interesat gjeostrategjike të Kinës si dhe fuqia e vetos në Këshillin e Sigurimit janë garanci në mbrojtjen e Mianmarit nga hetimet ligjore ndërkombëtare (Tobin, 2018).

- *Rusia*, siç e kemi përmendur më lartë, përdori gjithashtu fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit në vitin 2007, për projektrezolutën e paraqitur nga SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar lidhur me situatën në Mianmar. Me anë të kësaj rezolute synohej t'i bëhej thirrje qeverisë së Mianmarit që t'i jepte fund sulmeve ushtarake kundër civilëve në rajonet ku jetojnë pakicat etnike dhe të fillonte dialogun politik për një tranzicion demokratik. Qëndrimi rus ishte se situata në Mianmar nuk përbën asnjë kërcënim për paqen botërore ose rajonale dhe se problemet që përmenden në projektrezolutën para Këshillit të Sigurimit konsideroheshin brenda kornizave të organeve të tjera të OKB-së, veçanërisht nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracion. Ky qëndrim ndahej edhe nga një numër i madh shtetesh, përfshirë ato fqinje të Mianmarit (UN Security Council, 2007). Lidhur me valën e parë të dhunës në vitin 2012, midis budistëve dhe rohingasve myslimanë në shtetin Rakhine, qëndrimi zyrtar ishte se Rusia inkurajon të gjitha forcat e përfshira në konflikt, të ndalonin dhunën dhe të bashkëpunonin me qeverinë për të arritur normalizimin e situatës bazuar në legjislacionin aktual të Mianmarit (The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation, 2012). Ndërsa lidhur me zhvillimet e vitit 2017 në shtetin Rakhinë, Rusia dënoi sulmet e armatosura të Ushtrisë së Shpëtimit të Rohingasve nga Arakani, të cilët sipas saj, provokuan një shpërthim të ri dhune, duke shprehur në të njëjtën kohë shqetësimin nga kërcënimi i një krize të madhe humanitare. Rusia u bëri thirrje të gjitha palëve

të përmbaheshin nga veprimet që mund të çojnë në përkeqësimin e situatës. Rusia mbështeti gjithashtu hapat e qeverisë së Mianmarit në përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Këshillëdhënës për shtetin Rakhine të udhëhequr nga ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Kofi Anan për riatdhesimin e rohingasve të zhvendosur në Rakhine (The Ministry of Foreign Affairs of the Russian Federation, 2017). Në fund të tetorit të vitit 2017, Rusia dhe Kina nuk pranuan të bashkëpunonin për një rezolutë të Këshillit të Sigurimit për Mianmarin. Rusia dha miratimin pasi Mbretëria e Bashkuar dhe Franca ulën tonin dhe e shndërruan idenë për rezolutë, në një deklaratë presidenciale të Presidentit të Këshillit të Sigurimit, e cila krijohet nga Këshilli i Sigurimit kur nuk arrihet konsensus ose kur frenohet miratimi i rezolutës (Yap, 2017). Edhe presidenti rus Vladimir Putin, gjatë pranimit të letrave kredenciale të ambasadorit të ri të Mianmarit në Moskë, në një deklaratë për shtyp, bëri thirrje që të gjitha palët e inkuadruara t'i jepnin fund dhunës, dhe se zgjidhja e problemit duhet të kërkohej në sferën e bashkëpunimit politik, me mjete politike, pa shkelje të të drejtave të njeriut (Russian News Agency, 2017).

- *Shtetet e Bashkuara të Amerikës* ishin të kujdesshme në zgjedhjen e fjalëve dhe retorikën lidhur me situatën e rohingasve në shtetin Rakhine të Mianmarit gjatë vitit 2012. Retorika amerikane u intensifikua pas publikimit të raporteve përgjatë vitit 2018, e sidomos të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit që dokumentonte mizoritë në rajonin verior të shtetit Rakhine. Sipas raportit, tre të katërtat e rohingasve të intervistuar në kampet e refugjatëve në Bangladesh, kishin qenë dëshmitarë të një vrasje nga një anëtar i ushtrisë, dhe po këto viktime e etiketonin Ushtrinë si autore të vrasjeve të dëshmuara (US Department of State, 2018). Zëvendës Presidenti i SHBA-së Mike Pence i nxitur nga faktet e gjetura në raportin e Grupit për Politika dhe të Drejtën Ndërkombëtare Publike (Public International Law and Policy Group) në margjinat e samitit të ASEAN 2018 në Singapor, gjatë takimit me Aung San Suu Kyi tha se krimet ishin të pajustificueshme dhe se SHBA-ja mezi pret të dëgjojë përparime nga ana e qeverisë së Mianmarit në gjetjen e përgjegjësve dhe ndëshkimin e tyre për krimet e kryera (Rogin, 2018). Sipas raportit të të njëjtit grup, ekziston një bazë ligjore për të konkluduar se rohingasit ishin viktime të krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit (PILPG, 2018). Në vitin 2019, SHBA-ja vendosi sanksione kundër Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Mianmarit Min Aung Hlaing, zëvendësit të tij Soe Win dhe dy komandantëve të tjerë, të cilët ishin përgjegjës për vrasjet e paligjshme të myslimanëve rohingas, duke ua ndaluar atyre hyrjen në SHBA (Brunnstrom & Wroughton, 2019). Në aspektin legjislativ, Kongresi i SHBA-së bëri përpjekje të vazhdueshme për ta trajtuar këtë çështje dhe për t'u ardhur në ndihmë rohingasve të persekutuar. Një prej tyre ishte edhe akti i posaçëm i ndihmës financiare amerikane (Further Consolidated Appropriations Act) i vitit 2020, ku u vunë në dispozicion më shumë se 2 milion dollarësh për programe trajtimi për komunitetin rohingas në Bangladesh (Further Consolidated Appropriations Act, 2020). Përfshirja e një ndihme të tillë shënon drejtimin e politikës amerikane ndaj Mianmarit dhe rohingasve. Rruga për

këtë ndihmë të drejtpërdrejtë financiare kaloi përmes rezolutave të shumta të miratuara në Dhomën e Përfaqësuesve të SHBA-së, të tilla si “Burma Unified”, Aktit të Përgjegjësisë Ushtarake (Rigorous Military Accountability Act) etj. Me këtë kurs, SHBA-ja veçse tregonte kahun e saj në këtë çështje, madje *njihte* edhe krimet e kryera kundër rohingasve. Përmes aktit të përgjegjësisë ushtarake kërkohej vendosja e sanksioneve për shkeljen e të drejtave të njeriut si dhe autorizimi për të ofruar ndihmë humanitare (Burma Unified, 2019). Sot, politika e jashtme e SHBA-së e dënon mosveprimin e Mianmarit, sidomos në mbrojtjen dhe ndihmën e rohingasve. Nga ana tjetër, SHBA-ja mban marrëdhënie pozitive me Mianmarin, në mënyrë që Kina të mos ketë ndikim të pakontrolluar në atë pjesë të Azisë Juglindore. Edhe Urdhri i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i 23 janarit të vitit 2020 mund të shërbejë si katalizator për një përgjigje të re nga SHBA-ja në dënimin e mizorive të kryera kundër rohingasve në shtetin Rakhine të Mianmarit (Kiedrowski, 2020).

- *Mbretëria e Bashkuar* kërkoi dy herë nga Këshilli i Sigurimit që të diskutohet lidhur me krizën e rohingasve (Al Jazeera, 2017). Edhe Sekretari i Jashtëm britanik Boris Johnson, menjëherë pas shpërthimit të dhunës të vitit 2017, bëri thirrje për t’i dhënë fund dhunës në Rakhine. Ai gjithashtu inkurajoi dhe vlerësoi Aung Sang Suu Kyi si një nga figurat më frymëzuese të epokës së re, që të përdorte të gjitha cilësitë e saj për ta bashkuar vendin e saj, për ta ndaluar dhunën dhe për t’i dhënë fund paragjykimëve ndaj myslimanëve në shtetin Rakhine (Foreign&Commonwealth Office, 2017). Menjëherë pas fillimit të dhunës në vitin 2017, 157 deputetë britanikë kërkuan nga qeveria e Britanisë së Madhe të ushtronte më shumë presion ndaj qeverisë së Mianmarit për të ndaluar dhunën ndaj rohingasve. Ata kërkuan gjithashtu që qeveria britanike të rishikonte qasjen e saj ndaj ushtrisë së Mianmarit, dhe t’i pezullonte programet e trajnimit të ushtrisë së Mianmarit që ofroheshin nga qeveria britanike (Singh, 2017). Pas kësaj, ministria britanike e mbrojtjes pezulloi 300 000 sterlina nga buxheti që ishin parashikuar për trajnime dhe kurse edukimi për ushtrinë e Mianmarit deri sa të zgjidhej situata (BBC NEWS, 2017). Lidhur me këtë, kryeministria britanike Theresa May gjatë një fjalimi në Londër dënoi dhunën dhe e përshkroi atë si “spastrim etnik” ndaj rohingasve myslimanë në Mianmar. Ajo tha gjithashtu se Mbretëria e Bashkuar do vazhdojë të luaj rolin udhëheqës në bashkësinë ndërkombëtare, duke punuar përmes OKB-së dhe partnerëve rajonalë, për të bërë gjithçka për të ndaluar shkatërrimin e tmerrshëm dhe çnjerëzor të popullit rohingas (Calderwood, 2017). Mbretëria e Bashkuar, me lidhjet e saj historike me Mianmarin si fuqi koloniale dhe si një anëtare e përhershme në Këshillin e Sigurimit, ka një përgjegjësi të madhe morale dhe globale për të iniciuar hapa praktikë në zgjidhjen e krizës me rohingasit (Bari, 2018, f. 23). Mbretëria e Bashkuar sot kryeson përgjigjen ndërkombëtare humanitare me afro 129 milion sterlina për të përmbushur nevojat urgjente të refugjatëve rohingas që ndodhen në Bangladesh (Burt, 2019).
- *Franca* e kishte shprehur shqetësimin e saj për shkeljet serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare në shtetin Rakhine, të kryer në

mënyrë të organizuar, të koordinuar dhe sistematike, që nga fillimi i krizës në shtator të vitit 2017 (Permanent Mission of France to the UN, 2018). Presidenti francez Emmanuel Macron, gjatë një fjalimi në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, iu referua krizës si “spastrim etnik”, ndërsa gjatë një interviste për mediat, shkoi me tej duke e cilësuar dhunën me termin “gjenocid” (France 24, 2017). Franca ndërmori iniciativën në kuadër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në bashkëpunim me partnerët e saj, për të siguruar një përgjigje fillestare kolektive nga bashkësia ndërkombëtare lidhur me krizën me rohingasit (France Diplomatie, 2018). Rezultati i kësaj iniciative, siç përmendëm më sipër, ishte një deklaratë presidenciale e Këshillit të Sigurimit e cila do të shërbente si udhërrëfyes për zgjidhjen e krizës. Qeveria franceze kërkoi nga forcat e sigurisë në Mianmar të siguronin mbrojtjen e popullatës civile dhe qasjen e sigurt të ndihmave humanitare (UNA Sweden, 2018, f. 14). Më 28 qershor 2018, Franca së bashku me partnerët e saj evropianë vendosën sanksione (ngrirjen e pasurive në bankat evropiane dhe ndalimin e udhëtimit në BE) për shtatë oficerë të lartë të forcave të sigurisë së Mianmarit, për shkelje serioze të të drejtave të njeriut kundër civilëve rohingas (The Council of the EU, 2018). Që nga fillimi i krizës, Franca pezulloi edhe bashkëpunimin me ushtrinë e Mianmarit si dhe mori pjesë në iniciativat ndërkombëtare për ndihma humanitare në Mianmar. Nga ana tjetër, si në kapacitetin e saj kombëtar ashtu edhe brenda BE-së, Franca vazhdoi t’i ofronte mbështetje edhe Bangladeshit, ku më shumë së 1 milion rohingas ishin pranuar si refugjatë (France Diplomatie, 2018).

KAPITULLI III

5. PËRGJEGJËSIA PËR TË MBROJTUR CIVILËT (RESPONSIBILITY TO PROTECT-R2P)

Fundi i shekullit XX shënoi një ndryshim në natyrën e konflikteve ta armatosura. Konfliktet e brendshme zëvendësuan ato ndër-shtetërore dhe civilët përbënin pjesën më të madhe të viktimave. Shfaqja e aktorëve jo-shtetërorë si ekzekutorë kryesorë të dhunës në shumë konflikte, shfaqti nevojën për një kornizë ndërkombëtare ligjore në lidhje me detyrimet e shtetit për të mbrojtur popullatat civile. Gjenocidet në Kamboxhia, Ruanda dhe Bosnjë, si dhe krimet kundër njerëzimit në Kosovë, Timorin Lindor dhe Darfur kanë demonstruar dështime të mëdha të komunitetit ndërkombëtar për t'i ndaluar këto mizori (R2PCS, 2020).

Doktrina e “Përgjegjësisë për të mbrojtur” ose (Responsibility to Protect – R2P) është një nga doktrinat më të rëndësishme dhe më të debatueshme në kuadër të OKB-së. Më shumë se sa një tufë parimesh të shteteve të fuqishme, kjo doktrinë mban epitelin e një angazhimi politik mbarëbotëror, i pranuar nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara. “Përgjegjësia për të mbrojtur” lindi në vitin 2005 gjatë një Samiti Botëror, me qëllimin e vetëm për të trajtuar katër shqetësimet e mëdha: për të parandaluar gjenocidin, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimin etnik (UN, 2020). Sipas dokumentit të dalë nga samiti i 2005, shtetet u morën vesh gjithashtu për një përgjegjësi kolektive për të inkurajuar dhe për të ndihmuar njëra-tjetrën t’i përmbahen këtij angazhimi. Ata shpallën gatishmërinë e tyre për të marrë veprime në kohë dhe me vend, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, dhe në bashkëpunim me organizata të ndryshme rajonale, kur autoritetet lokale dështojnë të mbrojnë popullatën e tyre. Doktrina përbëhet nga norma në zhvillim, bazuar në idenë se sovraniteti nuk është e drejtë, por përgjegjësi (Qose, 2015, f. 136).

Si koncept, kjo doktrinë u rrënjos në arenën ndërkombëtare në vitin 2001 nga Komisioni Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitetin Shtetëror, si një komision i pavarur, qëllimi i të cilit ishte ndërtimi i një konsensusi politik global për të tejkaluar polemikat, shpesh bllokimin e veprimit në sistemin ndërkombëtar, veçanërisht përmes OKB-së (ICISS, 2001). Qëllimi kryesor i Komisionit ishte ngritja e një strukture për të përmirësuar kundërpërgjigjen e komunitetit ndërkombëtar në rastet e tragjediave humanitare, jo nëpërmjet një formule unike për të gjitha rastet, por nëpërmjet një bashkësie opsionesh udhëzuese të cilat mund të zbatoheshin sipas veçorive të secilit rast me qëllim parandalimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, pa dëmtuar parimin e sovranitetit shtetëror dhe të integritetit territorial (Gërdeci, 2019, f. 48).

Sipas dokumentit përfundimtar të dalë nga Samiti Botëror, të miratuar formalisht në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 60/1 (2005), në paragrafët 138-140 të këtij dokumenti, në kapitullin mbi të drejtat e njeriut dhe shtetit të së drejtës, krerët e shteteve dhe Asambleja e Përgjithshme afirmonin përgjegjësinë për të mbrojtur popullatat nga gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimi etnik (General Assembly, 2005). Paragrafët e lartpërmendur formuluan përgjegjësinë për të mbrojtur si më poshtë:

Përgjegjësia për të mbrojtur popullsitë nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit

138. Çdo shtet individual ka përgjegjësinë për të mbrojtur popullsinë e vet nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit. Kjo përgjegjësi nënkupton parandalimin e krimeve të tilla, duke përfshirë edhe nxitjen e tyre, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe të nevojshme. Ne e pranojmë këtë përgjegjësi dhe do të veprojmë në përputhje me të. Komuniteti ndërkombëtar, sipas rastit, duhet t'i inkurajojë dhe t'i ndihmojë shtetet që ta ushtrojnë këtë përgjegjësi dhe të mbështesin Kombet e Bashkuara në krijimin e një kapaciteti të paralajmërimit të hershëm.

139. Komuniteti ndërkombëtar, nëpërmjet Kombeve të Bashkuara, ka gjithashtu përgjegjësinë të përdorë mjete të përshtatshme diplomatike, humanitare dhe mjete të tjera paqësore, në përputhje me Kapitujt VI dhe VIII të Kartës, për të ndihmuar në mbrojtjen e popullatave nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit. Në këtë kontekst, ne jemi të përgatitur të ndërmarrim aksione kolektive, në kohë dhe mënyrë vendimtare, nëpërmjet Këshillit të Sigurimit, në përputhje me Kartën, duke përfshirë edhe Kapitullin VII, në bazë rast pas rasti dhe në bashkëpunim me organizatat relevante rajonale, kur mjetet paqësore të jenë të pamjaftueshme dhe autoritetet kombëtare në mënyrë të dukshme nuk i mbrojnë popullatat e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit. Ne theksojmë nevojën që Asambleja e Përgjithshme të vazhdojë shqyrtimin e përgjegjësisë për të mbrojtur popullatat nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit dhe implikimet e saj, duke pasur parasysh parimet e Kartës dhe të drejtës ndërkombëtare. Ne gjithashtu synojmë të angazhojmë veten, kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, të ndihmojmë shtetet respektive të ndërtojnë kapacitete për të mbrojtur popullatat e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit dhe për t'i ndihmuar ato që janë nën stres para se të shpërthejë kriza dhe konfliktet. (UN General Assembly, 2005, f. 30).

Sipas paragrafëve 138-140, “Përgjegjësia për të mbrojtur” konsiston në tri elemente: *së pari* në përgjegjësinë e çdo shteti për të mbrojtur popullsinë e tij nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit; *së dyti* bashkësia ndërkombëtare duhet, në rast se e konsideron si të përshtatshme, të inkurajojë dhe të ndihmojë shtetet për ta ushtruar këtë përgjegjësi dhe të mbështesë OKB-në për të ndërtuar një kapacitet të paralajmërimit të hershëm, *së treti*, në përgjegjësinë e shteteve për të reaguar kur një shtet “qartazi dështon” në mbrojtjen e popullsisë civile (Gërdeci, 2019, f. 66).

Për zbatimin e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur” në rastet konkrete të krizave humanitare, si dhe për zhvillimin konceptual të saj, tri organet kryesore të OKB-së, përkatësisht Këshilli i Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë rolin kyç. Këshilli i Sigurimit ka një rol parësor sa i përket ndërmarrjes së masave kolektive si kundërpërgjigje ndaj kërcënimeve ose shkeljes së paqes, atëherë kur ka prova të mjaftueshme se këto shkelje përbejnë shkelje masive të të drejtave të njeriut. Këshilli i Sigurimit gjithashtu ka kompetencë për të referuar një çështje në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, sipas Statutit të Romës (UN General Assembly, 1998). Asambleja e Përgjithshme ka rol dytësor sa i përket R2P, pasi fuqia e saj mund të jetë vetëm me natyrë rekomanduese, pra mund të rekomandojë edhe veprime ushtarake (ICISS, 2001, f. 53). Ndërkaq, Sekretari i Përgjithshëm vepron në emër të organizatës dhe ai është në krye të të gjitha nismave për zhvillimin e konceptit R2P. Sot ai luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e strategjive për gjetjen e konsensusit dhe zhvillimit konceptual të “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”.

Gjithashtu, në kuadër të OKB-së veprojnë edhe Këshilli i të Drejtave të Njeriut dhe Zyra e Përbashkët e Këshilltarit të Posaçëm mbi Parandalimin e Gjenocidit dhe “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”, si organe të posaçme mbështetëse të doktrinës R2P. Këshilli i të Drejtave të Njeriut e përdor “përgjegjësinë për të mbrojtur” si bazë për të hetuar shkeljet e rënda në raste specifike. Ai sinjalizon qeveritë, autoritetet dhe komunitetin ndërkombëtar mbi praninë e dyshimeve të bazuara të kryerjes së shkeljeve masive të të drejtave të njeriut (HRW, 2014). Zyra e Përbashkët e Këshilltarit të Posaçëm mbi Parandalimin e Gjenocidit dhe “Përgjegjësisë për të Mbrojtur” mbledh informacione mbi zhvillimet politike, humanitare, politike, sociale dhe mbi të drejtat e njeriut në mbarë botën, me qëllim të identifikimit të shenjave të hershme të shkeljeve të rënda (UN, 2020).

5.1 Sovraniteti shtetëror përball përballë sovranitetit njerëzor (4 krimet kundër njerëzimit)

Sovraniteti shtetëror lindi që nga Vesftalia dhe mbahej vetëm mbi parimin se sovraniteti i çdo shteti ishte i paprekshëm (Osiander, 2001). Çdo shkelje e tij, e mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare që nga viti 1948, tregonte se shtetet do të përballeshin me luftë. Por, kur fryma e re e të drejtës ndërkombëtare diktoi se shteti nuk mund të shkelë të drejtat e njeriut, atëherë as shtetet e tjera nuk mund të rrinë duarkryq dhe të lejojnë një shtet të caktuar që të shkel të drejtat e qytetarëve të vet.

Ky sovranitet i ri, ai njerëzor, e mbivendosi sovranitetin Vestfalian dhe parimin e tij.

Pra, siç u përmend edhe më sipër, sistemi modern ndërkombëtar u përcaktua me Traktatin e Vestfalisë (1648) që i dha fund luftës 30-vjeçare të asaj kohe (Wilson, 2009). Sipas Kissinger, sistemi Vestfalian ofronte zgjidhje për dhunën ndërmjet shteteve, por nuk ofronte zgjidhje për dhunën brenda shteteve të shkakuar nga luftërat civile, konfliktet etnike, dhe gjithë gamën e atyre që sot njihen si shkelje të të drejtave të njeriut (Kissinger, 2005, f. 360). Sot mbështetësit e të drejtave të njeriut vlerësojnë se nëse ka drejtësi, paqja do të rrjedhë në mënyrë të natyrshme prej saj. Sipas tyre “drejtësia duhet të vendoset nën njëfarë autoriteti supranacional me të drejtën për të përdorur forcën për ta bërë këtë vendim të funksionojë (Kissinger, 2005, f. 360).

Rikonceptimi i sovranitetit shtetëror dhe mosndërhyrjes nga jashtë filloi pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, me paraqitjen e kërcënimeve të reja ndaj njerëzimit, siç ishin krimi i organizuar, sulmet terroriste, dhuna etnike, droga, armët e shkatërrimit në masë, varfëria, konfliktet e brendshme dhe shkelja e ashpër dhe sistematike e të drejtave të njeriut në forma të ndryshme (gjenocid, krime të luftës, krime kundër njerëzimit dhe spastrim etnik).

Ishte raporti “Agjenda për Paqe” i ish Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Boutros Boutros-Ghali që kishte futur idenë e “sigurisë njerëzore” (sovranitetit njerëzor), në të cilin theksohej se pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, njerëzit u ekspozuan ndaj rreziqeve shumë më të mëdha se sa shtetet, dhe një gjë e tillë impononte nevojën për t’i mbrojtur ata në përputhje me mundësitë dhe rrethanat (Reka, Bashota, & Sela, 2016, f. 167).

Më vonë, Rezoluta 688 e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në prill të vitit 1991 shënoi fillimin e ndryshimeve në këtë koncept, duke vendosur një normë e re – atë të ndërhyrjeve humanitare (Hosseini & Qasemi, 2015, f. 154). Me anë të rezolutës Këshilli i Sigurimit kërkoi nga Iraku që t’i jepte fund shtypjes dhe të respektonte të drejtat e popullatës së tij (UN Security Council, 1991). Dështimi i komunitetit ndërkombëtar që të përgjigjej në kohë dhe në mënyrë efikase ndaj gjenocidit në Ruanda (1994) dhe në Srebrenicë (1995), përkundër pranisë së forcave paqeruajtëse të OKB-së, ngritën pikëpyetje rreth vullnetit politik dhe kapacitetit (aftësisë) të OKB-së. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së gjatë viteve 1998-1999, në disa fjalime, paralajmëroi se bashkësia ndërkombëtare duhet të zgjidhte mes heshtjes dhe të shikonte kryerjen e krimeve masive, ose të ndërhynte ushtarakisht (ICISS, 2001, f. 67).

Pas këtyre zhvillimeve, qeveria e Kanadasë njoftoi më 20 shtator të vitit 2000 krijimin e Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitetin Shtetëror, për t’iu përgjigjur sfidave që u shtruan nga Sekretari i Përgjithshëm në vitin 1998-1999. Ky komision, në bazë të studimeve dhe konsultimeve të nevojshme, paraqiti raportin e tij para Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së nën titullin “Përgjegjësia për të Mbrojtur”. Baza e këtij raporti ishte ndryshimi i konceptit të së “drejtës për ndërhyrje” në “përgjegjësi për të mbrojtur” në kuadër të ndërhyrjeve humanitare, si dhe për të zgjidhur thelbin e ndërhyrjes dhe sovranitetit (ICISS, 2001, f. 80).

Raporti që u miratua nga liderët botërorë (2005) shprehte se miliona njerëz janë ekspozuar në luftëra, trazira dhe ndaj shtypjes nga ana e shtetit, dhe se qëllimi i këtij

koncepti ishte që të sigurohej mbështetje praktike aty ku jeta e njerëzve ishte në rrezik dhe qeveritë e tyre nuk ishin në gjendje, nuk ishin të gatshme ose nuk dëshironin t'i mbështesin ata. Bazuar në këtë teori, sovraniteti i shtetit garanton edhe përgjegjësinë që ai e ka në mbrojtje të popullatave të rrezikuara, ndërkohë që mosndërhyrja e shtetit në këto kriza të brendshme, shndërrohet në përgjegjësi ndërkombëtare (Hosseini & Qasemi, 2015, f. 154).

5.1.1 Doktrina R2P, shtyllat dhe kushtet për ndërhyrje ushtarake ndërkombëtare

Doktrina R2P, sikurse kemi theksuar edhe më lart, është instrumenti i cili merret parasysh nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe shtetet të tjera, të cilat kërkojnë vendimmarrje konkrete, rezoluta, e deri edhe ndërhyrje *humanitare*. Por, kjo ndërhyrje, nuk ka qenë gjithnjë e saktë dhe rigorozë për shkak se shtete anëtare të Këshillit të Sigurimit ose janë mjaftuar vetëm me vërejtje, rezoluta, etj., (që në fakt përbëjnë rekomandime për një shtet të caktuar) ose kanë ndërmarrë edhe ndërhyrje ushtarake (ndonjëherë edhe pa pëlqim të të gjitha anëtareve të Këshillit të Sigurimit). SHBA-ja, e cila mban edhe primatin e frymës së re të së drejtës ndërkombëtare dhe atë të sovranitetit njerëzor, është e njohur për shkeljen e parimit të konsensusit të 5 anëtareve të përhershme, duke reaguar dhe duke ndërhyrë në mënyrë të njëanshme.

Siç e kemi përmendur edhe më lart, Dokumenti përfundimtar i Samitit Botëror parashikonte tre përgjegjësi: *përgjegjësinë për të parandaluar* (adresimin e shkaqeve të drejtpërdrejta të konfliktit të brendshëm dhe krizave të tjera të krijuara nga njeriu); *përgjegjësinë për të vepruar* (me masa të përshtatshme të cilat mund të përfshijnë masa shtrënguese si sanksionet dhe në raste ekstreme, ndërhyrje ushtarake) dhe *përgjegjësinë për të rindërtuar* (për të siguruar, veçanërisht pas një ndërhyrje ushtarake, ndihmë të plotë në rimëkëmbjen, rindërtimin e shtetit si dhe pajtimin e palëve) (ICISS, 2001).

Këto përgjegjësi u modifikuan pas prezantimit të Raportit të Sekretarit të Përgjithshëm Ban Ki-Moon të titulluar “Zbatimi i Përgjegjësisë për të Mbrojtur” në vitin 2009. Doktrina u ristrukturua me tre shtyllat, si tre përgjegjësi të lidhura (Orchard, 2012, f. 379). Dispozitat e paragrafëve 138-140 të dokumentit të dalë nga Samiti Botëror në vitin 2005, sugjerojnë që R2P të mbështetet në tre shtyllat e mëposhtme:

Shtylla I - Përgjegjësia e shtetit për të mbrojtur

Shtylla e parë është përgjegjësia e shtetit për të mbrojtur popullsinë e vet, *qofshin shtetas ose jo*, nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit dhe nga nxitja e tyre (UN General Assembly, 2009). Kur një shtet nuk është në gjendje ta përmbushë plotësisht këtë përgjegjësi për shkak të mungesës së kapacitetit ose mungesës së kontrollit territorial, bashkësia ndërkombëtare duhet të përgatitet për ta mbështetur dhe ndihmuar shtetin në përmbushjen e kësaj përgjegjësie thelbësore. Vetë mbrojtja e popullsisë është një atribut përcaktues i sovranitetit (UN General Assembly, 2009). Gjithashtu në kuadër të shtyllës së parë, shtetet duhet të bashkëpunojnë me Këshillin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, si mekanizëm për monitorimin e performancës së shteteve në fushën e të drejtave të njeriut në kuadrin e “Përgjegjësisë për të Mbrojtur”.

Shtylla II – Asistimi ndërkombëtar dhe ndërtimi i kapaciteteve shtetërore

Shtylla e dytë është angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare për të inkurajuar dhe ndihmuar shtetet në përmbushjen e detyrimeve të shtyllës së parë. Për të mbështetur përgjegjësitë e tyre për të mbrojtur, shteteve u duhen njohuri të përshtatshme dhe kapacitete institucionale për të parandaluar dhe për t'u përgjigjur këtyre katër krimeve të mëdha. Veprimet që krijojnë ose forcojnë sundimin e ligjit, reformat në sektorin e sigurisë, çarmatimi, demobilizimi dhe ri-integrimi shërbejnë si pika kyçe në angazhimin për të ndihmuar një shtet për të rritur kapacitetin e tij për parandalimin e krimeve në të ardhmen (UN General Assembly, 2009).

Shtylla III – Kundërpërgjigje në kohë dhe në mënyrë decisive

Shtylla e tretë artikulon përgjegjësinë e shteteve anëtare për t'u përgjigjur në kohë dhe në mënyrë vendimtare, atëherë kur shtetet haptazi dështojnë në mbrojtjen e popullsisë së tyre. Sipas kësaj shtylle, mjetet në kuadër të kuadër të përgjegjësisë për të mbrojtur përfshijnë gamën e gjerë të masave jo-shtrënguese dhe atyre shtrënguese: si ndërmjetësimi, diplomacia parandaluese, misionet e hetimit, monitorimit dhe vëzhgimit, referime në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, sanksionet, si dhe përdorimi i forcës ushtarake. Vetëm pas ezaurimit të mjeteve diplomatike dhe paqësore shtetet anëtare duhet të ndërmarrin veprime kolektive në kohë dhe në mënyrë vendimtare në përputhje me Kartën e OKB-së (UN General Assembly, 2009). Veprimet kolektive mund të autorizohen vetëm nga Këshilli i Sigurimit në bazë të neneve 42 dhe 44 të Kartës (ICISS, 2001, fv. 30-31). Në rast të Këshilli i Sigurimit nuk përgjigjet në kohë dhe në mënyrë të duhur ndaj krizës, kjo nuk përbën ndonjë shkelje të ndonjë detyrimi ligjor sipas të drejtës ndërkombëtare (ICRtoP, 2020).

Kushtet apo kriteret të cilat duhen të përmbushen përpara se të ndërmerret një ndërhyrje ushtarake, për rastet që kërkojnë zbatimin e masave shtrënguese, janë të parashikuara në Raportin e Komisionit Ndërkombëtar për Ndërhyrje dhe Sovranitetin Shtetëror. Ato janë:

- *Shkaku i drejtë* – veprimet duhen të ndërmerren si kundërveprim ndaj një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm kundrejt qenieve njerëzore, që ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhë.
- *Autoriteti legjitim* – autoriteti i cili ndërmerr veprimet duhet të jenë legjitim.
- *Qëllim i drejtë* – qëllimi kryesor i ndërhyrjes duhet të jetë ndalimi ose evitimi i vuajtjes njerëzore.
- *Mjeti i fundit* – pasi të shterohen më parë të gjitha mjetet parandaluese dhe paqësore të zgjidhjes së konfliktit, vihet në ndërhyrja humanitare.
- *Proporcionaliteti* – shkalla, kohëzgjatja dhe intensiteti i ndërhyrjes humanitare, në proporcion me kufirin minimal të dëmeve ndaj popullatës së rrezikuar
- *Suksesi i pritshëm* – ndërhyrja humanitare të përmbushë qëllimin për të cilën është ndërmarrë. Aksioni ushtarak mund të justifikohet vetëm nëse ka

sukses në parandalimin ose shmangien e mizorive ndaj popullatës së rrezikuar (ICISS, 2001, fv. 32-37).

Këshilli i Sigurimit është organi i vetëm kompetent për të autorizuar ndërhyrjen ushtarake nën përgjegjësinë për të vepruar në kuadër të doktrinës R2P, bazuar te gjetjet e raportit të Komisionit Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror i cili përveç fakteve, propozon edhe alternativat e zgjidhjes së krizës (Peters, 2011). Nga ana tjetër, në rast të mospajtimit për shqyrtim të rastit ose përdorimit të vetos në Këshillin e Sigurimit, atëherë rezoluta 377 e vitit 1950 “Të bashkohemi për paqen” i jep gjithashtu një shans Asamblesë së Përgjithshme ta kthejë në shqyrtim çështjen, dhe t’u rekomandojë anëtarëve të marrin masa të përbashkëta. (UN General Assembly, 1950). Megjithatë, nuk kanë qenë të pakta rastet kur shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit kanë vënë përpara interesat e tyre gjeopolitike dhe ekonomike, duke mos i mbështetur (duke përdorur veton) ndërhyrjet humanitare si parandalim për krimet kundër njerëzimit (ICISS, 2001, f. 51). Pavarësisht kësaj, edhe “Përgjegjësia për të mbrojtur” ka dhënë deri diku efektin e saj. Ajo ka qenë bazë e rreth 80 rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për krizat në Republikën Afrikane Qendrore, Bregun e Fildishtë, Republikën Demokratike të Kongos, Libinë, Malin, Somalinë, Jemenin etj., në lidhje me parandalimin e gjenocidit, konfliktit të armatosur dhe kufizimin e tregtisë së armëve. R2P është përdorur si bazë edhe në më shumë se 40 rezoluta të Këshillit për të Drejtat e Njeriut si dhe 13 rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme (Global R2P, 2020).

5.2 Gjenocidet e mëparshme (Ruandë, Srebrenicë, Lufta në Kosovë e ajo në Libi) dhe ndërhyrjet ndërkombëtare

5.2.1 Gjenocidi në Ruandë

Gjenocidi në Ruandë është një ndër tragjeditë më të mëdha që kishte parë bota që nga Lufta e Dytë Botërore. Edhe pse pati shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare, asnjë shtet nuk iu përgjigj krizës në kohë dhe mënyrë efikase. Komuniteti ndërkombëtar u përballë me një situatë të rëndë humanitare në Ruanda dhe një gjë e tillë ngriti shumë pyetje dhe debate lidhur me sovranitetin shtetëror dhe atë njerëzor, si dhe kush duhet ta mbrojë popullsinë e pafajshme. Gjatë përplasjes etnike të fiseve hutu dhe tutsi, afër 1 milion njerëz u vranë brenda një periudhe prej katër muajsh (Tatum, 2010, f. 50). Etnia tutsi ishte minoritet dhe shumë e njohur për shkak se prej shekujsh kishte qeverisur Ruandën, ndërsa ernia hutu- një komunitet që përbënte shumicën – kishte ardhur në pushtet pas një rebelimi 3-vjeçar nga viti 1959 deri në 1963 (Qose, 2015, f. 244). Lufta filloi në vitin 1990 kur *Fronti Patriotik Ruandez*, i përbërë nga një grup refugjatësh tutsi të vendosur në Uganda, hyri në Ruanda në përpjekje për të rrëzuar qeverinë e drejtuar nga etnia hutu. Përplasia etnike solli spastrimin dhe vrasjen e shumë hutuve në veri dhe tutsëve në jug. Vala e gjenocidit kulmoi me vrasjen e presidentit Xhuvanal Habjarimana në prill të vitit 1994, aeroplani i të cilit u godit me raketë në

aeroportin Kigali (BBC, 2011). Vrasja e presidentit solli një reagim të menjëhershëm ku grupet hutu nisën masakrat ndaj tutsëve. Gjenocidi u krye me mjetet më makabre që ka njohur njerëzimi, përfshirë hanxharë, thika, kazma si dhe iu vunë flaken spitaleve, shkollave dhe kishave ku strehoheshin banorët tutsi. Përveç viktimave të shumta, rreth 2 milion tutsi u transferuan si refugjatë në Zaire – Republika e sotme Demokratike e Kongos (Qose, 2015, f. 245).

OKB-ja hartoi një raport për situatën në Ruanda, dhe Këshilli i Sigurimit, përmes rezolutës 846 në vitin 1993 themeloi Misionin e Asistencës së Kombeve të Bashkuara në Ruanda (UNAMIR) i cili kishte për detyrë të ofronte sigurinë në kryeqytetin Kigali si dhe të monitoronte përmbushjen e armëpushimit mes Qeverisë së Ruandës dhe Frontit Patriotik Ruandez nën ndërmjetësimin e SHBA-së, Francës dhe Organizatës së Bashkimit Afrikan (UN Security Council, 1993).

UNAMIR nuk kishte kompetenca për të marrë pjesë në operacionet e çarmatimit, të përdortë forcë, qoftë edhe në mbrojtjen e civilëve. Në 17 maj 1994, Këshilli i Sigurimit miratoi rezolutën 912, me të cilën vendosi embargo armësh ndaj qeverisë të Ruandës, ndërsa në 8 qershor miratoi rezolutën 925 sipas të cilës në Ruanda ishte kryer gjenocid (UN Security Council, 1994).

Më 8 tetor 1994, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 955, me anë të së cilës u krijua Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën, me qëllimin e “ndjekjes penale të personave përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e Ruandës midis 1 janarit 1994 dhe 31 dhjetorit 1994” (UN Security Council, 1994). Dështimi i komunitetit ndërkombëtar u kritikua ashpër, sidomos për veprimin e ngadaltë dhe të vonuar. OKB-ja dështoi t’i përgjigjej në kohë dhe në mënyrë efikase krizës në Ruanda. Më vonë Kombet e Bashkuara caktuan një Komision të Pavarur Hetimor për të vlerësuar rolin e OKB-së në krizën në Ruanda, me anë të të cilit u vërtetua se OKB-ja kishte dështuar në mbrojtjen e popullsisë nga gjenocidi (UN Security Council, 1999).

5.2.2 Gjenocidi në Bosnjë (Srebrenicë)

Gjenocidi në Bosnjë ishte një nga më të rëndët që kishte ndodhur në Evropë, pas atij që kryen gjermanët nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai lidhet me emrin e Slobodan Millosheviqit, i cili rrëzoi nga pushteti pasardhësin e Titos, Ivan Stamboliqin (Qose, 2015, f. 250). Qëllimi i Millosheviqit ishte të ruante një shtet të dominuar nga serbët, duke penguar çdo tentativë për pavarësi nga ana e republikave apo krahinave autonome të Jugosllavisë, dhe këtë e bënte duke inkurajuar dhe nxitur nacionalizmin serb (Word Without Genocide, 2020).

Shpërbërja e ish Jugosllavisë ishte e përgjakshme dhe filloi në vitin 1991. Më 25 qershor, pas referendumeve të brendshme, Sllovenia dhe Kroacia shpallën pavarësinë. Në Slloveni konflikti zgjati vetëm 10 ditë, por në Kroaci, ai u ashpërsua me krime të rënda, duke tërhequr vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar. Përpjekje për shpallje të pavarësisë do të bënte edhe Bosnjë-Hercegovina, por kjo lëvizje u përgjak gjithashtu (Word

Without Genocide, 2020). Menjëherë pas pavarësisë, komuniteti serb që përbënte një pjesë të konsiderueshme të republikës së Bosnjës, shpalli Republikën Serbe të Bosnjës në krye me Radovan Karaxhiqin, i cili së bashku me Ratko Mlladiqin (komandant i forcave boshnjako-serbe) ishin mbështetësit e ideologjisë së Millosheviqit. Sarajeva u rrethua, ndërsa masakrat që vijuan ishin të ngjashme me ato të nazistëve ndaj hebrenjve (Qose, 2015, f. 251). Bosnja u bë skenë e gjenocidit, varrezave masive, përdhunimeve, gjymtimeve dhe torturave. Një ndër masakrat më famëkeqe ndodhi në Srebrenicë, një qytet me shumicë boshnjakësh myslimanë, i cili ishte shpallur zyrtarisht si “zonë e sigurt” nga Kombet e Bashkuara. Në korrik të 1995, gjenerali serb Ratko Mlladiq dhe trupat e tij hynë në “zonën e sigurt” duke mposhtur forcat holandeze të UNPROFOR, ndanë gratë dhe fëmijët nga burrat dhe vranë mbi 8 000 boshnjakë (Smith J., 2017). Masakrat në Bosnjë, parë nga aspekti juridik i përkufizimit të gjenocidit, jo vetëm që e përmbushnin por edhe tejkalonin këtë vepër penale (Qose, 2015, f. 257). Gjenocidi zgjati deri në dhjetor të vitit 1995, kur u nënshkrua Marrëveshja e Dejtonit, me të cilën iu dha fund luftës disavjeçare, dhe u mundësua ndarja e Bosnjës-Hercegovinës. 51% në territorin të saj i kaloi Federatës së Bosnjë-Hercegovinës ndërsa 49% në Republikën Serbe (Word Without Genocide, 2020).

Komuniteti ndërkombëtar dështoi në mbrojtjen e civilëve boshnjakë në të ashtuquajturat “zona të sigurta”. Trupat holandeze, siç sqarohet në raportin e sekretarit Kofi Anan, duhet të raportonin ngjarjet në terren, në kohë dhe në mënyrë të detajuar. Mirëpo palët në konflikt nuk respektonin autoritetin e OKB-së. Forcat e NATO-s arritën t’i jepnin fund konfliktit, vetëm pas 3 vitesh e gjysmë (UN General Assembly, 1999). I vetmi sukses i ndërkombëtarëve ishte vetëm krijimi i Gjykatës Penale për Krime Luftë në Ish Jugosllavi, për të trajtuar krimet si dhe për të arrestuar autorët e tyre, bazuar në Rezolutën 827 të OKB-së (UN Security Council, 1993). Kjo gjykatë paditi më shumë se 161 krerë shtetesh dhe ushtarakë, mes tyre edhe autorët Slllobodan Millosheviq, Radovan Karaxhiq dhe Ratko Mlladiq, të akuzuar për shkelje të Konventave të Gjenevës, për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

5.2.3 Lufta në Kosovë

Pas dështimit të komunitetit ndërkombëtar për të ndaluar shkeljet e rënda në Ruandë dhe Bosnjë, komuniteti ndërkombëtar u vendos përballë një dileme të madhe me çështjen e Kosovës. Në bazë të kushtetutës së vitit 1974, Kosova gëzoi statusin e një krahine autonome, ndërsa pas vdekjes së Titos, shqiptarët që përbënin 90% të popullatës do të kërkonin shpallen e saj republikë. Nga ana tjetër, serbët (10%) synonin marrëdhënie më të ngushta me pjesën tjetër të Serbisë, dhe ankoheshin për diskriminim nga shqiptarët (Bekaj, 2010).

Lidhur me ankesat se serbet po keqtrajtoheshin në Kosovë, presidenti Ivan Stamboliq dërgoi zëvendësin e tij Slllobodan Millosheviqin në Kosovë për t’u marrë me këtë çështje. Më 24 prill 1987, Millosheviqi mbledhi serbët në një protestë dhe iu drejtua turmës me fjalët “askush nuk guxon t’ju rrahë” (Toal & Dahmal, 2011, f. 41). Këto fjalë u kapën në video dhe shfaqeshin vazhdimisht në televizionin e Beogradit. Me këto shkëndija

nacionalizmi, Slobodan Millosheviqi në shtator të vitit 1987 erdhi në pushtet, si hero kombëtar duke rrëzuar shokun e tij të ngushtë Ivan Stamboliqin. Sapo erdhi në pushtet, Millosheviqi ia ngushtoi autonominë Kosovës, mori në kontroll të drejtpërdrejtë policinë dhe sistemin gjyqësor, shfuqizoi mediat dhe gazetat duke i lënë shqiptarët me një program televiziv shqip të menaxhuar nga Beogradi, si dhe transferoi kontrollin e kompanive në duart e shtetit. Shqiptarët e Kosovës refuzuan t'i nënshtroheshin kësaj politike dhe më 2 korrik të vitit 1990, deputetët e Asamblesë së Kosovës shpalosën Deklaratën e Pavarësisë duke e shpallur Kosovën si republikë të pavarur (Tatum, 2010, f. 121). Kosovarët krijuan institucionet e tyre paralele politike ndërsa lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova, në vitin 1992 u zgjodh President i Kosovës.

Rritja e dhunës serbe si dhe përleshjet e vazhdueshme sollën deri në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në vitin 1996. Falë financimit nga diaspora, UÇK-ja do të bëhej faktor kyç gjatë konfliktit të mëvonshëm. Krijimi i saj rezultoi me një reagim të dhunshëm nga qeveria serbe duke e shpallur atë si organizatë terroriste (International Independent Commission on Kosovo, 2000, f. 53).

Viktima e parë e brutalitetit serb ishte një mësues shqiptar që u qëllua në klasën e tij afër Prishtinës, në nëntor të vitit 1997 (Stoessinger, 2008, f. 157). Fushata e masakrave serbe filloi me sulmet në fshatrat e Drenicës, të administruara ushtarakisht nga Adem Jashari. Më 5 mars serbët sulmuan edhe Prekazin, në mënyrë të veçantë shtëpinë e Adem Jasharit, duke masakruar krejtësisht familjen e tij prej 52 anëtarësh, pa kursyer gratë dhe fëmijët. Këto masakra tërhoqën vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar, pavarësisht këmbënguljes së qeverisë jugosllave se ky konflikt ishte një çështje e brendshme. Më 31 mars 1998, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1160 e cila vendoste “embargo armësh në Republikën Jugosllave, përfshirë edhe Kosovën, ndërprerjen e armiqësive dhe akteve terroriste dhe zgjidhjen politike dhe diplomatike të çështjes” (UN Security Council, 1998). Më 23 shtator të 1998-së, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën tjetër 1199, e cila e përcaktoi situatën në Kosovë si kërcënim të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Rezoluta në fjalë bënte thirrje që autoritetet jugosllave dhe udhëheqja shqiptare e Kosovës të ndërmerrnin hapa të menjëhershëm për të shmangur katastrofën humanitare të afërt (UN Security Council, 1998).

Pas dështimit të tentativave diplomatike për qetësimin e konfliktit në Kosovë, në 24 mars të 1999-së, NATO filloi Operacionin e Forcave Aleate, operacion i cili përfshinte një fushatë ajrore për të penguar sulmet e Millosheviqit në Kosovë dhe për të dëmtuar seriozisht kapacitetet ushtarake të Jugosllavisë (International Independent Commission on Kosovo, 2000, f. 85). Bombardimet përfunduan më 11 qershor të vitit 1999, kur Millosheviqi pranoi të ndalte dhunën dhe të tërhiqte forcat serbe nga Kosova. Megjithatë, një forcë ndërkombëtare nën mbikëqyrjen e OKB-së mbeti e pranishme në Kosovë. Me rezolutën 1244 të miratuar nga Këshilli i Sigurimit u themelua Misioni i Posaçëm i Administrimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), qëllimi i të cilit ishte krijimi i kushteve paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimi i stabilitetit rajonal të Ballkanit Perëndimor (UN Security Council, 1999). Kosova sot është shtet i

pavarur dhe sovran, i njohur nga më shumë se 113 shtete anëtare të OKB-së (Be In Kosovo, 2020).

Ndërhyrja e NATO-s, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, nga aspekti i të Drejtës Ndërkombëtare bie ndesh me Kartën e OKB-së, pavarësisht se SHBA-ja e justifikonte veprimin e NATO-s si një imperativ moral për të parandaluar tragjedinë humanitare dhe vrasjen e popullsisë civile në Kosovë. Nga ana tjetër, vetoja e Rusisë ndaj çdo rezolute në Këshillin e Sigurimit për ndërhyrje ushtarake ndaj Serbisë tregonte qartë se imperativi moral për ta, nuk ekzistonte.

Kështu, SHBA-ja dhe aleatët e saj nëpërmjet NATO-s ndërhynë në emër të të drejtave të njeriut dhe vlerave njerëzore për të parandaluar gjenocidin në Kosovë. SHBA-ja e cila ishte nxitësja më e madhe e kësaj ndërhyrjeje, kishte theksuar se nuk do të lejonte që Kosova të bëhej një Bosnjë të dytë (Qose, 2015, f. 276).

5.2.4 Ndërhyrja ndërkombëtare në Libi

Ndërhyrja e NATO-s në Libi është një ndër rastet e rralla ku Këshilli i Sigurimit autorizoi përdorimin e forcës kundër qeverisë së një shteti. Për dallim nga rastet e tjera, ku ndërhyrjet nuk e kishin autorizimin e Këshillit të Sigurimit apo ishin të njëanshme, në rastin e Libisë ndërhyrja mori miratimin, falë abstenimit të Rusisë dhe Kinës (Abomo, 2019, f. 39). Instrumenti më adekuat i komunitetit ndërkombëtar në parandalimin e gjenocidit në Libi, ishte ndërhyrja ushtarake bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe bazuar në doktrinën R2P.

Pranvera Arabe, pas suksesit që shënoi me rrëzimin nga pushteti të Ben Alisë (president i Tunizit) dhe të Hosni Mubarak (president i Egjiptit), arriti edhe në Libi në 15 shkurt të 2011-së, me aktin e shtypjes me dhunë të një proteste në Bengazi (Roberts, 2011).

Protestat kundër qeverisë u përhap shpejtë në Libi në një lëvizje për të rrëzuar Muamer Gadafin i cili kishte sunduar vendin për gati 41 vjet (BBC News, 2013). Ato u nxitën nga arrestimet e kritikuesve të qeverisë, përfshirë edhe një avokat i cili përfaqësonte familjet e rreth 1 600 të burgosurve që ishin vrarë në burgun Ali Salim të Tripolit në 1996 (Taylor W. , 2014, f. 147). Lidhur me protestat, Gadafi mbajti fjalim në të cilin iu referua protestuesve si “minj” dhe “buburrecë”, ndërsa kërkoi publikisht nga forcat e sigurisë që të mos tregonin mëshirë ndaj kryengritësve deri sa të dorëzohen (ICRtoP, 2020). Forcat e sigurisë arrestuan dhe sulmuan protestuesit paqësorë në Bengazi dhe në qytete të tjera të Libisë. Sipas organizatave për të drejtat e njeriut, deri më 20 shkurt, rreth 233 persona ishin vrarë, përfshirë edhe civilë (Watch, Human Rights, 2012). Regjimi i Gadafit vazhdoi edhe më tej dhunën duke shkaktuar gati 10 mijë viktima deri më 17 mars të 2011-së (Qose, 2015, f. 284).

Reagimi ndërkombëtar për goditjen e Muamer Gadafit ishte i shpejtë. Dy rezolutat e OKB-së për Libinë, 1970 dhe 1973 të miratuara nga Këshilli i Sigurimit në mars të vitit 2011 si kundërpërgjigje ndaj një krize të mundshme humanitare, vunë shtetet para përgjegjësisë se diçka duhej bërë. Një gjë e tillë u vu re edhe në mënyrën e votimit në

Këshillin e Sigurimit, për rezolutat në fjalë. Megjithë ndasitë që manifestonin, shtetet u shprehën njëzëri për të mbrojtur civilët. Rezoluta kaloi me 10 vota në favor dhe 5 abstenime (asnjë kundër) (Qose, 2015, f. 137). Rezoluta e parë (1970) nënkuptonte sanksione ndaj familjes së Gadafit, ngrirjen e pasurive si dhe ndalimin e fluturimeve për zyrtarët e regjimit të tij (UN Security Council, 2011). Por, me vazhdimin e akteve të dhunës ndaj kryengritësve dhe popullatës së tij, Këshilli i Sigurimit miratoi në formë urgjente edhe rezolutën e dytë (1973) që vendoste një zonë ndalim-fluturimesh në mbrojtje të popullatës (UN Security Council, 2011).

Regjimi i Muamer Gadafit filloi të masakronte popullatën e tij, duke përdorur madje edhe armë kimike. Këto prova mblidheshin nga organizata të ndryshme ndërkombëtare sikurse Human Rights Watch dhe Amnesty International, grupe për të drejtat e njeriut etj., dhe më vonë u faktuan nga Prokuroria e Hagës, e cila ngrii akuzat kundër Gadafit, djalit të tij dhe njerëzve të afërt të regjimit, për krime lufte dhe krimin e persekutimit (Qose, 2015, f. 186).

Pavarësisht se gjenocidi në Libi kryhej ndaj një grupi të caktuar “thwarts” (kryengritësve), fakti që gjithë popullata doli në mbështetje të pranverës arabe dhe kundër regjimit të Gadafit nënkuptonte se krimi i gjenocidit ishte i predispozuar të shtrihej në përmasa të gjera ndaj gjithë popullatës. Vendimi për ndërhyrjen ndërkombëtare në Libi u mor në kuadër të 3 javëve, edhe pse ndërkombëtarët kishin dështuar më herët, në rastin e Bosnjës, Ruandës etj., pasi fuqitë e mëdha nuk mund të merreshin vesh. Pas luftës disa mujore (19 mars – 31 tetor) regjimi i Gadafit më në fund ra. Forcat kryengritëse të ndihmuara edhe nga NATO-ja, më 20 tetor gjatë sulmit të qytetit Sirt - vendlindje e Gadafit – vranë ish lideri Gadafi në një tentativë të tij për t’u arratisur (O’Sullivan, 2018, f. 1).

Në fund të muajit tetor, NATO-ja njoftoi mbylljen e misionit të saj ku ishin angazhuar 16 shtete. Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, Anders Fog Rasmussen theksonte se “*NATO-ja përmbushi plotësisht mandatin historik të OKB-së për të mbrojtur popullin në Libi*” (NATO, 2011).

5.2.5 Përgjegjësia për të Mbrojtur: Rasti i Rohingyave në Mianmar

Sipas doktrinës R2P, qeveria e Mianmarit dhe komuniteti ndërkombëtar kanë për detyrë dhe përgjegjësi të mbrojnë rohingasit nga katër krimet e lartpërmendura kundër njerëzimit. Për situatën e rohingasve në Mianmar paralajmëruan shumë institucione ndërkombëtare, të cilët kërkuan ndërhyrje të menjëhershme nga komuniteti ndërkombëtar në parandalimin e gjenocidit, spastrimit etnik dhe krimet kundër njerëzimit që kryente qeveria e Mianmarit. Pavarësisht refuzimit të krimeve nga ana e autoriteteve të Mianmarit, raporte të shumta, dëshmi të bazuara në hetime, si dhe hulumtime nga institucione të ndryshme (organizata joqeveritare për të drejtat e njeriut) vërtetohnin se kërcënimi i mizorive masive ndaj rohingasve ishte real.

Qeveria, përveç mohimit përmes mediave të saj, nuk paraqiti prova për të kundërshtuar gjetjet dhe provat nga institucionet ndërkombëtare (Ibrahim & Nordin, 2015, f. 10). Komuniteti ndërkombëtar nga ana tjetër vendosi sanksione si dhe përdori mjete

diplomatike për të adresuar krizën e rohingasve, megjithatë masat nuk ishin efikase dhe shkeljet e të drejtave të njeriut vazhduan. Mianmari, siç kemi përmendur më lartë, ishte në qendër të debatit ndërkombëtar, mirëpo thirrjet për veprim ishin të pasuksesshme.

Projektrezoluta e vitit 2007, e hartuar nga SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar, nëpërmjet të cilës kërkohet nga qeveria e Mianmarit të lejoheshin ndihmat humanitare për qytetarët e saj, të respektoheshin normat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të bëhej progres drejt demokratizimit të vendit dështoi sepse Rusia dhe Kina përdorën të drejtën e vetos në Këshillin e Sigurimit në fund të debatit (ICRtoP, 2020). Kina dhe Rusia u përgjigjën në mënyrë të ngjashme edhe kur çështja e refugjatëve rohingas u vendos për diskutim para Këshillit të Sigurimit në vitin 2017. SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar synonin reagim të fuqishëm nga Këshilli i Sigurimit kundër qeverisë së Mianmarit, ndërsa Kina dhe Rusia ishin kundër – ato as që e njohën krizën e rohingasve, jo më krimin e spastrimit etnik (Khan & Ahmed, 2019, f. 4).

Për krizën e vitit 2017, Këshilli i Sigurimit lëshoi vetëm një deklaratë të presidentit të Këshillit të Sigurimit e cila iniciohet kur nuk arrihet konsensus ose kur frenohet miratimi i rezolutës. Deklarata theksonte përgjegjësinë e qeverisë së Mianmarit për të mbrojtur popullsinë e saj përmes respektimit dhe sundimit të ligjit, si dhe përmes promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut (UN News, 2017). Shkeljet e rënda u njohën edhe nga Misioni i Pavarur Ndërkombëtar Fakt-Gjetës i Kombeve të Bashkuara, pa ndonjë veprim konkret, përveç presioneve diplomatike, sanksioneve ekonomike dhe embargo të armëve. Sipas raportit të këtij misioni, autoritetet e Mianmarit, përfshirë edhe Këshilltaren e Shtetit Aung San Suu Kyi, dështuan në “përgjegjësinë për të mbrojtur civilët” dhe ishin bashkëpunëtorë në kryerjen e krimeve (Adams, 2019, f. 15).

Ky mision i bënte thirrje gjithashtu Këshillit të Sigurimit për ta trajtuar situatën në Mianmar, në Gjykatën Penale Ndërkombëtare ose të krijohej një Gjykatë Ndërkombëtare Ad-Hoc vetëm për krimet në këtë shtet.

Pavarësisht përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të kontribuar në zhvillimin dhe demokratizimin e Mianmarit, kushtet kryesore për implementimin e suksesshëm të R2P nga Këshilli i Sigurimit nuk u përmbushën. Sipas Jared Genser, ekzistojnë tre kushte përcaktuese që Këshilli i Sigurimit të përmbush me sukses doktrinën R2P. *E para*, të mos ketë pengesë nga qeveria që kryen krime të rënda, ose, nëse pengimi i qeverisë ndodh, atëherë një nga pesë shtetet anëtare të Këshillit të Sigurimit duhet të sigurojnë vullnetin politik për ta kapërcyer këtë pengesë. *E dyta*, të ekzistojë bashkëpunimi midis organizatave rajonale dhe Këshilli i Sigurimit të koordinojë R2P. *E treta*, vetëm Këshilli i Sigurimit ka aftësinë dhe kapacitetin për të reaguar shpejt ndaj kryerjes së krimeve të mizorisë, dhe t’i mbrojë civilët në mënyrë efikase (Genser, 2018, f. 2).

Mirëpo, rastet në Siri, Jemen dhe Mianmar, si raste me përgjigje të vonuar dhe bllokuar nxorrën në pah kushtin e katërt, veton e pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit si pengesë për zbatimin dhe implementimin e mandatit të R2P. Edhe sikur tre kushtet e lartpërmendura të përmbushen në rastin e Mianmarit, ato janë sekondare përballë kushtit të katërt, vetos nga Rusia dhe/ose nga Kina (Genser, 2018, f. 4).

Mandati i R2P në kuadër të Këshillit të Sigurimit lidhur me situatën e rohingasve në Mianmar mbetet i bllokuar; qeveria vazhdon të kryejë krime ndaj popullsisë civile (Genser, 2018, f. 7).

KEY CONDITIONS IMPACTING SECURITY COUNCIL IMPLEMENTATION OF R ₂ P IN CASE STUDIES			
COUNTRIES	LACK OF GOVERNMENT OBSTRUCTION OR HIGH P ₅ ENGAGEMENT	SECURITY COUNCIL COOPERATION WITH REGIONAL ORGANIZATIONS	RAPID CAPACITY TO RESPOND
	Conditions Key:  Fully Present  Mostly Present  Fully Absent  Mostly Absent		
<i>More Successful Implementation</i>			
Côte d'Ivoire			
Libya			
Mali			
<i>Lack of Successful Implementation</i>			
Central African Republic			
Democratic Republic of the Congo			
Sudan			
South Sudan			
<i>Stalled Response</i>			
Democratic People's Republic of Korea			
Myanmar			
Syria			
Yemen			

Fig. 1 Kushtet që kanë bërë Këshillin e Sigurimit të ndërhyjë në kuadër të R2P-së

Cikloni “Nargis” dhe “Përgjegjësia për të Mbrojtur”

I vetmi rast kur R2P u përdor për Mianmarin, ishte vetëm me krizën humanitare të shkaktuar në vitin 2008 nga cikloni “Nargis” përgjatë lumit Irrawady ku preku 1,5 milion banorë dhe la të vdekur 138 000 njerëz (Bensaoud, 2015, f. 10).

KAPITULLI IV

6. REZOLUTAT E OKB-SË DHE DËSHTIMI I KËSHILLIT TË SIGURIMIT

Minamari u bë shtet anëtar i OKB-së që në vitin 1948 (UN Security Council, 1948). Por, pavarësisht kësaj, dhe krimeve që zhvilloheshin që prej 1978, në vitet 1991-92 apo edhe më vonë, OKB-ja nuk pati luajtur ndonjë rol të madh ndaj Mianmarit për të frenuar diskriminimet e juntës ushtarake (Storal, 2018, f. 4).

Edhe lidhur me krimet e fundit, Këshilli i Sigurimit nuk miratoi asnjë rezolutë, përkundër tentativave të disa anëtarëve për ta trajtuar krizën e rohingasve pranë Këshillit të Sigurimit. Sikurse u theksua edhe në kapitujt më sipër, këto përpjekje, ose bllokoheshin me fuqinë e vetos nga Rusia dhe Kina ose përfundonin si deklaratë presidenciale e Presidentit të Këshillit të Sigurimit.

Tentativa e parë me të cilën komuniteti ndërkombëtarë filloi të merrej me shkeljet e të drejtave të njeriut në Mianmar ishte projektrezoluta e hartuar nga Mbretëria e Bashkuar, Irlanda e Veriut dhe SHBA-ja në vitin 2007 (UN News, 2007). Projekt rezoluta i bënte thirrje qeverisë së Mianmarit të lironte të burgosurit politikë, përfshirë edhe Aung Sang Suu Kyi, duke shprehur shqetësimin për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut kundër pakicave etnike, dhunën kundër civilëve të paarmatosur nga ushtria e Mianmarit, vrasjet e paligjshme, përdhunimet, torturimet, punën e detyruar si dhe heqjen e kufizimeve për ndihmat humanitare (UN Security Council, 2007).

Projekt rezoluta nuk kaloi, pasi Rusia dhe Kina përdorën fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit. Për Kinën, situata në Mianmar ishte çështje e brendshme e një shteti sovran dhe ajo nuk përbënte kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ndërsa për Rusinë, situata në Mianmar nuk kishte nevojë të trajtohej në Këshillin e Sigurimit, por mjaftonte në organet e tjera të OKB-së, si Këshilli i të Drejtave të Njeriut dhe Asambleja e Përgjithshme (United Nation Press, 2007). Pas dështimit të projektrezolutës në fjalë, disa muaj më vonë (11 tetor 2007), presidenti i Këshillit të Sigurimit përgatiti një deklaratë në emër të Këshillit lidhur me "situatën në Mianmar". Në të thuhej se Këshilli i Sigurimit shprehte keqardhjen për përdorimin e dhunës kundër demonstratave paqësore në Mianmar. Në deklaratë theksohej sërish rëndësia e lirimit të të gjithë të burgosurve politikë, si dhe i bëhej thirrje qeverisë së Mianmarit që të ndërmernte masa që kishin të bënin me të drejtat e njeriut, të drejtat politike, ekonomike dhe humanitare (UN Security Council, 2007).

Një tentativë e dytë për ta trajtuar krizën dhe krimet ndaj rohingasve në Mianmar ishte hartimi i një draft-rezolute nga Franca dhe Mbretëria e Bashkuar në vitin 2017. Draftrezoluta synonte të vendoste afate kohore për kthimin e më shumë se 700 000 refugjatëve rohingas nga Bangladeshi në Mianmar, gjetjen e përgjegjësisë lidhur me krizën, si dhe vendosjen e sanksioneve për Mianmarin. Kina dhe Rusia morën pjesë në takimin fillestar lidhur me draft rezolutën, ndërsa në raundet e tjera të bisedimeve, bojkotuan (The Diplomat, 2017). Abstenimi i Kinës dhe Rusisë për të marrë pjesë në këto bisedime dërguan sinjalin se rezoluta në fjalë nuk mund ta kalonte pragun e Këshillit të Sigurimit, për shkak të

mundësisë së përdorimit të vetos. Kina dhe Rusia dhanë miratimin e tyre pasi Franca dhe Mbretëria e Bashkuar ulën tonet dhe e shndërruan atë në një deklaratë presidenciale të Presidentit të Këshillit të Sigurimit, e cila (ndryshe nga rezoluta) nuk është e zbatueshme (Yap, 2017).

Në deklaratën e presidentit të Këshillit të Sigurimit u dënuan sulmet e kryera nga Ushtria e Shpëtimit të Rohingasve nga Arakani – ARSA, kundër forcave të sigurisë të Mianmarit më 25 gusht në shtetin Rakhinë. Në deklaratën e lartpërmendur, Këshilli i Sigurimit shprehte shqetësim të madh lidhur me raportet për shkeljet dhe abuzimet e të drejtave të njeriut në shtetin Rakhinë, ku forcat e sigurisë të Mianmarit kishin detyruar të zhvendoseshin rreth 607 000 rohingas muslimanë (UN Security Council, 2017, f. 1). Më tej, në deklaratë, theksohej se përgjegjësia kryesore e qeverisë së Mianmarit ishte mbrojtja e popullatës civile të saj, duke përfshirë respektimin dhe sundimin e ligjit, si dhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Deklarata presidenciale bënte thirrje për mos përdorimin e tepërt të forcës ushtarake në shtetin Rakhinë dhe të ndërmerreshin të gjitha masat e nevojshme për dialog, që do të frenonte nxitjen e dhunës ose urrejtjes (UN Security Council, 2017, f. 2).

Përveç dy deklaratave të lartpërmendura të Presidentit të Këshillit të Sigurimit lidhur me krizën e rohingasve në Mianmar, në vitin 2018 dy letra nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit iu drejtuan Presidentit të Këshillit të Sigurimit, për ta rikthyer këtë çështje në rendin e ditës së Këshillit të Sigurimit.

Më letrën e datës 16 tetor të vitit 2018 nga përfaqësuesit e Bregut të Fildishtë, Francës, Kuvajtit, Holandës, Perusë, Polonisë, Suedisë, Mbretërisë së Bashkuar, Irlandës së Veriut dhe SHBA-së drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit, u kërkua që Këshilli i Sigurimit të mbante takim për situatën në Mianmar. Në letër kërkohet që në të takim të merrte pjesë edhe kryetari i Misionit të Pavarur Ndërkombëtar Fakt-Gjetës për Mianmarin, për të referuar para anëtarëve të Këshillit për situatën në Mianmar dhe implikimet e saj në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare (UN Security Council, 2018).

Kjo tentativë u kundërshtua me një letër tjetër, më datën 18 tetor të 2018-së, e dërguar nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit Kina, Rusia si dhe Bolivia dhe Guinea Ekuatoriale. Në letrën drejtuar kryetarit të Këshillit të Sigurimit, thuhej se shtetet e lartpërmendura e kundërshtojnë fuqishëm referimin para këshillit të Kryetarit i Misionit të Pavarur Ndërkombëtar Fakt-Gjetës për Mianmarin i krijuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut për të informuar Këshillin e Sigurimit. Sipas Kinës dhe Rusisë, është jashtë kompetencave që kryetari i misionit të informojë para Këshillit të Sigurimit (por vetëm para Këshillit për të Drejtat e Njeriut). Një akt i tillë do të përbënte një precedent të keq në të ardhmen, me pasoja negative serioze (UN Security Council, 2018).

Pavarësisht përplasjes me letrat e mësipërme, Presidenti i Këshillit të Sigurimit vendosi që situata në Mianmar të vendosej për diskutim në agjendën e Këshillit të Sigurimit. Më 24 tetor të 2018-së, pesë anëtarët e përhershëm së bashku me anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurimit diskutuan situatën në Mianmar, pasi agjenda mori miratimin pro nga nëntë anëtarë, tre ishin kundër (Kina, Rusia dhe Bolivia) dhe tre anëtarë abstenuan. Pas miratimit të agjendës, për të referuar për situatën në Mianmar, para Këshillit të Sigurimit doli edhe

Marzuki Darusman, Kryetari i Misionit të Pavarur Ndërkombëtar Fakt-Gjetës për Mianmarin. Ai lexoi raportin e misionit (444 faqe) që bazohet në një hetim të paanshëm, sipas praktikave dhe metodologjive më të mira në gjetjen e fakteve për të drejtat e njeriut. Darusman theksoi se ngjarjet në shtetin Rakhine përbënin një katastrofë për të drejtat e njeriut, dhe se shkeljet e përshkruara në raport paraqisnin krime të rënda që kërcënonin paqen, sigurinë dhe mirëqenien botërore (Besheer, 2018).

Misioni gjeti gjithashtu informacione të mjaftueshme për të garantuar hetim dhe ndjekje penale të zyrtarëve të lartë të Ushtrisë së Mianmarit – Tatmadaw, me akuzën e gjenocidit (UNHRC, 2018). Kryetari i misionit në fund të fjalimit të tij, i rekomandoi Këshillit të Sigurimit që të transferonte çështjen e Mianmarit pranë Gjykatës Penale Ndërkombëtare, të vendoste sanksione kundër përgjegjësve të krimeve të rënda si dhe të ndërmerre veprime për të drenuar krimet që ende vazhdonin të ndodhnin në Mianmar (Fassihi, 2018).

Darusman mbaroi fjalimin e tij duke thënë se “soveraniteti shtetëror nuk është licencë për të kryer krime kundër njerëzimit dhe gjenocid” (UNHRC, 2018).

Pas kësaj, presidenti i Këshillit të Sigurimit i dha hapësirë anëtarëve për të dhënë deklarata, me të cilat Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe SHBA-ja shprehën njëzëri shqetësimet për krimet e kryera kundër rohingasve në Mianmar dhe se është përgjegjësi e Këshillit të Sigurimit të ndërmarrë veprime lidhur me situatën në Mianmar (UN Security Council, 2018). Kina dhe Rusia dhanë gjithashtu deklarata duke përsëritur qëndrimin e tyre se Misioni Ndërkombëtar Fakt-Gjetës për Mianmarin bazohet në informacione jo të plota dhe se rekomandimet e tij përbëjnë ndërhyrje të qëllimshme në punët e brendshme të sovranitetit të Mianmarit. Gjatë deklaratave, anëtarët e Kinës dhe Rusisë përsëritën faktin se çështje specifike për të drejtat e njeriut nuk janë në mandatin e Këshillit të Sigurimit (UN Security Council, 2018).

Në fund të takimit, presidenti i Këshillit të Sigurimit i dha fjalën edhe përfaqësuesit të Mianmarit i cili i hodhi poshtë akuzat ndaj shtetit të tij për kryerjen e krimeve të rënda kundër rohingasve, dhe se situata në shtetin Rakhine nuk kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ai theksoi se pothuajse të gjitha rekomandimet e Komisionit Këshillëdhënës për shtetin Rakhine ishin përmbushur dhe se raporti i misionit të lartpërmendur është i njëanshëm (UN Security Council, 2018).

Situata në Mianmar u diskutua para Këshillit të Sigurimit edhe më 28 shkurt të vitit 2019. Në këtë takim mori pjesë edhe i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Mianmarin, Christine Schraner Burgener. Ajo tregoi për 5 vizitat e saj në Mianmar, veçanërisht në kampet e refugjatëve rohingas të cilët jetonin në kushte jashtëzakonisht të rënda (UN Security Council, 2019, f. 2). Ajo theksoi rëndësinë e angazhimit të shtetit të Mianmarit, në hartimin e një strategjie për mbylljen e kampeve të zhvendosura brenda vendit, përfshirë këtu edhe çështjen e shtetësisë dhe vendosjen e lirisë së lëvizjes për rohingasit myslimanë. Në fund të fjalimit, Burgener rikujtoi rëndësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të lira në vitin 2020, të cilat do t'i përshpejtonin reformat demokratike lidhur me diskriminimin e institucionalizuar të rohingasve (UN Security Council, 2019, f. 3).

Kina dhe Rusia theksonin se me Mianmarin duhet të vazhdohej *shuttle diplomacy* për zgjidhjen e çështjes, ndërsa Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe SHBA-ja nga ana tjetër këmbëngulnin që Mianmari të rikthente në vendlindje refugjatët dhe të zhvendosurit, të mos pengonte ndihmat humanitare dhe si dhe t'i jepte fund krimeve dhe përndjekjeve. Ato këmbëngulnin edhe në rëndësia e hartimit të një rezolute të Asamblesë së Përgjithshme e cila do të trajtonte situatën e të drejtave të njeriut në Mianmar (UN Security Council, 2019).

Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme lidhur me krimet kundër rohingasve në Mianmar

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi disa rezoluta lidhur me situatën në Mianmar, mirëpo siç dihet, ato nuk janë të obligueshme për shtetet anëtare. Ndër më të rëndësishmet janë këto:

Rezoluta 67/233 - "Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar" e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 24 dhjetor 2012, përmes së cilës u shpreh shqetësimi për shkeljet e të drejtave të njeriut, për dhunën dhe diskriminimin ndaj pakicës rohingase në shtetin Rakhine (UN General Assembly, 2013). Rezoluta në fjalë bënte thirrje nga qeveria e Mianmarit që të ndërmernte të gjitha veprimet e nevojshme për të ndaluar valën e dhunës që shpërtheu midis budistëve dhe myslimanëve rohingas, ta trajtonte çështjen në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe përshëndeste krijimin e një komisioni hetimor për situatën në shtetin Rakhine për të siguruar një hetim të pavarur, transparent dhe të plotë, me pjesëmarrjen e të gjithë të prekurve, përfshirë edhe rohingasit, me qëllim që të sillte para drejtësisë përgjegjësit e shkeljeve (UN General Assembly, 2013).

Rezoluta 68/242 - "Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar" e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 27 dhjetor 2013 përsëriti shqetësimin për situatën e rohingasve në shtetin Rakhine, përfshirë rastet e përsëritura të dhunës mes etnive dhe abuzimet e tjera ndaj rohingasve dhe pakicave të tjera myslimane në shtetet e tjera të Mianmarit (UN General Assembly, 2014). Rezoluta i bëri thirrje qeverisë së Mianmarit që të mbronte popullatën civile nga dhuna e vazhdueshme, si dhe të siguronte respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Kthimi vullnetar i personave të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatëve rohinga, liria e lëvizjes, kthimi i pronave të tyre dhe lejimi i shtetësisë për rohingasit ishin përsëritje e thirrjeve të mëparshme, të aktualizuara edhe nga kjo rezolutë e lartpërmendur (UN General Assembly, 2014).

Rezoluta 70/233 - "Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar" e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 23 dhjetor 2015 shprehte shqetësimin për situatën e rohingasve në shtetin Rakhine dhe pakicave të tjera që i nënshtroheshin marginalizimit (UN General Assembly, 2016). Rezoluta i bënte thirrje qeverisë së Mianmarit që të mbronte liritë dhe të drejtat e njeriut, përfshirë personat që i përkasin pakicës rohingase, të mos u mohonte të drejtën e përcaktimit, t'u siguronte qasje të barabartë të të drejtat civile dhe politike, si dhe të mos u mohonte të drejtën për shtetësi, martesë dhe regjistrim të fëmijëve, për qasje të barabartë në shërbime, shëndetësi dhe arsim e të tjera (UN General Assembly, 2016).

Rezoluta 72/248 - “Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 24 dhjetor 2017 i bënte thirrje autoritetet e Mianmarit që t’i jepte fund operacioneve ushtarake që nxisnin tensione midis komuniteteve dhe kishin prodhuar abuzime të të drejtave të njeriut, veçanërisht ndaj rohingasve (UN General Assembly, 2017). Rezoluta në fjalë kërkonte lejimin e plotë dhe të papenguar të shpërndarjes së ndihmave humanitare për rohingasit; zbatimin e rekomandimeve të Komisioni Këshillëdhënës (i kryesuar nga Kofi Anan); të sigurohej qasje të plotë për gjetjen e fakteve nga ana e Misionit të Këshillit për të Drejtat e Njeriut; të sigurohej mbrojtje të plotë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të myslimanëve rohingas dhe pakicave të tjera etnike dhe fetare (UN General Assembly, 2017).

Rezoluta 73/264 - “Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 22 dhjetor 2018 përsëriti shqetësimin për përdorimin e tepërt të forcës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut nga forcat ushtarake dhe të sigurisë së Mianmarit, përfshirë vrasjet e paligjshme, përdhunimet dhe format e tjera të dhunës seksuale, zhdukjet me forcë të civilëve rohingas, shkatërrimin në masë të gjerë të shtëpive, si dhe përdorimin e paligjshëm të forcës nga aktorët jo-shtetërorë ndaj myslimanëve rohingas (UN General Assembly, 2019). Rezoluta në fjalë riktheksonte shqetësimin se, edhe përkundër faktit se myslimanët rohingas jetonin aty që përpara pavarësisë së Mianmarit, ata ishin lënë pa shtetësi me ligjin kontrovers për shtetësi të vitit 1982, ishin shpëputur pa të drejtë nga proceset zgjedhore në vitin 2015, duke ua mohuar të drejtën për të votuar dhe për të qenë i zgjedhur (UN General Assembly, 2019).

Rezoluta 74/246 - “Situata e të drejtave të njeriut të myslimanëve rohingas dhe pakicave të tjera në Mianmar” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 27 dhjetor 2019 ishte rezoluta e fundit e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së lidhur me situatën e rohingasve në Mianmar (UN General Assembly, 2020). Kjo rezolutë dënoi shkeljet dhe abuzimet e të drejtave të njeriut në Mianmar, veçanërisht kundër myslimanëve rohingas në shtetin Rakhine. Ajo bënte sërish thirrje për ndërprerje të menjëhershme të luftimeve dhe armiqësisë ndërkohë që ritheksonte nevojën urgjente për sjelljen përpara drejtësisë të të gjithë kryerësve të krimeve në bazë të të drejtës ndërkombëtare (UN General Assembly, 2020).

Rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut lidhur me krimet kundër rohingasve në Mianmar

Këshilli për të Drejtat e Njeriut (UNHRC) është organi kryesor ndërqeveritar brenda sistemit të OKB-së i përbërë nga 47 shtete, përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen, si dhe për trajtimin e të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut në të gjithë globin. Këshilli ka zëvendësuar Komisionin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut i cili është kritikuar shpesh për nga përbërja e tij, pasi shpeshherë në të zgjidheshin edhe shtetet që nuk garantonin as liritë dhe të drejtat e qytetarëve të vet (Gruda, 2007, f. 29).

Këshilli për të Drejtat e Njeriut mban takime gjatë gjithë vitit për të trajtuar shkeljet e të drejtave të njeriut kudo ku ndodhin nëpër botë. Ai miraton rezoluta dhe jep

rekomandime, krijon komisione ndërkombëtare hetimore dhe misione fakt-gjetëse që hetojnë dhe ndihmojnë në gjetjen e përgjegjësve të krimeve si dhe sjelljen e tyre para drejtësisë (UNHRC, 2020).

Lidhur me krimet kundër rohingasve në Mianmar, Këshilli për të Drejtat e Njeriut miratoi disa rezoluta:

Rezoluta 32/22 – “Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar” e miratuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut më 24 mars 2017 kërkoi me urgjencë krijimin e një Misioni të pavarur ndërkombëtar për gjetjen e fakteve në Mianmar, për të hetuar të gjitha rrethanat e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ushtria dhe forcat e sigurisë në shtetin Rakhine. Rezoluta theksoi nevojën që misioni të gjente të gjitha burimet dhe ekspertizat e nevojshme për të përmbushur mandatin e tij (UNHRC, 2017).

Rezoluta 39/2 – “Situata e të drejtave të njeriut të rohingasve myslimanë dhe pakicave të tjera në Mianmar” e miratuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut më 27 shtator 2018 vendosi t’i zgjaste mandatin e Misionit fakt-gjetës deri sa dëshmitë e shkeljeve dhe abuzimeve të dokumentoheshin plotësisht (UNHRC, 2018). Rezoluta në fjalë kërkonte nga Komisionari i Lartë për të Drejtat e Njeriut të paraqiste një raport të shkruar mbi shkaqet thelbësore të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve të pakicës myslimane rohingase dhe pakicave të tjera në Mianmar, si dhe të rekomandonte masa konkrete që duhet të ndërmerrete qeveria e Mianmarit dhe bashkësia ndërkombëtare për trajtimin e situatës. Në rezolutë shprehej edhe shqetësimi se qeveria e Mianmarit nuk bashkëpunonte me Misionin për zbardhjen e duhur dhe të plotë të akteve të dhunës ndaj rohingasve (UNHRC, 2018).

Rezoluta 42/3 - “Situata e të drejtave të njeriut të rohingasve myslimanë dhe pakicave të tjera në Mianmar” e miratuar më 26 shtator 2019 si dhe rezoluta 40/29 – “Situata e të drejtave të njeriut në Mianmar” janë rezolutat e fundit të Këshillit. Këto rezoluta dënuan të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut në Mianmar, sidomos të rohingasve myslimanë si dhe të pakicave të tjera. Të dy rezolutat u bënë thirrje autoriteteve të Mianmarit që të ndalonin urgjentisht përdorimin e dhunës si dhe të ndëshkonin autorët e krimeve dhe të gjithë ata që shkelin ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ato humanitare dhe të së drejtës penale ndërkombëtare (UNHRC, 2019). Këshilli për të Drejtat e Njeriut miratoi edhe disa rezoluta lidhur me krimet kundër rohingasve në Mianmar, mirëpo siç dihet, këto rezoluta kishin vetëm fuqi rekomandimesh.

Raportet e Raportuesit Special për situatën e të drejtave të njeriut në Mianmar

Raportuesit Specialë janë ekspertë të pavarur, të emëruar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, me mandat të monitorojnë, këshillojnë dhe raportojnë publikisht për situatat e të drejtave të njeriut në vende specifike (mandate vendesh) dhe për shkeljet e të drejtave të njeriut në të gjithë botën (mandate tematike) (OHCHR, 2020). Raportuesit Specialë veprojnë në kuadër të procedurave speciale të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, ndërsa asistencën logjistike e sigurojnë nga Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Funksionet dhe aktivitetet e Raportuesit Special përfshijnë përgjigjen ndaj

ankesave individuale, kryerjen e hulumtimeve, ofrimin e këshillave për bashkëpunimin teknik, si dhe ndërmarrjen e vizitave në vende të caktuara për të vlerësuar situatat specifike të të drejtave të njeriut (Rodley, 2011). Ato gjithashtu marrin informacione mbi pretendimet specifike të shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe u dërgojnë thirrje urgjente ose letra ankimore qeverive në të cilat kërkojnë sqarime dhe masa konkrete për t'i dhënë fund këtyre shkeljeve (Subedi, Wheatley, & et.al, 2011).

Mjeti më i rëndësishëm i Raportuesit Special janë vizitat në vend, të cilat kryen me kërkesën e tyre dhe me ftesë të vendit në fjalë. Vizitat i mundësojnë Raportuesit Special të njihet me të gjitha aspektet e situatës në terren, dhe ato zgjasin rreth 2 deri në 3 javë, pas të cilave, ato paraqesin raport të vizitës së tyre para Këshillit për të Drejtat e Njeriut, duke paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tyre (ACLU, 2020).

Raportuesi i parë Special për Mianmarin u emërua nga Komisioni (tani Këshilli) për të Drejtat e Njeriut, me rezolutën 1992/58 më 3 mars të vitit 1992. Një ndër detyrat për të cilat u emërua Raportuesi Special ishte të shqyrtonte situatën e të drejtave të njeriut në Mianmar, si dhe të ndiqte përparimin e bërë drejt transferimit të pushtetit në një qeveri civile, hartimin e një kushtetute të re dhe rivendosjen e të drejtave të njeriut në Mianmar (Commission on Human Rights, 1992).

Në raportin e parë të Raportuesit Special për Mianmarin Yozo Yokota, në pjesën “situata e myslimanëve të shtetit Rakhine në Mianmar” shpjegohej për origjinën e myslimanëve (pa përdorur termin “rohingas”) në pjesën veriore të shtetit Rakhine, si dhe për problemin e shtetësisë së këtij grupi. Yakota raportoi për eksodin masiv të rreth 250 000 myslimanëve të Mianmarit drejt Bangladeshit, të cilët kishin kërkuar strehim nga frika e përndjekjes (Commission on Human Rights, 1993). Pra, siç mund të shihet, që nga viti 1992 Raportuesi Special për Mianmarin kishte raportuar për shkeljet e të drejtave të njeriut të rohingasve myslimanë, edhe pse askund në raport nuk përdorej termin “rohingas” por vetëm myslimanë të shtetit Rakhine.

Deri në vitin 2017, asnjë qeveri e huaj, e as Kombet e Bashkuara, nuk përdorën zyrtarisht termin “gjenocid” në lidhje me krimet ndaj rohingasve. Në prill të vitit 2014, ish Raportuesi i atëhershëm Special i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Tomas Ojea Quintana, në një konferencë tha se “ekzistojnë elemente të gjenocidit në Rakhine në lidhje me rohingasit” dhe se “duhet të diskutohet mundësia e gjenocidit” (Southwick, 2018, f. 125). Referencat zyrtare për gjenocidin në Mianmar fillojnë të shfaqen në vitin 2017, pasi vrasjet dhe zhvendosja masive arritën shkallën më të lartë në historinë e fundit të shtetit Rakhine. Presidenti Emanuel Macron ishte i pari që pohoi se sulmet kundër rohingasve përbënin gjenocid. Ndërsa Komisionari i Lartë për të Drejtat e Njeriut, Zeid Ra’ad al-Huseini, në një seancë të veçantë të Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut përsëriti akuzat kundër forcave të sigurisë në Mianmar, dhe pyeti “A mundet dikush të përjashtojë se elementet e gjenocidit mund të jenë të pranishme?” (Meixler, 2017).

Në vitin 2014, Raportuesja Speciale për Mianmarin Yanghee Lee shfrytëzoi rastin për të kundërshtuar përpjekjet nga qeveria e Mianmarit e cila i bënte presion që të mos e përdorte termin “rohingas” në raportet e tij. Në mars 2018, përpara se misioni fakt-gjetës të lëshonte raportin e tij, Lee tha para Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

Njeriut se ishte e bindur që krimet e kryera pas 9 tetorit 2016 dhe 25 gushtit 2017 mbanin shenjat e gjenocidit (Southwick, 2018, f. 134). Para largimit të saj nga kjo pozitë në prill të 2020, raportuesja Yanghee Lee kritikoi dhe deklaroi se ishte tërësisht e zhgënjyer nga Aung San Suu Kyi e cila nuk mundi të ruante reputacionin e një ikone të të drejtave të njeriut (Aljazeera, 2020). Ajo tha se ndërkohë që bota përballet me pandeminë e COVID-19, ushtria e Mianmarit vazhdon të përshkallëzojë sulmet në shtetin Rakhine, duke synuar popullsinë civile. Lee i bëri thirrje Kombeve të Bashkuara që të shtonin përpjekjet për të mbrojtur civilët në Rakhine dhe të siguronin se nuk do të ndodh më një dështim tjetër sistematik si ai në vitin 2017 (OHCHR, 2020).

6.1 Vetoja e Këshillit të Sigurimit, pengesë në realizimin doktrinë R2P

Anëtarët e Përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të njohur edhe si Pesëshja e Madhe (P5), përveç pozitës së përhershme në Këshillin e Sigurimit gëzojnë edhe pushtetin e përdorimit të vetos. Karta e OKB-së, në nenin 27, pika 3, përkufizon se për “vendimet e Këshillit të Sigurimit në lidhje me të gjitha çështjet e tjera (përveç atyre procedurale) duhet të miratohen nga 9 anëtarë, përfshirë edhe të gjithë anëtarët e përhershëm” (UN Charter, 1945). Kjo do të thotë se të gjitha vendimet thelbësore të Këshillit duhet të merren me “votat e njëkohshme të anëtarëve të përhershëm” (Parrat, 2019, fv. 91-92). Pra siç mund të shihet, Karta e OKB-së nuk përmend fuqinë e vetos, por pika e tretë e nenit 27 dikton që të gjitha çështjet thelbësore duhet të kalohen me nëntë vota dhe pëlqimin e pesë anëtarëve të përhershëm (Kina, Rusia, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA).

Sa i përket vetos, Anëtarët e Përhershëm e përdorin atë për të mbrojtur interesat e tyre kombëtare, për të mbështetur një parim të politikës së tyre të jashtme ose, në disa raste për të promovuar një çështje me rëndësi të veçantë për një shtet (Security Council Report, 2015). Fuqia e vetos nga pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit mund të përdoret edhe kundër miratimit të ndonjë rezolute ose projekt-rezolute, pavarësisht nivelit të përkrahjes ndërkombëtare për një projekt-rezolutë ose rezolutë, si dhe për bllokimin e zgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (Rukambe, 2017, f. 18).

Vetoja e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është kritikuar shpesh nga shumë shtete si elementi më jodemokratik i Kombeve të Bashkuara, sepse i jep pushtet të konsiderueshëm dhe privilegje vendeve të caktuara. Sipas kritikuesve, sigurimi i anëtarëve të përhershëm me pushtetin e vetos vendos një hierarki midis shteteve anëtare, që është në kundërshtim me parimet themelore të Kartës së OKB-së e cila nga ana tjetër pohon barazinë sovranë si një nga shtyllat themelore të OKB-së. Në prizmin tjetër, përkrahësit e pushtetit të vetos e konsiderojnë atë si instrument ndihmës në stabilitetin ndërkombëtar, si dhe si një kontroll kundër ndërhyrjeve (të njëanshme) ushtarake (Irbar, 2012). Ka pasur disa takime botërore ku është diskutuar për pushtetin e vetos dhe përdorimin e saj nga ana e pesë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, mirëpo asgjë e re nuk u amendua në këtë drejtim.

Ishte Samiti Botëror në vitin 2005 kur liderët botëror u mbledhën në Nju Jork për të diskutuar reformën e mundshme të OKB-së. Shumica e pikave për reforma u shtynë për një

kohë të mëvonshme, mirëpo përjashtim u bë vetëm për miratimin e “përgjegjësisë për të mbrojtur” të hartuar nga një komision i Kombeve të Bashkuara dhe i propozuar nga Kofi Anan. Siç kemi përmendur edhe më lartë “Përgjegjësia për të Mbrojtur” i jep bashkësisë ndërkombëtare të drejtën të ndërhyjë në rastet kur “në mënyrë të dukshme, autoritetet kombëtare nuk arrijnë ta mbrojnë popullatën e tyre nga gjenocidi, spastrimi etnik, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit”. Sipas dokumentit përfundimtar të dalë nga Samiti Botëror, miratuar formalisht në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 60/1 (2005), në paragrafin 139 thuhet se “Bashkësia ndërkombëtare është e përgatitur të ndërmarrë aksione të përbashkëta, në kohë dhe mënyrë vendimtare, nëpërmjet Këshillit të Sigurimit, në përputhje me Kartën, duke përfshirë edhe Kapitullin VII, në bazë rast pas rasti dhe në bashkëpunim me organizatat e rëndësishme rajonale, kur mjetet paqësore të mos mjaftojnë dhe kur autoritetet kombëtare në mënyrë të dukshme nuk i mbrojnë popullsitë e tyre nga gjenocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit (UN General Assembly, 2005).

Në bazë të doktrinės R2P, pesë anëtarët e Këshillit të Sigurimit (P5) duhet të bien dakord të mos përdorin fuqinë e vetos për të bllokuar veprime në përgjigje të gjenocidit dhe krimeve masive atëherë kur 1) shumica e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit janë pro ndërhyrjes; 2) në rast gjenocidi ose shkelje masive të të drejtave të njeriut; 3) një anëtar nuk ka interesa jetësore mbi çështjen në fjalë (ICISS, 2001, f. 51).

Nga kjo që u përmend më sipër, qartë shihet se pushteti i vetos që kanë në dispozicion pesë shtetet e përhershme të Këshillit të Sigurimit, është pengesë për realizimin e doktrinės R2P. Kjo do të thotë se për çdo ndërhyrje duhet pëlqimi unanim i P5.

Kombet e Bashkuara janë të pranishme në Mianmar që nga vitet 1950, dhe madje edhe gjatë ditëve më të errëta të diktaturës ushtarake, OKB-ja siguronte ndihma humanitare. Mianmari ka qenë në agjendat e Asamblesë së Përgjithshme që nga viti 1993 si dhe në agjendat e Komisionit për të Drejtat e Njeriut (tani Këshilli) që nga viti 1992 (Rosenthal, 2019, f. 9). Mianmari përmendej në raporte të shumta periodike nga Raportuesit Special për situatën e të drejtave të njeriut, dhe deri në vitin 2016, përmendej edhe në raportet vjetore nga Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e rezolutave të miratuara (Magnusson & Pedersen, 2012).

Të vetmet dy momente kur OKB-ja ka pasur prani të shtuar të saj në Mianmar, kanë qenë në vitin 2008 pas katastrofës së shkaktoar nga cikloni “Nargis”, si dhe pas vitit 2010 kur nisi procesi i demokratizimit të shtetit të Mianmarit (Rosenthal, 2019, f. 10).

Pas ngjarjeve të gushtit në vitin 2017, Asambleja e Përgjithshme mori përsipër situatën e të drejtave të njeriut në Mianmar dhe miratoi një rezolutë jashtëzakonisht të ashpër, përmes të cilës u kërkua emërimi i një të dërguari të ri special për t’i ofruar ndihmë qeverisë si dhe për të trajtuar shqetësimet e përfshira në rezolutë (UN General Assembly, 2017). Sa i përket angazhimit të Këshillit të Sigurimit gjatë gjithë kësaj periudhe, ai ka qenë i kufizuar, për dallim nga angazhimi shumë i fortë Zyrës së Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, dhe Këshillit për të Drejtat e Njeriut.

Mbretëria e Bashkuar mori hapin e parë në promovimin e përfshirjes së Këshillit të Sigurimit në Mianmar, ndërsa Kina argumentonte vazhdimisht se situata në Mianmar nuk e

kërcënonte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, dhe se duhet të trajtohet si çështje e brendshme e shtetit. Kur SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar u përpoqën në vitin 2007 të vendosin në tryezë një rezolutë për situatën në Mianmar, Kina dhe Rusia vendosën të dyja veton (UN Security Council, 2012). Edhe Sekretari i Përgjithshëm Guterres në letrën e tij drejtuar Këshillit të Sigurimit në 2 shtator 2017 kërkoi përpjekje të përbashkëta për të parandaluar përshkallëzimin e krizës në pjesën veriore të shtetit Rakhine, mirëpo Këshilli nuk u përgjigj në kohën e duhur. U deshën dy javë që të caktohej mbledhje zyrtare për të analizuar dhe trajtuar çështjen si dhe 38 ditë të tjera për të dalë me një deklaratë të presidentit të Këshillit të Sigurimit lidhur me krizën e rohingasve në Mianmar (Rosenthal, 2019, f. 18).

Në vitin 2019 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Antonio Guterres emëroi Gert Rosenthal për të hulumtuar përfshirjen e Kombeve të Bashkuara në Mianmar nga viti 2010 deri në vitin 2018. Në një raport lidhur me këtë, Rosenthal tha se përgjegjësia është e përbashkët dhe se mund të karakterizohet si një dështim sistematik i Kombeve të Bashkuara. Ai shkruante më tej në raport se sistemi i Kombeve të Bashkuara ka qenë relativisht i pafuqishëm për të punuar në mënyrë efikase me autoritetet e Mianmarit për të frenuar tendencat negative në fushën e të drejtave të njeriut dhe për të konsoliduar tendencat pozitive në fusha të tjera (Nichols, 2019). Sipas tij, anëtarësia kolektive e Kombeve të Bashkuara, e përfaqësuar nga Këshilli i Sigurimit, duhet të mbajë një pjesë të përgjegjësisë për dështimin sistematik në Mianmar. Sipas raportit të lartpërmendur, qasja e Kombeve të Bashkuara ndaj qeverisë së Mianmarit ka qenë pa efekt në gjetjen e një strategjie të qëndrueshme, qoftë presion apo diplomaci të qetë, apo kombinim i të dyjave. Në terren ka pasur konfuzion, pasi zyrtat lokale të OKB-së në Mianmar kanë pasur mungesë udhëzimesh dhe drejtime jo të qarta, jo vetëm si të menaxhonin situatën por edhe t'i bënin ballë fushatës së presionit nga shteti i Mianmarit. Bllokimet në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku Kina dhe Rusia "*mbështesnin*" qeverinë e Mianmarit duke luajtur një rol të madh në minimizimin e çështjeve të të drejtave të njeriut, shtuan dozën e dështimeve dhe mos-reagimit për t'u përgjigjur ndërkombëtarisht (Kurlantzick, 2019).

Megjithatë, paraliza e Këshillit të Sigurimit nuk duhet të jetë fundi i historisë së përgjegjësisë në Mianmar. Këshilli i Sigurimit ka përgjegjësinë kryesore për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, por pa përgjegjësi nuk mund të mbetet as Asambleja e Përgjithshme. Karta e OKB-së e ka veshur Asamblenë të Përgjithshme me pushtetin për të dhënë rekomandime në çdo çështje brenda fushëveprimit të saj. Duke ushtruar këtë pushtet, Asambleja e Përgjithshme mund të rekomandojë embargo armësh (Carroll, 2019), të mandatojë forca paqeruajtëse, t'u kërkojë shteteve që të ndërpresin marrëdhëniet diplomatike me shtete që shkelin të drejtën ndërkombëtare etj. (Barber, 2019).

6.2 Dështimi i ndërkombëtareve në përmbushjen e vlerave të OKB-së

Përmbushja e qëllimit dhe misionëve të OKB-së në ruajtjen e paqes ndërkombëtare, ende lë dritëhije dhe dyshime për kapacitetin real të saj në këtë drejtim. Pavarësisht se shumë autorë dhe studiues theksojnë se OKB-ja dhe formula e Këshillit të Sigurimit, me 5

anëtare të përhershme, duhet të garantojë një vendimmarrje të drejtë, një reagim të shpejt në kohë dhe efikas për shtetet që shkelin të drejtën ndërkombëtare (veçanërisht lidhur me gjenocidin), ende në realitet kjo nuk ofron pritshmëritë e saj.

Joshua Goldstein thekson se në themel të autorizimeve të Këshillit të Sigurimit është pikërisht ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare, si dhe rikthimi i paqes atje ku ajo është prishur. Vendimet e Këshillit janë të detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së që kanë dhënë pëlqimin e anëtarësimit në këtë organizatë (Goldstein, 2001, f. 293).

Kalvari i gjatë i përpjekjeve të OKB-së (konkretisht i Këshillit të Sigurimit), lidhur me trajtimin e çështjes së Mianmarit, dhe realiteti me gjendjen ende sot e kësaj dite, ka qenë jo i frytshëm. Pakica rohingase ende mbetet e diskriminuar, shënjestër e akteve të mizorisë, dhe ende komuniteti ndërkombëtar është duarlidhur për shkak të mekanizmit të votimit në Këshillin e Sigurimit, veçanërisht nga vetoja e përdorur nga shtete të caktuara të përhershme (Kina e Rusia), që sikurse u theksua më sipër, kufizohen ta japin pëlqimin si një prerogativë se ai bie ndesh me interesat e politikës së tyre të jashtme (Security Council Report, 2015), me mendimin se çdo ndërhyrje me misionë ndërkombëtare përbën ndërhyrje në marrëdhëniet e brendshme të shtetit, dhe se mund të gjenden mekanizma të tjerë për zgjidhjen e çështjes diskriminuese me rohingasit.

Në këtë drejtim, nuk mund të lihen pa përmendur interesat gjeopolitike dhe ekonomike, ku Kina është eksportuesja kryesore e mallrave drejt Mianmarit, ndërkohë që 80% e gazit dhe naftës që importohet në Kinë kalon nëpërmjet Mianmarit dhe ngushticës Malaka në gjirin e Bengalit (konkretisht ku gjendet edhe shteti Rakhine). Nga ana tjetër, Rusia është gjithashtu një nga shtetet më të interesuara lidhur me energjinë, gazin si dhe në sferën e energjisë bërthamore, atë ushtarake për armatime etj.

SHBA-ja duket se të vetmin interes të saj ka dobësimin e influencës kineze në këtë shtet. Pavarësisht se SHBA-ja pati ndërhyrë fuqishëm nën ndikimin e grupeve lobuese për përmbysjen e juntës ushtarake dhe demokratizimin e shtetit, ky qëllim do të merrte të paktën 2 dekada kohë për t'u përmbushur. SHBA-ja nuk ka pasur qasje shumë të madhe në Mianmar, pavarësisht se do të parapëlqente prej kohësh një ndërhyrje humanitare, por sigurisht, jo pa i bërë mirë llogaritë nga kundërpërgjigjja e mundshme ushtarake e Mianmarit (Steinberg, Burma/Myanmar what everyone needs to know, 2010, f. 126). Rritja e bashkëpunimit ose e pranisë amerikane do të ishte e rëndësishme për të siguruar interesat amerikane në të gjithë Paqësorin Aziatik (Kuok, 2014, f. 21). Megjithatë, interesi parësor i SHBA-së dhe gjithë perëndimit ka qenë një qeveri demokratike, pasi demokracia do të ndikonte pozitivisht në paqen dhe stabilitetin, jo vetëm të Mianmarit por të gjithë Azisë Jugore dhe gjithë rajonit të Paqësorit Aziatik.

Bazuar në frymën e re të së drejtës ndërkombëtare, doktrinës "Përgjegjësia për të mbrojtur", dobësimin të teorisë së vjetruar të sovranitetit shtetëror uestfalian, shtetet e përhershme të Këshillit të Sigurimit, të vetmet që gëzojnë pushtetin dhe vendimmarrjen për ndërhyrje humanitare, duhet të kuptojnë qartë rolin e vërtet të vlerave të reja, si dhe të bëjnë dallim me interesat e tyre kombëtare dhe përplasjet për interesa ekonomike me fuqitë e tjera botërore, në kurriz të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe lumturive të tij të garantuara me kushtetutë.

Gjithnjë e më shumë, shtetet diktatoriale dhe politikat e tyre domuniese po marrin fund dhe rendi i ri botëror shkon drejt liberalizimit dhe promovimit të vlerave universale të njeriut.

7. PËRFUNDIMI

Krimet kundër rohingasve myslimanë në Mianmar përmbushin formulën e 4 krimeve sipas Konventës për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Gjenocidit. OKB-ja dhe Këshilli i Sigurimit dështuan në misionin e tyre për mbrojtjen e popullatës rohingase, për t'iu përgjigjur në mënyrë vendimtare dhe të menjëhershme krimeve që kryente komuniteti shumicë budist dhe forcat e armatosura të Mianmarit.

Doktrina “Përgjegjësia për të mbrojtur” mund të quhet e dështuar për këtë shekull të ri, pavarësisht se gjatë fundshekullit XX kishte nxjerrë mësim nga dështimi i komunitetit ndërkombëtar në Ruandë, si dhe nga veprimi i vonuar në Ish Jugosllavi për të parandaluar gjenocidin në Bosnjë. Doktrina “Përgjegjësia për të mbrojtur”, pavarësisht se lindi si pasojë e këtyre dështimeve, prapëseprapë, në rastin e Mianmarit, shënoi një kthim prapa duke ngritur pikëpyetje edhe njëherë për të ashtuquajturën qeveri botërore.

Këshilli i Sigurimit si organ kompetent për autorizimin e ndërhyrjeve humanitare nën përgjegjësinë për të vepruar në kuadër të doktrinës R2P, mbeti i paralizuar dhe peng i interesave ekonomike dhe gjeostrategjike të dy vendeve anëtare të përhershme, Kinës dhe Rusisë. Ato vendosën veto në vitin 2007 ndaj një rezolute të Këshillit të Sigurimit për situatën e të drejtave të njeriut në Mianmar, ndërsa në vitin 2017, një projekt rezolute e cila duhej të vendoste sanksione Mianmarit u shndërrua në deklaratë presidenciale të Këshillit të Sigurisë me fuqi vetëm rekomandimi.

Ky punim argumentoi gjithashtu se rohingasit, një grup etnik me besim mysliman që jeton në shtetin Rakhine të Mianmarit perëndimor, me dekada të tëra ka qenë shënjestër e abuzimeve të rënda të kryera nga ushtria e Mianmarit. Kjo etni, jo vetëm që nuk njihet si entitet i këtij shteti, (pa shtetësi dhe pa të drejta të tjera bazë), por është nën represion të vazhdueshëm për përzënie në Bangladesh – nën justifikimin se prejardhja e tyre është bengale.

Shënjestër e ushtrisë së Mianmarit nuk janë vetëm rohingasit, por edhe pakica të tjera, të cilat janë nën shtypje të vazhdueshme dhe nën paragjykim nga komuniteti shumicë. Edhe tranzicioni politik që synonte liberalizimin e pushtetit të Mianmarit, i dominuar nga ushtria, nuk ndryshoi thuajse asgjë kundrejt dhunës ndaj komuniteteve të tjera. Ardhja në pushtet e Aung San Suu Kyi si sekretare (kryeministre), pas vitesh të gjata përndjekjeje politike, nuk ndërroi mentalitetin dhe represionin ushtarak, pavarësisht se ajo

ishite fituese e çmimit Nobel për angazhimin e saj për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në Mianmar.

Vala e parë e dhunës u shënua në vitin 2012 midis budistëve nacionalistë dhe rohingasve myslimanë, dhunë që ndodhte para syve të forcave të sigurisë. Ushtria nuk ndërmernte asnjë veprim për ta ndaluar dhunën, por vetëm e legalizoi atë duke i dhënë shtysë për një valë akoma më dramatike në vitin 2017. Një sulm i Ushtrisë së Shpëtimit të Rohingasve nga Arakani (formacion rebelues i rohingasve) kundër forcave të sigurisë gjatë atij viti, shërbeu si pretekst për fillimin e një operacioni spastrimi jo vetëm kundër kryengritësve, por ndaj të gjithë rohingasve në Rakhine duke shkaktuar vrasje, përdhunime, djegie dhe masakra të cilat bota nuk i kishte parë ndonjëherë. Për autoritetet e Mianmarit operacioni ishte kundërpërgjigje kundër terrorizmit, ndërsa ajo që rezultoi, ishte dëbimi i rohingasve me metoda më marramendëse, duke shkaktuar një krizë të madhe humanitare.

Këto fakte, të notuara nga shumë raporte të organizatave që merren me të drejtat e njeriut, dhe të dëshmuara me pamje dhe dëshmi të shumta, vetëm zbuluan realitetin e situatës me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut që kryen qeveria e Mianmarit.

Në një kohë që perëndimi dërgon apele për mbrojtje të të drejtave të njeriut, Kina dhe Rusia, e mbyllin njërin sy dhe njërin vesh, me justifikimin se ndërhyrja humanitare do të ishte një përzierje në punët e brendshme të shtetit të Mianmarit. Për ironi të fatit, edhe Aung San Suu Kyi, ikona e të drejtave të njeriut, sot mbron shtetin e Mianmarit, si palë e paditur nga Gambia, para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Procesi ndërkombëtar gjyqësor filloi në fund të vitit 2019, por Aung San Suu Kyi çuditi botën me qëndrimin e saj, duke hedhur poshtë pretendimet se ushtria e Mianmarit (e cila e kishte mbajtur atë në arrest shtëpiak për 15 vjet me radhë) ka kryer gjenocid ndaj pakicës rohingase në vendin e saj.

Por, vendimi i kësaj gjykate ndërkombëtare, e cila merr vendime në rast kontestesh dhe mosmarrëveshesh mes shtetesh, përsëri nuk mund të bëjë shumë në vendosjen e drejtësisë për rohingasit. Edhe sikur Gambia ta fitojë procesin, vendimi dërgohet sërish në Këshillin e Sigurimit, ku mund të bllokohet, sikurse edhe në dy përpjekjet e dështuara për rezoluta.

Me vendosjen e interesave të tyre, shtetet i dhanë një grusht të fortë sovranitetit të njeriut. Sot, gati 2 milion roingas vazhdojnë të mbeten pre e dhunës sistematike dhe deportimit, ndërsa në pikëpyetje mbetet edhe fati i gati 850 mijë roingas të cilët prej vitesh jetojnë në kampe refugjatësh në Bangladesh, pas deportimit të tyre.

Parë më hollësisht në këtë punim, në kapitullin e parë hodhëm dritë mbi pozitën gjeopolitike të Mianmarit, pozicioni gjeografik i të cilit e bën atë mjaft të rëndësishëm në Gjirin e Bengalit (një nga rrugët detare më të mëdha të tregtisë në botë). Faktet tregojnë se 80% e naftës dhe gazit që importohet në Kinë kalon nëpërmjet ngushticës Malaka në Gjirin e Bengalit, pikërisht nëpërmjet shtetit Rakhine ku jetojnë rohingasit. Në këtë kapitull u njohëm edhe me pakicat e tjera etnike që përbëjnë rreth 32% të popullsisë në Mianmar. Sa i përket ekonomisë dhe politikës, pamë se sa i fuqishëm është ndikimi i ushtrisë (e cila kishte vendosur kthetrat e saj gjatë juntës 50 vjeçare, nga 1962 deri në 2011). Thuajse e gjithë ekonomia e vendit është në duart e dy korporatave të kontrolluara nga ushtria e Mianmarit; Korporata Ekonomike Pronësore (MEHC) dhe Korporata Ekonomike e Mianmarit (MEC). Sa i përket sistemit politik, siç u analizua edhe kushtetuta e vitit 2008,

vendi duhej të demokratizohej dhe të mundësonte transferim të pushtetit (nga junta ushtarake) në një qeveri civile. Mirëpo, në realitet, ndodhi legalizimi i autorizimeve të fuqishme të ushtrisë së Mianmarit. Në bazë të kushtetutës ushtria gëzon ende të drejtën të emërojë deputetë në të dyja dhomat e parlamentit, duke i pamundësuar ndryshimet rrënjësore të kushtetutës. Ushtria emëron gjithashtu edhe ministrin e punëve të brendshme, atë të mbrojtjes dhe atë të kufirit, tre pozita thelbësore për qeverisjen e vendit dhe ushtrimin e pushtetit, duke mbetur kështu, autoriteti më i lartë vendimmarrës në Mianmar.

Në kapitullin e dytë, në mënyrë të detajuar shpalosëm faktet kronologjike të valëve të dhunës të vitit 2012 dhe 2017... si është ushtruar ajo nga ushtria e Mianmarit, e përkrahur nga nacionalistët budistë... taktikat e dhunës dhe fryma e paragjyqimeve se rohingasit dhe feja myslimane shihet si kërcënim për budizmin dhe ekzistencën e shtetit të Mianmarit. Gjithashtu analizuam aktet e numëruara sipas Konventës së Gjenocidit, me anë të të cilave vërtetua se aktet e dhunës në Mianmar i përmbushin të gjitha elementet e krimit të gjenocidit. Analizuam edhe reagimet e komunitetit ndërkombëtar i cili pothuajse nuk ndërmori asnjë veprim për ta zgjidhur krizën.

Në kapitullin e tretë hidhet dritë mbi doktrinën “Përgjegjësia për të mbrojtur”. Kjo doktrinë e themeluar në vitin 2005 kishte synim t’i jepte domethënie më të madhe individit, dhe të zbuste sovranitetin shtetëror të ngulitur që nga Uesfalia (1648). Shtyllat e doktrinës R2P kanë të bëjnë me përgjegjësinë e çdo shteti për të mbrojtur popullsitë e veta, qofshin shtetas ose jo, ndaj 4 krimeve, ato kundër njerëzimit, krimeve të luftës, gjenocidit dhe pastrimit etnik. Shtylla e dytë është ajo e angazhimit të bashkësisë ndërkombëtare për të ndihmuar shtetet në përmbushjen e detyrimeve të dala nga shtylla e parë. Po ashtu, në këtë kapitull hidhet dritë edhe mbi mësimet e nxjerra nga e kaluara, gjenocidet e mëhershme për të cilat komuniteti ndërkombëtar dështoi të reagojë. Në analizë u morën gjenocidi në Ruandë dhe Bosnja, lufta në Kosovë si dhe ndërhyrja humanitare në Libi.

Ndërsa në kapitullin e katërt hidhet dritë mbi kalvarin e përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për t’i gjetur zgjidhje krizës në Mianmar. Numëruam tentativat për rezoluta në Këshillin e Sigurimit, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, qëndrimet e palëve në këtë debat, rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe raportet e Raportuesve Specialë për situatën e të drejtave të Njeriut në Mianmar. Në këtë kapitull vërtetua dështimin e trajtimit të duhur të çështjes nga Këshilli i Sigurimit, dhe mbetjen e saj vetëm në dorë të organeve për të drejtat e njeriut, pa mundur të ngjitej më lart në Këshillin e Sigurimit, duke shuar përfundimisht edhe shansin për ndërhyrje humanitare ndaj popullatës viktimë.

Duke marrë parasysh këto gjetje, dhe duke i gërshetuar ato, mund të theksohet se u vërtetua edhe teza e ngritur në fillim të këtij punimi;

- Mianmari shkel të drejtat e njeriut me krimet ndaj minoritetit rohingas!

Masakrat e tmerrshme çnjerëzore ndaj rohingasve të kryera nga ushtria e Mianmarit, të shoqëruara me veprimet e dhunshme të budistëve nacionalistë si dhe me diskriminimin sistematik të qeverisë së Mianmarit, sidomos me ligjet që i bënë rohingasit si “të huaj” në vendin ku ata jetojnë prej shekujsh, vërtetojnë pikërisht faktin se Mianmari shkel të drejtat e njeriut. Përndjekja e rohingasve daton shumë më herët, por legalizimi i përndjekjes erdhi me një ligj diskriminues në vitin 1982, që u mohonte atyre të drejtën e shtetësisë, dhe i detyronte ata çdo ditë e më shumë të regjistroheshin si bengalë – të ardhur

nga Bangladeshi. Nga ana tjetër, gjuha e urrejtjes, kryesisht e ushtruar nga murgjit budistë, që e shohin besimin mysliman si kërcënim, e nxiste më tej dhunën në shtetin Rakhine. Organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç ishin “Human Rights Watch” dhe “Amnesty International” publikuan raporte dhe analiza lidhur me shkeljet e rënda të rohingasve në Mianmar. Edhe misioni fakt-gjetës i mandatuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut në raportin e tij përfundimtar fakttoi se në Mianmar, të drejtat e njeriut shkelen.

Në këtë punim vërtetohen edhe hipotezat dytësore.

- Krimet ndaj rohingasve përbushin 4 krimet kundër lirive dhe të drejtave të njeriut sipas Konventës për Gjenocid (gjenocid, krime kundër njerëzimit, spastrim etnik dhe krime të luftës).

Sipas të drejtës ndërkombëtare, gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe spastrimi etnik përbëjnë krime të rënda, të cilat duhet të ndëshkohen ndërkombëtarisht. Këto krime u përkuftizuan në Konventën e Gjenocidit (1948), në Konventat e Gjenevës (1949/1977) dhe në Statutin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare (1998). Siç kemi përmendur edhe gjatë punimit, krimet kundër rohingasve i përbushin të gjitha aktet e numëruara sipas konventës së gjenocidit. Historia e rohingasve dëshmon se ata përbëjnë një grup etnik kombëtar, etnik, racor dhe fetar. Përfshirja e ushtrisë në masakrat ndaj rohingasve, si dhe mosveprimi i tyre për të frenuar dhe ndëshkuar dhunën e budistëve nacionalistë, përbën gjithashtu shkelje të konventës, brenda kategorisë së aktit të numëruar, *të vrasjes së anëtarëve të grupit*. Torturimet, përdhunimet dhe dhuna seksuale përbushin aktin tjetër *të lëndimit të rëndë fizik dhe mendor të anëtarëve të grupit*. Dëbimi i rohingasve nga shtëpitë e tyre nëpër kampe të zhvendosura brenda dhe jashtë Mianmarit dhe mohimi i kujdesit mjekësor, ushqimit, mjeteve themelore higjienike etj., përbëjnë kushte të tilla jetese që synojnë *t'i shkatërrojnë rohingasit si grup*. Qëllimi gjenocidal si dhe shkalla e krimeve të kryera vërtetojnë gjithashtu se krimi i gjenocidit është përbushur dhe se autorët e tij duhen nxjerrë para organeve të drejtësisë.

- Këshilli i sigurimit i OKB-së ka dështuar përballë krimeve dhe nuk arriti të miratonte asnjë rezolutë me efekt konkret

Në këtë studim u vërtetua se Këshilli i Sigurimit nuk arriti të miratonte asnjë rezolutë me të cilën do të trajtonte çështjen ose do ta sanksiononte qeverinë e Mianmarit për krimet e rënda kundër rohigasve myslimanë. Siç theksuam edhe gjatë studimit tonë, dy tentativat për ta zgjidhur krizën në Mianmar dështuan; në vitin 2007 me vendosjen e vetos nga Kina dhe Rusia, si dhe në vitin 2017 kur përpjekja përmes një projekt-rezolute mbeti në suazat e një deklarate presidenciale të Presidentit të Këshillit të Sigurimit pasi Kina dhe Rusia bënë të ditur se nuk do lejonin që rezoluta të kalonte në votim.

- “Përgjegjësia për të mbrojtur” dhe sovraniteti i njeriut, ende në pikëpyetje në rastin me rohingasit

Doktrina “Përgjegjësia për të mbrojtur” lindi si kundërpërgjigje e dështimeve të komunitetit ndërkombëtar në të kaluarën, për të trajtuar 4 shqetësimet e mëdha; atë të parandalimit të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe spastrimit etnik. Doktrina në fjalë kishte për qëllim të vendosë një normë të re në funksionimin e të drejtës ndërkombëtare, e sidomos të ndërhyrjeve humanitare, gjithmonë kur *një shtet dështon që të mbrojë popullsinë e vet nga krimet*. Por, mostrajtimi i çështjes në nivel më të lartë, ose mos gjetja e një pajtimi për këtë, bënë që edhe vetë misioni i doktrinës të tradhtohet.

- Vetoja e Kinës dhe Rusisë, bllokadë për ndërhyrje të komunitetit ndërkombëtar

Ky punim vërtetoi gjithashtu se vetoja e Kinës dhe Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së shërbeu si bllokadë për ndërhyrje të komunitetit ndërkombëtar. Ky veprim i dy shteteve të përhershme anëtare minoi edhe vetë mekanizmin e votimit të të gjithë shteteve anëtare, si dhe zbatimin e doktrinës “Përgjegjësia për të mbrojtur”. Për Kinën, respektimi i të drejtave të njeriut është çështje e brendshme e një shteti sovran dhe situata në Mianmar nuk përbënte kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ndërsa për Rusinë, situata në Mianmar nuk kishte nevojë të trajtohej në Këshillin e Sigurimit, por mjaftonte në organet e tjera të OKB-së, si Këshilli i të Drejtave të Njeriut dhe Asambleja e Përgjithshme.

- Interesat ndërkombëtare, pengesë edhe për ndërhyrje të njëanshme

Sikurse u tregua edhe gjatë punimit, një nga mëdyshjet e ngritura është edhe ajo e përplasjeve të vetë fuqive më të mëdha të botës. Lufta që bëhet tashmë për 3E-të, energji, ekonomi dhe ekologji, ka vendosur në një garë të pabarabartë shtetet e mëdha. Kina synon të zgjerojë tregjet e saj, ndërkohë që SHBA-ja është në një luftë të re kundër këtij ekspansioni ekonomik. Edhe ndërhyrjet e deritanishme kanë dalluar nga njëra-tjetra. Aty ku kanë interes, shtetet marrin vendime njëzëri, ndërsa aty ku nuk kanë, vendimarrja e tyre është e ngadaltë, ose heshtin.

Nga ky studim, dalin të natyrshme edhe një sërë rekomandimesh, të cilat i kemi ndarë në dy rrafshë; si më poshtë

Për Komunitetin ndërkombëtar

Referim urgjent i situatës së Mianmarit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, ose krijimi i një gjykate ad-hoc e cila do të dënonte krimet e rënda që u kryen në Mianmar, bazuar në të drejtën ndërkombëtare. Nëse Këshilli i Sigurimit nuk është i gatshëm ta referojë çështjen te Gjykata Penale Ndërkombëtare, atëherë Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë në konsideratë përdorimin e kompetencave të saj në bazë të Kartës së OKB-së.

Vendosja e sanksioneve kundër të gjithë atyre personave që janë përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut në shtetin Rakhine, si dhe vendosja e një embargoje globale të armëve për ushtrinë e Mianmarit.

Rritja e presionit diplomatik mbi Mianmarin. Të gjitha marrëdhëniet diplomatike pozitive në të ardhmen duhen të kushtëzohen me heqjen e politikave dhe praktikave diskriminuese kundër rohingasve. Diplomatat dhe zyrtarët e Kombeve të Bashkuara duhet

të përdorin termin “rohingas”, si në marrëdhëniet ndërshtetërore ashtu edhe në ato ndërkombëtare, si një formë jo vetëm e njohjes së rohingasve, e dënimit të ligjit për mohimin e shtetësisë së tyre (1982) por edhe minimizimi i diskriminimit të vazhdueshëm të qeverisë për t'i portretizuar rohingasit si emigrant të paligjshëm.

Për qeverinë e Mianmarit

T'i jap fund akteve të dhunës dhe ta trajtojë popullatën rohingase si pjesë të shoqërisë së tyre.

Të anulojë ligjin diskriminues dhe ta njohë popullatën rohingase, duke nisur një fushatë për të drejta të barabarta të kësaj etnie, sikurse asaj shumicë.

Të sigurojnë kthimin e sigurt, dinjitoz dhe vullnetar të të gjithë rohingasve të cilët janë të zhvendosur nëpër rajone të tjera ose në kampe refugjatesh në Bangladesh, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Të ratifikojë Statutin e Romës dhe të bëhet palë e tij, duke iu nënshtruar plotësisht fushëveprimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, si dhe Konventave Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Civile (përfshi edhe instrumentet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut).

Të reformojë sistemin politik duke bërë ndryshime strukturore brenda entitetit të Ushtrisë, të rishikojë me ndryshime ligjore forcën dhe pushtetin e saj në këtë shtet, si dhe të distancojë elementet e juntës nga pushteti që duhet të burojë nga populli sovran.

Të parandalojë dhe sanksionojë çdo retorikë çnjerëzore dhe diskriminuese ndaj pakicës rohingase dhe të ofrojë një strategji për pajtim midis burmanëve budistë dhe pakicave të tjera në Mianmar.

Në përmbyllje, ky punim vë theksin edhe njëherë te individi, si palë e marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe se jeta e tij vlen mbi të gjitha përpjekjet e një shteti, sado autoritar që ai të jetë, për të fshehur krimet ndaj njerëzimit.

8. BIBLIOGRAFIA

- Abomo, P. T. (2019). *R2P and the US Intervention in Libya*. Nairobi: Palgrave Macmillan.
- ACLU. (2020). *FAQS: UNITED NATIONS SPECIAL RAPPORTEURS*. Gjetur në <https://www.aclu.org/other/faqs-united-nations-special-rapporteurs>
- Adams, S. (2019, Janar). *"If Not Now, When?": The Responsibility to Protect, the Fate of the and the Future of Human Rights*. Gjetur në Global Centre for the Responsibility to Protect: https://www.globalr2p.org/wp-content/uploads/2019/01/adamsrohingya_opaper_final.pdf
- Advisory Commision on Rakhine State. (2017). *Towards a Peacefull Fair and Prosprerous Future For The People Of Rakhine*.
- Aibing, G. (2011). China Power Investment Says Myanmar Dam Suspension 'Bewildering'. Gjetur në <https://www.bloomberg.com/news/articles/2011-10-04/china-power-investment-says-myanmar-hydropower-dam-suspension-bewildering>
- Al Jazeera. (2015, Maj 17). *Myanmar rejects blame for Rohingya migrant crisis*. Gjetur në <https://www.aljazeera.com/news/2015/05/myanmar-deflects-blame-rohingya-migrant-crisis-150516223643074.html>
- Al Jazeera. (2017, Gusht 30). *UK calls for UN meeting on Myanmar violence*. Gjetur në Al Jazeera: <https://www.aljazeera.com/news/2017/08/uk-calls-meeting-myanmar-violence-170829210354423.html>
- Aljazeera. (2016, Dhjetor 16). *Rohingya abuse may be crimes against humanity: Amnesty*. Gjetur në <https://www.aljazeera.com/news/2016/12/rohingya-crimes-humanity-amnesty-161219045655733.html>
- Aljazeera. (2020, Prill 29). *Outgoing UN envoy to Myanmar 'utterly disappointed' with Suu Kyi*. Gjetur në <https://www.aljazeera.com/news/2020/04/outgoing-envoy-myanmar-utterly-disappointed-suu-kyi-200429144700254.html>
- Amnesty International. (2016). *MYANMAR: SECURITY FORCES TARGET ROHINGYA DURING VICIOUS RAKHINE SCORCHED-EARTH CAMPAIGN*. Amnesty International. Gjetur në <https://www.amnesty.org/en/press-releases/2016/12/myanmar-security-forces-target-rohingya-viscious-scorched-earth-campaign/>
- Amnesty International. (2017). *"Caged Without A Roof" - Apartheid In Myanmar's Rakhine State*. Gjetur në <https://www.amnesty.org/download/Documents/ASA1674842017ENGLISH.PDF>
- Amnesty International. (2020). *HUMAN RIGHTS IN ASIA: REVIEW OF 2019. MYANMAR*. Gjetur në <https://www.amnesty.org/download/Documents/ASA1617742020ENGLISH.PDF>
- APHR. (2018). *The Rohingya Crisis: Past, Present, and Future*. ASEAN Parliamentarians for Human Rights. Gjetur në https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/APHR_Bangladesh-Fact-Finding-Mission-Report_Mar-2018.pdf

asfasf, a. (2020). *asfasfasf*.

Assembly, U. G. (2017, Tetor 31). *Situation of human rights in Myanmar*. Gjetur në A/C.3/72/L.48:
http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/a_c_3_72_l_48.pdf

Aziri, E. (2012). *Sistemet Politike*. Tetovë: Universiteti i Evropës Juglindore.

Bagnall, S. (2010). *Burma's 'forgotten' Chin people suffer abuse*. (BBC, Redaktori) Gjetur në
<http://news.bbc.co.uk/2/hi/asia-pacific/8626008.stm>

Barber, R. (2019, Mars 19). *Violence in Myanmar: look elsewhere than Security Council*. Gjetur në The Interpreter : <https://www.lowyinstitute.org/the-interpreter/violence-myanmar-look-elsewhere-security-council>

Bari, M. A. (2018). *The Rohingya Crisis: A People Facing Extinction*. Leicestershire : Kube Publishing Ltd .

BBC. (2011, Maj 17). *Rwanda: How the genocide happened*. Gjetur në BBC News:
<https://www.bbc.com/news/world-africa-13431486>

BBC NEWS. (2012). Q&A: Unrest in Burma's Rakhine state. *BBC NEWS ASIA*. Gjetur në
<https://web.archive.org/web/20120614210200/http://www.bbc.co.uk/news/world-asia-18395788>

BBC News. (2013, Dhjetor 16). *Arab uprising: Country by country - Libya*. Gjetur në
<https://www.bbc.com/news/world-12482311>

BBC NEWS. (2013). *Burma communal rioting spreads outside Meiktila*. Gjetur në
<https://www.bbc.com/news/world-asia-21921080>

BBC NEWS. (2013, Prill 22). *Burma riots: Video shows police failing to stop attack*. Gjetur në YouTube:
<https://www.bbc.com/news/world-asia-22243676>

BBC NEWS. (2014, Shtator 26). *Why is there tension between China and the Uighurs?* Gjetur në
<https://www.bbc.com/news/world-asia-china-26414014>

BBC NEWS. (2015, Maj 29). *Myanmar picks up migrants as Asean agrees to tackle crisis*. Gjetur në
<https://www.bbc.com/news/world-asia-32925815>

BBC NEWS. (2017, Shtator 19). *UK suspends aid for Myanmar military*. Gjetur në BBC NEWS:
<https://www.bbc.com/news/uk-41326179>

Be In Kosovo. (2020). *Countries That Have Recognized Kosovo as an Independent State*. Gjetur në BeInKosovo.com: <http://www.beinkosovo.com/countries-that-have-recognized-kosovo-as-an-independent-state/>

Beech, H. (2017, Nëntor 23). *Deal on Rohingya Repatriation Inches Forward, but Hurdles Remain*. Gjetur në The New York Times : https://www.nytimes.com/2017/11/23/world/asia/deal-on-rohingyas-myanmar-bangladesh.html?_r=0

- Bekaj, A. R. (2010). *The KLA and the Kosovo War: From Intra-State Conflict to Independent Country*. *Berghof Conflict Research*.
- Bella, L. L. (2015). *Aung San Suu Kyi: Myanmar's Freedom Fighter*. New York: The Rosen Publishing Group.
- Bensaoud, M. (2015). *Between R2P and the ASEAN Way: The case of Myanmar's Cyclone Nargis*. Brunei: Institute of Asian Studies.
- Bequelin, N. (2017, Dhjetor 5). *Behind China's Attempt to Ease the Rohingya Crisis*. Gjetur në The New York Times : <https://www.nytimes.com/2017/12/05/opinion/china-rohingya-crisis.html>
- Besheer, M. (2018, Tetor 24). *UN Official Urges Justice for Myanmar's Rohingya*. Gjetur në VOA: <https://www.voanews.com/usa/un-official-urges-justice-myanmars-rohingya>
- Birma. (2020). *Languages in Myanmar*. Gjetur në <https://www.birma.com/languages-in-myanmar.html>
- Bookbinder, A. (2013). *969: The Strange Numerological Basis for Burma's Religious Violence*. The Atlantic. Gjetur në <https://www.theatlantic.com/international/archive/2013/04/969-the-strange-numerological-basis-for-burmas-religious-violence/274816/>
- Bookbinder, A. (2014, Tetor 3). *Rakhine Action Plan a 'Blueprint for Segregation and Statelessness'*. Retrieved from <http://alexbookbinder.com/rakhine-action-plan-a-blueprint-for-segregation-and-statelessness-dvb/>
- Bookbinder, A. (2014, Nëntor 12). *UN Sec-Gen Urges Rohingya Rights*. Gjetur në <http://alexbookbinder.com/un-sec-gen-urges-rohingya-rights-dvb/>
- Brooker, P. (2009). *Non-Democratic Regimes*. London: Palgrave Macmillan; 2 edition.
- Broomfield, M. (2016, Dhjetor 9). *UN calls on Burma's Aung San Suu Kyi to halt 'ethnic cleansing' of Rohingya Muslims*. Gjetur në The Independent : <https://www.independent.co.uk/news/world/asia/burma-rohingya-myanmar-muslims-united-nations-calls-on-suu-kyi-a7465036.html>
- Brunnstrom, D., & Wroughton, L. (2019, Korrik 16). *U.S. imposes sanctions on Myanmar military leaders over Rohingya abuses*. Gjetur në Reuters: <https://www.reuters.com/article/us-usa-myanmar-idUSKCN1UB2QM>
- Buchanan, F. (1799). *A Comparative Vocabulary of Some of the Languages Spoken in the Burma Empire*. Asiatic Research 5. Gjetur në <https://eprints.soas.ac.uk/8050/1/BuchananComparativeVocabulary.pdf>
- Burma Unified. (2019). Gjetur në The Senate Of The United States : <https://www.congress.gov/bill/116th-congress/house-bill/3190/text#toc-H5A5FFA651E5243E6B76E02E83AB52F4D>
- Burt, A. (2019, Shtator 16). *How Britain is striving to end the Rohingya crisis*. Gjetur në The Daily Star : <https://www.thedailystar.net/rohingya-crisis/news/how-britain-striving-end-the-rohingya-crisis-1634266>

- Cady, J. F. (1958). *A History of Modern Burma*. Ithaca: Cornell University Press.
- Calderwood, I. (2017, Nëntor 14). *British PM Theresa May Condemns What 'Looks Like Ethnic Cleansing' of Rohingya Muslims*. Gjetur në Global Citizen : <https://www.globalcitizen.org/fr/content/theresa-may-rohingya-myanmar-ethnic-cleansing/>
- Carroll, J. (2019, Gusht 6). *UN calls for sanctions, arms embargo against Myanmar army*. Gjetur në Al Jazeera: <https://www.aljazeera.com/news/2019/08/calls-sanctions-arms-embargo-myanmar-army-190806011519378.html>
- Central Intelligence Agency. (2020). *World Factbook: Myanmar*. Gjetur në <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/bm.html>
- Clymer, K. (2015). *A Delicate Relationship: The United States and Burma/Myanmar since 1945*. New York : Cornell University Press.
- CNN. (2012). *Death sentences for 2 Muslims in murder case that set off Myanmar unrest*. CNN. Gjetur në <https://edition.cnn.com/2012/06/19/world/asia/myanmar-rakhine-death-sentence/index.html>
- Cohen, R. (2008, Korrik 21). *The Burma Cyclone and the Responsibility to Protect*. Gjetur në Brookings : <https://www.brookings.edu/on-the-record/the-burma-cyclone-and-the-responsibility-to-protect/>
- Commission on Human Rights. (1992, Mars 3). *Situation of human rights in Myanmar*. Gjetur në Office of the High Commissioner for Human Rights: <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Myan%20E%20CN4%20RES%201992%2058.pdf>
- Commission on Human Rights. (1993, 17 Shkurt). *QUESTION OF THE VIOLATION OF HUMAN RIGHTS AND FUNDAMENTAL FREEDOMS IN ANY PART OF THE WORLD, WITH PARTICULAR REFERENCE TO COLONIAL AND OTHER DEPENDENT COUNTRIES AND TERRITORIES*. Gjetur në Report on the situation of human rights in Myanmar: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G93/108/30/PDF/G9310830.pdf?OpenElement>
- Cooler, R. M. (2002). *THE ART AND CULTURE OF BURMA: Prehistoric and Animist Periods*. Northern Illinois: Center for Burma Studies. Gjetur në http://www.seasite.niu.edu/burmese/Cooler/BurmaArt_TOC.htm
- Corruption Perception Index. (2019). *www.transparency.org*. Gjetur në <https://www.transparency.org/cpi2019>
- Cotte, M. (2015). 'Third time lucky for a Russia-Myanmar nuclear deal? *IIIS Voices*. Gjetur në www.iiss.org/en/iiss%20voices/blogsections/iiss-voices2015-dda3/april-1413/third-time-lucky-for-a-russian-myanmar-nuclear-deal-ed6e.
- Danish Refugee Council . (2014). *Daily Record of Information from DRC Program Locations in Rakhine* . Gjetur në Myanmar: <https://drc.ngo/where-we-work/asia/myanmar>
- Dautremer, J. (1913). *Burma Under British Rule*. London : University of Michigan Library.

- Department of Population. (2020). Retrieved from Ministry of Labour, Immigration and Population: <http://www.dop.gov.mm/en>
- Edroos, F. (2017, Shtator 13). *ARSA: Who are the Arakan Rohingya Salvation Army?* Gjetur në www.aljazeera.com: <https://www.aljazeera.com/news/2017/09/myanmar-arakan-rohingya-salvation-army-170912060700394.html>
- Ellis-Petersen, H. (2018, Nëntor 23). *From peace icon to pariah: Aung San Suu Kyi's fall from grace*. Gjetur në The Guardian: <https://www.theguardian.com/world/2018/nov/23/aung-san-suu-kyi-fall-from-grace-myanmar>
- Encyclopedia Britannica. (2020). *About Myanmar*. Gjetur në www.britannica.com/place/Myanmar
- Encyclopedia Britannica. (2020). *Associated Press*. Gjetur në <https://www.britannica.com/topic/Associated-Press>
- Fan, H., & Steinberg, D. I. (2012). *Modern China-Myanmar Relations: Dilemmas of Mutual Dependence*. Copenhagen: Nordic Institute of Asian Studies Press.
- Fan, L., & Saleem, A. (2012). *Rakhine crisis: Restricted humanitarian access and risk of radicalisation*. Gjetur në www.aljazeera.com: <https://www.aljazeera.com/indepth/opinion/2012/11/20121179208947630.html>
- Fassihi, F. (2018, Nëntor 24). *Genocide Continues in Myanmar, Says U.N. Investigator*. Gjetur në The Wall Street Journal : <https://www.wsj.com/articles/u-n-investigator-says-genocide-continues-in-myanmar-1540427100>
- Fisher, J. (2013, Gusht 29). *Anti-Muslim monk stokes Burmese religious tensions*. Gjetur në BBC NEWS: <https://www.bbc.com/news/world-asia-23846632>
- Foreign&Commonwealth Office. (2017, Shtator 2). *Foreign Secretary calls for an end to violence in Rakhine*. Retrieved from GOV.UK: <https://www.gov.uk/government/news/foreign-secretary-calls-on-an-end-to-violence-in-rakhine>
- Fortify Rights. (2015). *Persecution of the Rohingya Muslims: Is Genocide Occurring in Myanmar's Rakhine State*. Yale Law School.
- Fortify Rights. (2018). *"They Gave Them Long Swords": Preparation for Genocide and Crimes Against Humanity Against Rohingya Muslims in Rakhine State, Myanmar*. Fortify Rights.
- Foxeus, N. (2019). The Buddha was a devoted nationalist: Buddhist nationalism, resentment, and defending Buddhism in Myanmar. *Religion*, 668.
- France 24. (2017, Shtator 21). *Crise des Rohingya : Macron parle d'un "génocide en cours"*. Gjetur në France 24: <https://www.france24.com/fr/20170921-emmanuel-macron-rohingya-birmanie-genocide-nettoyage-ethnique-onu>
- France Diplomatie. (2018, Shtator 8). *The Rohingya Crisis*. Gjetur në Ministry for Europe and Foreign Affairs: <https://www.diplomatie.gouv.fr/en/country-files/myanmar/the-rohingya-crisis/>

- Freedom House. (2019). Freedom In The World. Myanmar. Gjetur në <https://freedomhouse.org/country/myanmar/freedom-world/2019>
- Frydenlund, I. (2018, Mars 20). *MaBaTha*. Gjetur në World Religious and Spirituality : <https://wrlldrels.org/2018/03/21/mabatha/>
- Fuller, T. (2012). Obama Receives Warm Welcome in Myanmar. *The New York Times*. Gjetur në <https://www.nytimes.com/2012/11/20/world/asia/obama-receives-warm-welcome-in-myanmar.html?searchResultPosition=6>
- Fuller, T. (2013, Qershor 20). Gjetur në <https://www.nytimes.com/2013/06/21/world/asia/extremism-rises-among-myanmar-buddhists-wary-of-muslim-minority.html>
- Fuller, T. (2013, Qershor 20). *Extremism Rises Among Myanmar Buddhists*. Gjetur në The New York Times : <https://www.nytimes.com/2013/06/21/world/asia/extremism-rises-among-myanmar-buddhists-wary-of-muslim-minority.html>
- Further Consolidated Appropriations Act. (2020). Gjetur në Congress of the United States of America: <https://www.congress.gov/bill/116th-congress/house-bill/1865/text>
- General Assembly. (2005, Tetor 24). *2005 World Summit Outcome* . Gjetur në A/RES/60/1: https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/generalassembly/docs/globalcompact/A_RES_60_1.pdf
- Genocide Convention. (1948, Dhjetor 9). *Article I*. Retrieved from https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf
- Genocide Convention. (1948, Dhjetor 9). *Article II*. Gjetur në https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf
- Genocide Convention. (1948, Dhjetor 9). *Article III*. Retrieved from https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocities-crimes/Doc.1_Convention%20on%20the%20Prevention%20and%20Punishment%20of%20the%20Crime%20of%20Genocide.pdf
- Genocide Watch. (2020). *The Ten Stages of Genocide*. Gjetur në <https://www.genocidewatch.com/ten-stages-genocide>
- Genser, J. (2018). *The UN Security Council's Implementation of the Responsibility to Protect: A Review of Past Interventions and Recommendations for Improvement*. Global Centre for the Responsibility to Protect. Gjetur në <http://responsibilitytoprotect.org/files/un-security-council-application-of-r2p-jared-genser.pdf>
- Gërdeci, A. (2019). *Ndërhyrja Humanitare dhe Përgjegjësia për të mbrojtur*. Gjetur në https://unitir.edu.al/hapdokument/?pdfURL=/wp-content/uploads/2019/07/2019_ALBA-

GERDECI_ND%C3%8BRHYRJA-HUMANITARE-DHE-P%C3%8BRGJEGJ%C3%8BSIA-P%C3%8BR-T%C3%8B-MBROJTUR.pdf#toolbar=0

Gjerde, K. L. (2017). *Russia's turn to Asia: Myanmar seen from Moscow*. Norwegian Institute for Internal Affairs. Gjetur në https://nupi.brage.unit.no/nupi-xmlui/bitstream/handle/11250/2452187/NUPI_Policy_Brief_10_17_Lundby-Gjerde.pdf?sequence=1&isAllowed=y

Global R2P. (2020). *Global Centre for Responsibility to Protect*. Gjetur në What is R2P?: <https://www.globalr2p.org/what-is-r2p/>

Goldman, R. (2017, Shtator 4). *Muslims on 2 Continents Protest Persecution in Myanmar*. Gjetur në The New York Times: <https://www.nytimes.com/2017/09/04/world/asia/muslims-rohingya-daw-aung-san-su-kyi-malala-myanmar.html>

Goldstein, J. (2001). *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*. Tiranë: Soros.

Google Maps. (2020). *Myanmar*. Gjetur në [www.google.com/maps:https://www.google.com/maps/place/%D0%9C%D1%98%D0%B0%D0%BD%D0%BC%D0%B0%D1%80+\(%D0%91%D1%83%D1%80%D0%BC%D0%B0\)/@18.7806129,87.634286,5z/data=!3m1!4b1!4m5!3m4!1s0x305652a7714e2907:0xba7b0ee41c622b11!8m2!3d21.916221!4d95.955974](http://www.google.com/maps:https://www.google.com/maps/place/%D0%9C%D1%98%D0%B0%D0%BD%D0%BC%D0%B0%D1%80+(%D0%91%D1%83%D1%80%D0%BC%D0%B0)/@18.7806129,87.634286,5z/data=!3m1!4b1!4m5!3m4!1s0x305652a7714e2907:0xba7b0ee41c622b11!8m2!3d21.916221!4d95.955974)

Greenwood, C. (2002). Humanitarian intervention: The Case of Kosovo. Në *Finnish Yearbook of International Law* (fv. 141-175). Helsinki, Finland: Kluwer Law. Gjetur në [http://eprints.lse.ac.uk/21492/1/Humanitarian_intervention_the_case_of_Kosovo\(LSERO\).pdf](http://eprints.lse.ac.uk/21492/1/Humanitarian_intervention_the_case_of_Kosovo(LSERO).pdf)

Gruda, Z. (2007). *Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut*. Prishtinë: Universiteti "Fama".

Habib, M., Jubb, C., & et.al. (2018). *Forced Migration of Rohingya: The Untold Experience*. Ottawa: Ontario International Development Agency.

Hlaing, K. K., & Vakulchuk, R. (2017). *Myanmar's Attractiveness for Investment in the Energy Sector: A Comparative International Perspective*. Gjetur në https://www.researchgate.net/publication/317954536_Myanmar's_Attractiveness_for_Investment_in_the_Energy_Sector_A_Comparative_International_Perspective

Hodal, K. (2013, Prill 18). *Buddhist monk uses racism and rumours to spread hatred in Burma*. Gjetur në www.theguardian.com/: <https://www.theguardian.com/world/2013/apr/18/buddhist-monk-spreads-hatred-burma>

